

**Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Instituti i Studimeve Albanologjike**

***Fjalori i Shoqërisë «Bashkimi»  
në  
100 - vjetorin e tij***

**Studime shqiptare 19  
Shkodër, 2011**

**Këshilli shkencor:**

**Prof. dr. Artan Haxhi**  
**Prof. dr. Tomor Osmani**  
**Prof. as. dr. Tefë Topalli**  
**Prof. as. dr. Mimoza Priku**

**Redaktuan dhe përgatitën botimin**

**Prof. dr. Tomor Osmani**  
**Prof. as. dr. Tefë Topalli**  
**Prof. as. dr. Mimoza Priku**

**ISBN 978-9928-4011-5-1**

© Copyright:

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

**Korrektoi dhe faqosi Arta Bajrami**

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, më 19 janar 2008 organizuan konferencën shkencore “100 vjet të Fjalorit të shoqërisë “*Bashkimi*”.

Në këtë veprimtari morën pjesë pedagogë të këtij Universiteti, punonjës të Qendrës Shkencore Albanologjike në Tiranë, profesorë të Fakultetit “*Histori-Filologji*” të Tiranës. Ishte i pranishëm edhe prefekti i Shkodrës z. Maxhid Cungu.

Fjalën e hapjes e mbajti prof. dr. Tomor Osmani.

Në emër të Rektoratit të Universitetit të Shkodrës përshëndeti zv. rektori prof. as. dr. Fatmir Vadahi dhe prefekti i Shkodrës z. Maxhid Cungu.

Pastaj u vazhdua me leximin e kumtesave.

Në këtë botim përfshihen edhe disa materiale që nuk janë mbajtur në konferencë, por që kanë lidhje me Fjalorin e shoqërisë “*Bashkimi*”.

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

### **Tomor OSMANI**

Fjalori i shoqërisë “Bashkimi” – vepër me vlera të rëndësishme leksikografike

*The Dictionary of “Bashkimi Association” – A dictionary of important lexicological values.....9*

### **Emil LAFE**

Fjalori i shoqërisë “Bashkimi” i vështruar në krahasim me Fjalorin e K. Kristoforidhit

*The dictionary of “Bashkimi Association” versus K.Kristoforidhi’s Dictionary.....21*

### **Enver HYSA**

Larmia e mjeteve dhe e tipave fjalëformues të Fjalorit të shoqërisë “Bashkimi”

*The Dictionary of “Bashkimi Association” – a variety of word – formation types.....31*

### **Kolec TOPALLI**

Fjalori i shoqërisë “Bashkimi” dhe etimologjia e shqipes.

*The Dictionary of “Bashkimi Association” – Albanian Etymology.....39*

**Gjovalin SHKURTAJ**

Kahe të mbara fjalëformuese dhe normëthemeluese të Fjalorit të “Bashkimit”.

*The Dictionary of “Bashkimi Association” normative rules of word formation.....53*

**Mimoza PRIKU**

Fjalësi diturak në Fjalorin e shoqërisë “Bashkimi”.

*The sciential wordbook in the vocabulary of “Bashkimi” Society.....63*

**Ledi SHAMKU**

Pastë jetë të gjatë më se një shekull!

*Long life quite a century.....79*

**Anisa KOSTERI**

Frazeologjizmat në Fjalorin e “Bashkimit”.

*The Dictionary of “Bashkimi Association”– Albanian phraseology.....87*

**Artan HAXHI, Tefë TOPALLI**

Shtresa stilistikore në Fjalorin e shoqërisë “Bashkimi”.

*Stylistic strata in the Dictionary of “Bashkimi Association” .....99*

**Shezai RROKAJ**

Disa parime të zbatuara në Fjalorin e “Bashkimit”.

*Some principles applied in Dictionary “Bashkimi”* .....111

**Miço SAMARA**

Rreth vlerave leksikografike të Fjalorit të shoqërisë “Bashkimi” (1908).

*Lexicographical Achievements in "Bashkimi" Dictionary*.....117

**Shefkije ISLAMAJ**

U ribotua Fjalori i shoqërisë “Bashkimi”.

*The New Edition of “Bashkimi” Dictionary*.....121

**Karl GURAKUQI**

Pesëdhjetëvjetori i Fjalorit “Bashkimi”. Kujtime të reja e të vjetra.

*The Fiftieth Anniversary of “Bashkimi” Dictionary.*

*Past and Present Recollections*.....133

Parathënia e Fjalorit, 1908

*Preface to the Dictionary of 1908*..... 141

Ahmet Kelmendi, *Dy fjalë me rastin e ribotimit*, Prishtinë, 1978.

*On the occassion of its re-edition*, Pristina, 1978.....145

A.Xhuvani, *Fjalori i “Bashkimit”*. (1911)

*The Dictionary of “Bashkimi Association”*. (1911).....149

D. Ndoc Nikaj, *Sajimi i një alfabeti të përgjithshëm*.

*The compilation of an alphabet*.....155

A. Pal Doçi, *Puna e Doçit dhe e shoqërisë “Bashkimi” në fushën e gjuhës shqipe.*  
*Doçi his linguistic contribution as representative of the “Bashkimi” Association.....*157

**Tomor OSMANI**

## **FJALORI I SHOQËRISË “BASHKIMI” – VEPËR ME VLERA TË RËNDËSISHME LEKSIKOGRAFIKE**

Sivjet mbushen 100 vjet nga botimi i fjalorit të shoqërisë “*Bashkimi*”, më 1908 që është kremtimi i dytë në fushën e leksikografisë pas asaj konference shkencore me temë “*Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*” që u mbajt në Tiranë, më 3 dhjetor 2004, e cila përkonte me 100 - vjetorin e botimit të Fjalorit të K. Kristoforidhit dhe 50-vjetorin e Fjalorit të gjuhës shqipe të vitit 1954.

Do të jetë, kështu, 10-vjeçari i parë i shekullit XX që do të na japë dy vepra të rëndësishme leksikografike për gjuhën shqipe Fjalorin e K. Kristoforidhit (1904) dhe atë të shoqërisë “*Bashkimi*”(1908).

\* \* \*

Shoqëria shqiptare në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, por e ndiente gjithnjë e më shumë nevojën për përhapjen e gjuhës dhe të shkrimit shqip. Gjithë popujt e Ballkanit kishin fituar pavarësinë, ndërkohë edhe ndërgjegjja politike e shqiptarëve po rritej. Kjo u shoqërua me masa të tilla, që kishin karakter politik dhe kulturor. Në këto rrethana, një ngjarje e shënuar në fushën e kulturës



qe themelimi i shoqërisë “*Bashkimi*” në Shkodër në janarin e vitit 1899, me nismën e abatit të Mirditës, Preng Doçit. Pjesëmarrës ishin klerikë, ndonëse ishin ftuar për të marrë pjesë edhe disa mësues që, siç shkruan në kujtimet e tij Ndoc Nika kishin “zotsij<sup>1</sup> pende”, por nuk u aktivizuan për të mos krijuar dyshime te autoritetet turke. Shoqëria “*Bashkimi*” deri në vitin 1908 kishte botuar mbi 30 vepra. Ato ishin laike, me karakter gjuhësor, letrar, historik, shkollor, por edhe fetar, si: *Abetari, Oroë permimi abetar shqyp, Dheshkronja, Historia e Shqypniis, Te Ura e Rrzhanicës, Anzat e Parnasit, Bleta e re, Vargënimi n’gjuhë shqypeme një fjalorth shqyp–frengjisht n’ marim etj.*

Rilindësit tanë patën si ideal për të realizuar njësimin e alfabetit të shqipes, hartimin e gramatikës të gjuhës sonë dhe fjalorin e saj, që gjatë shekullit XIX e kreu shoqëria e Stambollit, me hartimin e alfabetit të Stambollit, më 1879, me botimin e “*Shkronjëtoe e gjuhës shqipe*” nga Sami Frashëri, më 1886 dhe në shek.XX me botimin e fjalorit të K.Kristoforidhit, më 1904. Këtë do ta realizojë edhe shoqëria “*Bashkimi*” disa vjet më vonë. Fillimisht u hartua alfabeti, që mbështetej në atë latin dhe pranonte dyshkronjëshat e që njihet si alfabeti i shoqërisë “*Bashkimi*”, më pas gramatika. Kështu në trinomim alfabet, gramatikë, fjalor ishin realizuar dy të parat. Tashti i kishte ardhur radha fjalorit.

*Në ç’rrethana u botua fjalori?* Jemi më 1908, 4 vjet para shpalljes së pavarësisë dhe kur, krahas detyrave me karakter politik, ishin edhe ato me karakter kulturor dhe arsimor. Ndonëse në fushën e kulturës një detyrë parësore ishte puna për zgjidhjen përfundimtare të problemit të alfabetit të njësuar të gjuhës shqipe, krahas saj duhej kontribuar edhe për mësimin, përhapjen, lëvrimin e gjuhës shqipe dhe hapjen e shkollave në gjuhën amtare. Në këto kushte hartimi i një fjalori për gjuhën shqipe ishte një domosdoshmëri, të cilën e

mori përsipër për ta zgjidhur kjo shoqëri. Edhe tipi i fjalorit ishte i kushtëzuar nga rrethanat politiko-shoqërore dhe nga vetë dija e kohës. Ende nuk ishte shkruar dhe botuar një fjalor shpjegues vetëm për gjuhën shqipe, por vetëm botoheshin fjalorë dygjuhësh, që nga fjalori i Frang Bardhit (1635) dhe në vazhdim.

Fjalori i “*Bashkimit*” u botua në Shkodër, 9 vjet pas themelimit të shoqërisë, më 1908, 100 vjet më parë. Titullohej: “*Fjaluer i Rii i Shqypes*” përbam prej Shoqnit t’*Bashkimit*.



*Anëtarët e shoqërisë “Bashkimi”: Preng Doçi, Gjergj Fishta, Ndoc Sheldija, Gjon Koleci, Mark Shllaku, Pashk Bardhi, Ndoc Nikaj, Jak Sarreqi, Dod Koleci, Mhill Çuni*

Parathënia e shkurtër mban datën 9 kallnuer 1908 dhe në fund të

saj shënohej: *Parsimi i Shoqniis Bashkimit t'Giuhes Shqype*. Vepra shënon një arritje në krahasim me fjalorët e botuar para tij, të cilët kanë qenë dygjuhësh. Ajo ka 538 f. +12, ndërsa fjalori fillon në f.17-526. Shtojca përfshin faqet 527-538. Pas parathënies së shkurtër jep alfabetin e përdorur që është një variant i alfabetit të “Bashkimit” me 34 shkronja (mungojnë dy shkronja ). Jep disa udhëzime të shkurtra për zanoret e theksuara dhe të patheksuara, për gjatësinë e zanoreve etj. Kur jep shkurtimin e termave gjuhësorë të përdorura në fjalor, i veçon fjalët e huaja nga ato të burimit autokton, duke i shënuar fjalët me burim turk me inicialën T, ato sllave me S dhe italiane me I. Bëhet edhe një sqarim. Në fjalor janë paraqitur fjalë të huaja që nuk u dihet burimi dhe për këto është venë pikëpyetje dhe fjalë shqipe që nuk u dihet kuptimi, të cilat shënohen në fjalor me dy pikëpyetje. Pastaj vjen fjalori. Për numrin e fjalëve nuk ka një shifër permanente. Është shënuar se fjalori ka rreth 11000 fjalë, por sipas parathënies të ribotimit të Prishtinës, më 1978 kjo shifër ndryshon. Me pjesën integrale dhe me shtojcën thuhet se shkon në 13798 fjalë<sup>2</sup>, ndërsa Shefkije Islamaj shkruan se fjalori së bashku me shtojcën ka 13614 fjalë.<sup>3</sup> Koleges sonë Anisa Ndocit, që po merret ekskluzivisht me këtë fjalor, i dalin se ai ka 13127 fjalë (bashkë me shtojcën), prej të cilave 1441 turke. Po të vërehet fjalësi i fjalorit jo të gjitha fjalët përbëjnë një njësi më vete leksikore, pasi në mjaft raste janë marrë si fjalë të veçanta edhe ato që paraqiten me ndryshime fonetike. Edhe për mendimin tonë ky fjalor ka rreth 12000-13000 fjalë.<sup>4</sup> Është e domosdoshme që të bëhet dallimi në mes fjalëve dhe varianteve të tyre etj.

Ky fjalor botohej 4 vjet pas Fjalorit të K.Kristoforidhit. Siç është thënë edhe nga hartuesit, autorët që janë shfrytëzuar, kanë qenë: Budi, Bardhi, Bogdani, Kristoforidhi, prandaj edhe ndikimi i këtij të fundit, sado modest që mund të jetë, është i pranishëm. Kur

shënohen fjalët jepen këto të dhëna gramatikore, duke shënuar në radhë të parë se ç'pjesë ligjërata i përket: për emrin jepet : gjinia, numri. Si formë përfaqësuese të foljes autorët kanë marrë veten e parë, të kohës së tashme të mënyrës dëftore, forma veprare. Jepet edhe veta III njëjës dhe veta e parë e së kryerës së thjeshtë, paskajorja e formës veprare e joveprare, si afrojt ~ on, ~ova, me e m'u afrue; marr – merr, mora, me e m'u marrë. Foljet e zgjedhimit II, në veten e parë dalin me mbaresë: hapi, çili, mbylli. Jo gjithnjë, por kemi ndeshur raste që si formë përfaqësuese merret paskajorja: me pa: shof, shef, paash e pava. Në ato raste kur është bërë shpjegimi i fjalëve, autorët e kanë dhënë mirë dhe qartë.

*Cili ishte qëllimi i botimit të këtij fjalori?* Këtë vepër shoqëria “*Bashkimi*” ia kushton gjuhës sonë, të cilën e shfaq qartë në fillimin e parathënies, kur thuhet se “*Po qesim n' dritë ket fialuer m' t' cillin kemi mbledhë ma t'shumen, sa ku kemi mujtë, t'atyne fjalve , sikurse fliten neper qytete, fusha e male t'dashtunes atmes s'onë.*” Shoqëria kërkonte që përmes veprave të saj, të lëvronte gjuhën shqipe.

*Lënda e fjalorit:* Përfshin: 1.Fjalë dhe frazeologji të mbledhura drejtpërdrejt nga goja e popullit 2. Fjalë të nxjerra nga botimet e ndryshme të autorëve vendës dhe të huaj që i kanë dhënë “*një shkelqim e hijeshi gjuhës s'onë, sikurse dom Pjetër Budi, emx. Frang Bardhi, emx. Pjetër Bogdani, Gustav Meyeri, atë Jak Jungu, Kristoforidhi*”<sup>5</sup>, si dhe autorë të tjerë të asaj kohe. Është qëmtuar e vjelë me kujdes një pjesë mjaft e madhe e pasurisë leksikore deri në atë kohë. Por Preng Doçi i kishte caktuar detyra secilit prej anëtarëve të shoqërisë për të mbledhur fjalë për shkronja të veçanta. Duhet të jetë bërë një punë përgatitore që do të kishte nisur disa vjet para botimit të fjalorit<sup>6</sup>. Sipas K.Gurakuqit u udhëzuan famullitarët të mbledhnin “*fjalë të rralla bimësh, zogjsh dhe kafshësh,*<sup>7</sup> duke

dhënë edhe korresponduesen në italisht ose latinisht me shpjegimet përkatëse. Për këtë qëllim punuan, po, sipas K.Gurakuqit, klerikët don Prend Suli, don Pal Treshi, don Mark Shllaku, don Ndoc Nikaj, atë Pashk Bardhi dhe të gjithë anëtarët e shoqërisë “*Bashkimi*”.

Hartuesit kanë mendimin se glosari i këtij fjalori përmbledh fjalë shqipe nga të gjitha anët, jo të ruajtura në formën ekzistuese, por të paraqitura “*në trajtë të shqyptimit të Shkodërs*”, duke i vënë gjegjësen në italisht, por jo gjithnjë, pasi hartuesit, duke qenë se një pjesë e fjalëve i përkiste ligjëritimit të folur, nuk e kanë gjetur në italisht korresponduesen e saj. “*Por asht shpnesa, shkruajnë në parathënie, se masi t’ përhapet shqypia letrare kto diftime s’kan për t’u lypun e kto mungesa kan për t’u shdukë preie Fjalorit t’onë.*” Kjo i ka çuar studiuesit e mëvonshëm që, ndonëse ky fjalor ka pamjen e një fjalori dygjuhësh shqip-italisht, ai mund të quhet fjalor i shqipes, sepse siç e theksuam, në mjaft raste nuk jepet gjegjësjë në italisht <sup>8</sup>. Ka studiues që pohojnë se ky fjalor nuk pasqyron gjithë leksikun e gjuhës shqipe, por kryesisht të zonave veriore. Hartuesit e fjalorit nuk e kanë parë të udhës të shënojnë se nga ku i kanë marrë këto fjalë, ndryshe kanë vepruar me fjalët e huaja që e përcaktojnë burimin e tyre. Gjithashtu në fjalor nuk janë përfshirë neologjizmat, pasi shumë prej tyre nuk kishin fituar të drejtën e qytetarisë dhe disa fjalë ishin ndërtuar kundër ligjeve të brendshme të gjuhës sonë.

*Kush e hartoi Fjalorin?* Ideja për hartimin e fjalorit i kishte lindur themeluesit të shoqërisë “*Bashkimi*” abatit të Mirditës, Preng Doçit. Ndonëse është fryt i një pune të përbashkët të disa autorëve të shoqërisë “*Bashkimi*”, si dhe i subjekteve që qenë famullitarë të zonave veriore, drejtimi i përket tjetër Preng Doçit, ndërsa autorësia më shumë i takon Dom Dodë Kolecit. Praktika e shoqërisë ishte e tillë që të mos shënohej autori, prandaj në fund te parathënia është vënë parësia. Pse i **atribohet** D.Kolecit një vepër e tillë? Sipas

K.Gurakuqit, Preng Doçi e çmonte D.Kolecin “*për zgjuesi mendjeje, për kulturë e për zotsi ndërmarrjeje*”. N. Nikaj sqaron se 4-5 shkronja ka shkruar Mark Shllaku, ndërsa ai vetë 1/3 e shkronjave d.m.th. 12 shkronja. Kështu del sipas kësaj dëshmie se D.Koleci ka përgatitur më shumë se gjysmën e fjalorit. Për K.Gurakuqin “*kryepërpiluesi është don D.Koleci*”<sup>9</sup> që autori e përsërit edhe ndonjë shkrim tjetër. Të njëjtin mendim ka edhe Daniel Gjeçaj që për të autori kryesor i këtij fjalori është d.Dodë Koleci.<sup>10</sup>

*Cili është kontributi Fishtës në këtë fjalor?* Autori i “*Lahutës së Malcis*” kur u botua fjalori ishte 34 vjeç. Kishte botuar “*Te Ura e Rrzhanicës*” (1905) dhe “*Anzat e Parnasit*”(1907). Ishte bërë i njohur në mjediset intelektuale, si njeri me formim të gjithanshëm kulturor. Mendimi im, siç e kam theksuar edhe më parë, Fishtën nuk mund ta quajmë bashkautor, sistemues dhe shpjegues të fjalëve leksemë të këtij fjalori, por mund ta konsiderojmë si një nga autorët më veprues që dha një pjesë të visarit të popullit në këtë vepër<sup>11</sup>. Për K.Gurakuqin Fishta nuk qe autori i drejtpërdrejtë, por dha ndihmesën e çmuar në përpilimin e saj. Ndërsa në një botim tjetër thotë se Fishta në të gjithë veprat e shoqërisë dha ndihmesën e vet të vlefshme me këshilla dhe punë.<sup>12</sup>

*Fjalësi i fjalorit.* Ai përfshin fjalë të shtresave të ndryshme leksikore, përveç fjalëve të ligjërit të zakonshëm dhe në disa raste edhe krahinor. Pasqyrimi i gjithë leksikut të niveleve të ndryshme është i lidhur me gjendjen e gjuhës shqipe, me zhvillimet e saj, por edhe me pikësnyimet që kanë pasur hartuesit. Në fjalor zënë vend, kryesisht fjalë të burimit autokton që kanë vlerë të veçantë jo vetëm për kohën kur u shkruan , por edhe më vonë. Lexuesi njihet edhe me ato fjalë që kanë kaluar në fondin pasiv që, sipas A.Kelmendit <sup>13</sup>, një pjesë e madhe e tyre janë vjetëruar, por sipas nesh, me një

studim të hollësishëm të specialistëve të gjuhës dhe të leksikografëve të sotëm, ato fjalë që janë kthyer në arkaizma apo historizma, mund të rivështrohen dhe të gjallërohen për t'u përfshirë në fjalorin aktiv të gjuhës së sotme shqipe. E rëndësishme është se në fjalor janë dhënë edhe mjaft sinonime, të cilat i japin vlerë kësaj vepre dhe leksikut të gjuhës sonë. Duke qenë se në kushtet e pushtimit të gjatë osman, me të vërtetë gjuha shqipe i rezistoi asimilimit, por në leksikon e saj u futën edhe mjaft fjalë të huaja, të cilat gjetën pasqyrim edhe në fjalorin e shoqërisë "*Bashkimi*". Për studiuesin nuk është e vështirë të vërehet ndikimi i leksikut të huaj, pasi kjo është bërë e qartë nga autorët e veprës, të cilët e kanë sqaruar një fakt të tillë për çdo fjalë të gurrës joautoktone. Vendin e parë e zënë turqizmat. Sipas numërimit të Sh.Islamaj në fjalor ka 1342 turqizma<sup>14</sup>, diçka më tepër se 10% të të gjithë të fjalëve të fjalorit, ndërsa sllavizma dhe italianizma ka më pak. Sot është rëndësishme që këto fjalë të rivështrohen se sa i kanë qëndruar kohës, sa kanë mbetur në ligjërimin e folur dhe të shkruar, sa janë të trashëguara dhe sa janë të reja për atë kohë, sa prej tyre mund t'u ketë ndërruar kuptimin në atë kohë dhe më vonë.

Duke qenë se pati vërejtje dhe kritika për disa mangësi të fjalorit, shoqëria "*Bashkimi*" kishte ndërmend ta ribotonte, duke shtuar pasurinë leksikore dhe duke e pastruar nga fjalët e burimit të huaj që ishin të panevojshëm. Për këtë qëllim shoqëria "*Bashkimi*" do të aktivizonte përsëri famullitarët, të cilëve iu dha një kopje e fjalorit që të regjistronin fjalët që nuk ishin pasqyruar në të. Fjalori nuk u botua i ripunuar. Me rastin e 70-vjetorit të botimit të Fjalorit në Prishtinë iu bë një ribotim anastatik. Sot ne presim, që krahas botimit të disa fjalorëve të traditës, të ribotohet edhe fjalori i "*Bashkimit*", jo vetën anastatik, por edhe i transkriptuar. Edhe kjo Konferencë shkencore që po organizojmë sot

për fjalorin e shoqërisë “Bashkimi” është e para e këtij lloji pas 100 vjetëve të botimit.

*Jehona e veprës dhe rëndësia e Fjalorit.* Ai u vlerësua dhe pati jehonë në rrethet intelektuale të kohës dhe më vonë. Këtë e çmoi L.Gurakuqi, G, Petrota etj. Aleksandër Xhuvani në një shkrim të botuar në gazetën “Shkreptima” që dilte në Kajro, tri vjet pas botimit të Fjalorit, krahas vlerësimit dhe kritikave, bënte edhe ndonjë sugjerim që në një botim të dytë të rritej vëllimi dhe të shtoheshin fjalët që kjo vepër të zinte “*vendin e një fjalori akademik të gjuhës sonë.*”

\* \* \*

- Fjalori i shoqërisë “Bashkimi” dhe ai i K. Kristoforidhit janë ndër dy veprat kryesore të leksikografisë të gjuhës sonë të fillimit të shekullit XX. Ai ka vlera të veçanta shkencore dhe leksikografike,<sup>15</sup>

- Ky fjalor përfshin një glosar tepër të pasur dhe me shumë vlerë të leksikut të asaj kohe, kur shumë fjalë paraqitën të vjetëruara, por disa sërisht, mund të gjallërohen.

- Vepra ka vlera dialektologjike, por njëkohësisht shërben edhe për të parë evoluimin e gjuhës shqipe në vitet e para të shekullit XX. Në këtë rrafsh nuk përjashtohen vlerat e tij edhe drejtshkrimore, fonetike dhe gramatikore, ku shihet përmes fjalëve të veçanta, se hartuesit po i ndienin atë zhvillim që po ndodhte në gjuhë, duke iu larguar shkodranishtes së gjysmës së dytë të shekullit XIX, gjë e cila u pasqyrua më pas në vendimet që mori Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918) për gjuhën e përbashkët dhe drejtshkrimin e saj.

- Ky fjalor ka shërbyer si mbështetje edhe për fjalorë të tjerë të



botuar pas tij. Është konsideruar një ndër veprat kapitale të leksikografisë sonë dhe një ndër fjalorët më të mirë të leksikografisë shqiptare derisa u botua fjalori i vitit 1954.

- Kjo vepër e shoqërisë “Bashkimi” është një sukses i padiskutueshëm i saj dhe i gjuhësisë sonë, që pasuroi me një vepër të re inventarin e botimeve të leksikografisë shqiptare në një kohë shumë të vështirë, kur vendi ynë ndodhej i pushtuar. Por edhe në kohën e regjimit monist, vlera e saj ka mbetur në heshtje.

- Organizimi i kësaj Konference shkencore për 100-vjetorin e botimit të Fjalorit të shoqërisë “Bashkimi” është edhe një vlerësim dhe mirënjohje i punës së bërë të hartuesve të kësaj vepre një shekull më parë.

#### **REFERENCA:**

1. Dom Ndoc Nikaj, *Kujtim të një jetes së kalueme*, Tiranë, 2003, f.171.
2. Ahmet Kelmendi, *Dy fjalë me rastin e ribotimit*, Fjalor i “Bashkimit”, Prishtinë, 1978, f.VI.
3. Shefkije Islamaj, *U ribotua Fjalori i shoqërisë “Bashkimi”*, Gjurmime albanologjike, IX, 1979, Prishtinë, 1980, f.316.
4. Shih edhe: Shezai Rrokaj, *Disa parime leksikografike të zbatuara në Fjalorin e “Bashkimit”* në përmbledhjen e autorit “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007, f. 108.
5. *Fjaluer i Rii i shqypes*, Shkodër, 1908, f. 4.
6. Pal Pjetër Doçi, *Prend Doçi, abat i Mirditës*, Tiranë, 1997, f. 104-105.
7. Karl Gurakuqi, *Pesëdhjetëvjetori i Fjalorit të “Bashkimit”*, Shejzat, Romë, nr.7-8, korrik-gusht 1958, f. 223-226.
8. Shih: Miço Samara, *Rreth vlerave leksikografike të Fjalorit të*

- shoqërisë "Bashkimi", Shqyrtime albanologjike, Shkup, 2000, f. 29-31.*
9. Karl Gurakuqi, "Shejzat", nr.7, 1962, f.128.
  - 10.P. Duka-G, Jeta dhe veprat e Fishtës, 1992, f.37. Autori shkruan: "*Fishta menjëherë u kthye në dorë të djathtë të këtij veterani të shndritshëm (P.Doçi) dhe, si i tillë muer pjesë aktive ndër të gjitha nicitivat e botimet e shoqnisë, tue zanë fill nga abetari, mandej në libra këndimi e deri në përpilimin e fjalorit të çmueshëm, kështu të quejtun e të vlershëm edhe sot, në fjalorin e "Bashkimit" (1908). Dihet se autori kryesor i këtij fjalori asht dom Dodë Koleci, edhe pse emni i tij s' del në pah në botimet e asaj kohe, ashtu si s'figuron emni i kurrnji nga anëtarët e veprave të botueme nga "Bashkimi". Kjo asht normë e rregullores së shoqnisë vlerëplotë."*
  - 11.Tomor Osmani, *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër*, Shkodër, 2004, f.140.
  12. Shih: K.Gurakuqi, Gjergj Fishta, "Shkëndija", 1941.
  13. A. Kelmendi, *Dy fjalë...f.VII*.
  14. Sh.Islamaj, art.i cit. f. 316.
  15. M. Samara, art. i cit. f.32. Në mes vlerave të tjera, autori shënon: *Së pari fjalori u hartua dhe u botua në rrethana të veçanta historiko-kulturore...kur kërkoheshin dhe bëheshin përpjekje të mëdha që të vihej në jetë programi i rilindësve për hapjen e shkollave në gjuhën amtare dhe përgatitjen e teksteve për to...së dyti, megjithëse Fjalori i shoqërisë "Bashkimi" ka pamjen e një fjalori dygjuhësh (shqip-italisht), ka disa arsye që ai mund të quhet fjalori i shqipes, sepse ai u nis të hartohet si i tillë dhe në mjaft raste pasqyrohet vetëm fjala shqipe pa përgjegjësen në italisht...së treti, krahas vlerave në fushën e leksikut, ky fjalor ka edhe vlera historike, në fushën e gramatikës, sidomos në fushën e*

*drejtshkrimit, meqë aty pasqyrohen edhe përpjekjet për njësimin e drejtshkrimit në përputhje me detyrën që kishte caktuar shoqëria “Bashkimi” për hartimin e rregullave drejtshkrimore dhe të një gramatike, e cila duket se kishte përfunduar para botimit të fjalorit...”*

**Emil LAFE**

**FJALORI I SHOQËRISË “BASHKIMI” I VËSHTRUAR  
NË KRAHASIM ME FJALORIN E  
K. KRISTOFORIDHIT**

Shekulli XX nisi i mbarë për leksikografinë shqiptare: më 1904 pa dritën “Fjalori i gjuhës shqipe” i lënë dorëshkrim nga Kostandin Kristoforidhi, ndërsa pas katër vjetësh, më 1908, gjuha shqipe u pasurua me një fjalor tjetër, i botuar në Shkodër me titullin “Fjaluer i rii i Shqypes Përbâam prejë Shoqniit t’Bashkimit”. Parathënia e nënshkruar nga “Parsimi i Shoqniis Bashkimit t’Gjuhës Shqype” mban datën 9 Kallnuer 1908. Sot më datën 19 Kallnuer ne jemi mbledhur këtu për të shënuar 100-vjetorin e kësaj ngjarjeje për gjuhën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare.

Të dy këta fjalorë kanë disa anë të përbashkëta:

*Së pari*, janë fjalorë të hartuar prej shqiptarësh; hartuesit e tyre ringjallin denjësisht traditën e Frang Bardhit.

*Së dyti*, janë hartuar e botuar në Periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare, kur lëvrimi i gjuhës shqipe dhe mbledhja e botimi i visarit gjuhësor ishte një nga pikat kryesore të programit të saj.

*Së treti*, kanë pak a shumë të njëjtin vëllim: Sipas përlllogaritjes së Aleksandër Xhuvanit, që përgatiti ribotimin e njohur të Fjalorit me transkriptim në alfabetin e sotëm të shqipes e me redaktime të tjera leksikografike, Fjalori i Kristoforidhit ka

11.675 fjalë<sup>1</sup>; për Fjalorin e “*Bashkimit*” është pohuar se ka rreth 11 mijë fjalë<sup>2</sup>. Por në Parathënien e shkruar nga Ahmet Kelmendi për ribotimin e Fjalorit nga Shtëpia botuese “Rilindja” (Prishtinë, 1978), pohohet se: “*Me pjesën integrale dhe me shtojcën na del me afro katërbëdhjetëmijë fjalë (13.798 fjalë)*”<sup>3</sup>. Këtë shifër e pranon më vonë edhe T. Osmani<sup>4</sup>, ndërsa Shefkije Islamaj jep shifrën 13.614 fjalë<sup>5</sup>. Sipas përllogaritjes sonë shtojca e Fjalorit ka 322 fjalë. Pra, në qoftë i saktë numri 11 mijë fjalë, bashkë me Shtojcën nuk kapet numri i fjalëve që jep A. Kelmendi dhe Shefkije Islamaj. Numri i fjalëve të këtij fjalori mbetet për t’u saktësuar.

*Së katërti*, për herë të parë ata janë konceptuar të dy si *fjalorë të gjuhës shqipe*, megjithëse të dy kanë formën e një fjalori shqip – gjuhë e huaj, d.m.th. synimi themelor i hartuesve të tyre ka qenë që të paraqesin leksikun e gjuhës shqipe, duke dhënë sa më saktë kuptimet e fjalëve, dhe jo të hartojnë një fjalor dygjuhësh të mirëfilltë<sup>6</sup>. Është për të vënë re se asnjëri nuk përdori turqishten për shpjegimin e fjalëve shqipe, megjithëse ishte gjuha zyrtare e shtetit dhe një numër i madh shqiptarësh e zotëronin dhe e mësonin në shkolla. Ky qëndrim dëshmon se orientimi kulturor i Rilindjes

---

<sup>1</sup> Fjalor shqip – greqisht prej Konstandin Kristoforidhit, hartuar së pari me alfabet greqisht dhe botuar në Athinë, më 1904 – transkriptuar tani me alfabet shqip dhe përpunuar prej prof. Aleksandër Xhuvanit. Universiteti Shtetëror i Tiranës Instituti i Historisë dhe i Filologjisë. 1961, 397 f. (Parathanie, f. 8).

<sup>2</sup> Tomor Osmani, “Shoqëria “Bashkimi” (1899)”, në: *Fjalor enciklopedik shqiptar*. Tiranë, 1985, f. 1029.

<sup>3</sup> *Fjalori i “Bashkimit”*. Ribotim. “Rilindja”. Prishtinë, 1978, f. VI.

<sup>4</sup> Tomor Osmani, “Shoqëria “Bashkimi” dhe ndihmesat e saj për lëvrimin e gjuhës shqipe”. *Gjuha jonë* 1999, nr. 1-2, f. 99.

<sup>5</sup> Shefkije Islamaj, “U ribotua Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi”. *Gjurmime albanologjike – Seria e shkencave filologjike*, IX, 1979 (1980), f. 313.

<sup>6</sup> Jo rrallë në të dy këta fjalorë fjala titull shpjegohet së pari me një fjalë a shprehje shqipe e pastaj jepet fjala përkatëse greqisht a italisht.

shqiptare nuk ishte drejt kulturës së Perandorisë Osmane. Pse Kristoforidhi zgjodhi greqishten për fjalorin e vet e pse Shoqëria “*Bashkimi*” zgjodhi italishten, kjo çështje është e qartë<sup>7</sup>.

Përveç këtyre anëve të përbashkëta, këta dy fjalorë kanë edhe disa dallime.

Fjalori i Kristoforidhit është cilësuar si “*i pari fjalor me bazë të gjerë gjithëkombëtare*”, ndërsa fjalësi i fjalorëve të tjerë të botuar para pavarësisë “*mbështetet në njërin ose në tjetrin dialekt*”<sup>8</sup>. Kushdo që e ka përdorur sado pak Fjalorin e Kristoforidhit, ka vënë re se ai përmban fjalë nga gjithë trualli i shqipes si dhe nga autorët e vjetër që njiheshin atëherë (Budi, Bogdani). Për Fjalorin e “*Bashkimit*” është pohuar se “*është mbështetur në dialektin e Veriut*” dhe se “*përfshin një lëndë deri diku të zgjedhur*”<sup>9</sup>, se “*është i bazuar kryesisht në të folmen gegërishte... se ka më shumë rëndësi e karakter dialektor*”, por “*për kohën kur u botua, ka një pasuri mjaft të madhe fjalësh e frazeologjish*”<sup>10</sup>.

Edhe këto pohime në përgjithësi qëndrojnë. Megjithatë mendoj se të dy fjalorët ka nevojë të vështrohen më për së afërmi. Kristoforidhi duket se ka synuar të japë sa më gjerë visarin e fjalëve shqipe të gjuhës popullore dhe me këtë t’i shërbejë gjuhës së letrare që po lëvrohej. Në fjalorin e tij janë përjashtuar më një anë turqizmat<sup>11</sup>, e më anën tjetër edhe shumica e huazimeve të reja

<sup>7</sup> Për Fjalorin e Kristoforidhit shih shpjegimet e A. Xhuvanit te Parathania e tij, f. 7; për Fjalorin e Bashkimit shih gjithashtu Parathënien f. IX.

<sup>8</sup> Androkli Kostallari - Palok Daka, “Fjalorët e shqipes”, në: *Fjalor enciklopedik shqiptar*. Tiranë, 1985, f. 273.

<sup>9</sup> Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. ShBLU, Tiranë, 2002, f. 277.

<sup>10</sup> Shefkije Islamaj, Po aty.

<sup>11</sup> Lidhur me këtë çështje Aleksandër Xhuvani në Parathënien studimore të shkruar për ribotimin e Fjalorit, shprehet kështu: “*Ishte tendenca e shkrimtarëve tonë të vjetër e të Rilindjes që të përdorin vetëm fjalë shqipe tue kuptue me këte purizëm përjashtimin nga gjuha të fjalëve të hueja, sidomos*

kulturore<sup>12</sup>. Përjashtimi i të parave lidhet me qëndrimin e njohur të rilindësve ndaj fjalëve të huaja. Lënia jashtë e huazimeve të reja kulturore mund të shpjegohet me këtë që në kohën kur e hartoi Kristoforidhi (vitet '80 të shekullit XIX), ato nuk ishin të shumta dhe njerëzit e mësuar pak a shumë i kuptonin.

Shoqëria “*Bashkimi*” u nis nga realiteti gjuhësor, synoi të pasqyronte leksikon aktiv të kohës, fjalët që ishin në përdorim në ligjërimin e popullit analfabet, po edhe fjalë kulture, formime të reja ose huazime prej gjuhësh perëndimore. Për këtë arsye Fjalori i “*Bashkimit*” ka një numër të madh turqizmesh të shënuara me shkronjën *T*, por edhe sllavizma e italianizma, të shënuara përkatësisht me shkronjat *S* dhe *I*. Pra vërtet këto fjalë janë brenda në Fjalor, por njëkohësisht janë edhe të dalluara. Kjo dëshmon qëndrimin e autorëve të fjalorit ndaj tyre: *i përdorim, por duhet ta dimë se nuk janë tonat*. Prandaj autorët këshillojnë herë-herë të përdoret një fjalë a shprehje shqipe në vend të fjalës së huaj. Ja disa shembuj nga fjalët e shkronjës

**A: Agallëk** *madhnī, a, t'zgjâam-t; me çue agallëk; mâa mirë, m'u zgjâa*. dominare, far pompa; **Akllagī** *mā mirë cabih, u, petës, i; Ânzë, a, mâa mirë se anason; Arkaxhī, a, mâa mirë arktār, i, e arktare, ja*. cassaio, cassiere.

Ndryshe nga Fjalori i Kristoforidhit, që përmban fjalë e variante fjalësh si në toskërishte, ashtu edhe në gegërishte (p.sh. *gjarpënë – gjarpëna* dhe *gjarpërë – gjerpinj*), Fjalori i “*Bashkimit*” përmban vetëm format e gegërishtes (*gjarpën – gjarpni – gjarpij*).

---

*turqishte e greqishte. ...Me gjith'ate, gjinden pak fjalë turqishte e greqishte ndër ato fjalë të Fjalorit, jo mâ tepër se 20, të cilat ose i kanë shpëtue Kristoforidhit, ose e ka mendue se duheshin shtimë si mâ të përdorshme e të nevojshme.” (Po aty).*

Por autorët, për sa u takon fjalëve, i kanë kapërcyer kufijtë e gegërishtes dhe kanë marrë prej Kristoforidhit edhe greqizma krahinorë të Jugut, ndoshta pa e ditur. E tillë është p.sh. fjala *Aparjas*, atë, *me e m'u aparjat* – *me hjekë dorë*: levar mano; *me bjerrë uzdajen*: cader di speranza. Siç shpjegon E. Çabej, “kemi të bëjmë me një huazim krahinor nga greqishtja e re *apariaso* “heq mënjanë, veçoj; lë, heq dorë”.

“*Bashkimi*”, duke e marrë fjalën prej Kristoforidhit, e ka dhënë gabim paskajoren me formën *me aparjatë*, sajuar prej si me rrugë analogjike. Aoristi i kësaj foljeje të toskërishtes, në pajtim me burimin grek të saj, bën rregullisht *aparjasa*, pjesorja *aparjasur*.<sup>13</sup> Fjalë të tjera të tilla janë *akoma*, *anangas*, *m'u anangasë* “affrettarsi”, *peleqis* “digrossare, spianare”, metaf. “vindicare”, *stis* “fabbricare, costruire, creare”, *thron* “trono”. Edhe përfshirja e fjalëve *aili!* “ajme”, *apori* “dubbio”, *argali* “avlëmend”, *lipësi* “mëshirë” (greqizma të arbërishtes) ose e fjalëve si *i lartë*, *lartësi*, *lartësim*, *lartësoj* krahas *i naltë*, *naltësi*, *naltim*, *naltoj* të gegërishtes, dëshmon se autorët e kanë përdorur Kristoforidhin, kanë vjelë prej tij dhe prej burimesh të tjera të toskërishtes ato fjalë që u janë dukur të nevojshme, pra kanë kanë synuar për më gjerë se një fjalor të fjalëve të dialektit të Veriut<sup>14</sup>. Në Parathënie ata flasin shprehimisht “*për përparim t'giuhës komtare, n'trajtë t'shqyptimit t'Shkoders.*” (f. IX). Prandaj edhe te forma e paskajores *me aparjatë*, që përmendëm më sipër, dhe në raste të tjera të ngjashme mendoj se

---

<sup>12</sup>Xhevat Lloshi, “Fjalori i gjuhës shqipe i K. Kristoforidhit”, në: *Fjalor enciklopedik shqiptar*, 1985, f. 275.

<sup>13</sup>*Studime etimologjike në fushë të shqipes*. vëll II. f. 55 v.

<sup>14</sup>Megjithatë të bën përshtypje se huazimet nga greqishtja nuk janë shënuar, siç do të pritej, me shkronjën *G*. Ndoshta autorët nuk kanë mundur t'ua përcaktojnë gjithnjë burimin huazimeve nga greqishtja, prandaj i kanë lënë të pashënuara.



kemi të bëjmë me një ndërhyrje normëzuese e jo me lapsuse të rastit.

Ndryshe nga Kristoforidhi, autorët e Fjalorit të “*Bashkimit*” kanë përfshirë edhe një varg fjalësh të leksikut dituror, administrativ e teknik, ndër to edhe huazime e neologjizma, si p.sh. *adresë, arkiv, artikull, dializë, diastolë, dokument, elektriksi* “elektricitet”, *filolog, filologji, gramatikuër, kakofoni, mekanik, metaforik, metal, metatezë, methudë, politikë* etj.; *ansujë* “ishull”, *antar* “ithtar, ndjekës”, *avullore* “anije me avull”, *avullorsi* “flotë”, *buejtore* “bujtinë”, *çmim, damshpërblim, drejtvlerë* “equivalenza”, *i drejtvlershëm* “equivalente”, *dyshare* “çift-i”, *fjalorth, e folme, kryefjalë* “motto”, *kryepunë* “capolavoro”, *njofti* “nacion”, *qannruer* (qendror), *qytetnim, qytetnoj* (Kristoforidhi *qytetëzim, qytetëzoi*), *qinnark* (qindarkë), *shpallje* etj. Këtë drejtim të pasurimit të leksikut dituror e administrativ të shqipes do ta vijonte më pas Komisia Letrare. Në këtë vështrim Fjalori i “*Bashkimit*” mund të quhet fjalor i shqipes së shekullit XX, i pragut të Shpalljes së Pavarësisë.

Fjalorit të “*Bashkimit*” i është vënë në dukje si e metë mungesa e thënieve që të tregojnë jetën e gjallë të fjalës. Në një recension të botuar në vitin 1911<sup>15</sup> Aleksandër Xhuvani i qorton autorët e fjalorit se më të shumtat e fjalëve që nuk gjenden te Kristoforidhi, “ashtu si janë shkruem e përkthym, nuk mund të merren vesh e të përdorohen prej çdo njeriu. Auktorët e Fjalorit janë kufizuem vetëm në përkthimin e këtyne fjalve me fjalët italishte qi i përkasin, pa i përcjellun kto me shemblla, me frazë ashtu si përdorohen në gjuhët, në mënyrë që një që nuk i din këto fjalë nga dhialekti i vet, a nuk i ka ndëgjuem prej ndokuj, apo nuk i ka hasun andej e këtej nëpër librat, nuk mund t’i shtjerë në punë e t’i

---

<sup>15</sup> Ribotuar në: Aleksandër Xhuvani, *Vepra II*. Akademia e Shkencave e RPSSH. Tiranë, 1990, f. 22-25.

përdorojë për nevojat e tij.” (f. 22). Por ai ka shpresë se autorët “do t’i marrin ndër sy” vërejtjet e tij kur ta ribotojnë, kështu që Fjalori i “*Bashkimit*”, “tue u përmirsuem e tue u shtuem gjithnjë, të zajë vendin e nji Fjalori Akademik në gjuhën tonë.” (f. 25).

Pra, këta dy fjalorë, i Kristoforidhit dhe i “*Bashkimit*”, mund të shikohen si plotësues të njëri-tjetrit (komplementarë), pasi në Fjalorin e Kristoforidhit, sipas përshtypjes sime, leksiku i trevave veriperëndimore përfaqësohet më pak. Ashtu si Kristoforidhi edhe autorët e “*Bashkimit*” kanë nxjerrë fjalë prej shkrimtarëve të vjetër, Budi, Bardhi, Bogdani; autori i katërt që kanë pasur parasysh ata është Kristoforidhi (shih f. XVI *Emnat e auktorëve*). Të bën përshtypje pse nuk kanë përmendur autorë fjalorësh të tjerë. Në Parathënie përmendin edhe Gustav Meyerin e Jak Junngun, por nuk i kanë shënuar më tek fleta me *Emnat e auktorëve*. Më tej autorët shkruajnë se “fjalët e qituna rishtas e t’përbame” i kanë lënë “për nji tjetër t’shpallun mâa t’peshuem”. Kjo tregon se kanë pasur dhe lëndë tjetër të mbledhur, por nuk kanë qenë të bindur nëse meritonte të hynte në fjalor, prandaj e kanë lënë për ta peshuar më mirë.

Do të ishte me interes një krahasim i plotë i Fjalorit të “*Bashkimit*” me Fjalorin e Kristoforidhit nga ky vështrim. Në ngushticën e kohës për këtë kumtesë, kemi krahasuar vetëm shkronjën A, e cila te Fjalori i “*Bashkimit*” përfshin 390 fjalë dhe 35 fjalë te Shtojca, pra gjithsej 425 fjalë. Nga këto 87 janë me burim nga turqishtja, ndërsa 94 i ka edhe Fjalori i Kristoforidhit<sup>16</sup>. Po t’i grupojmë sipas sferave kuptimore fjalët që ka më shumë “*Bashkimi*”, na del kjo pasqyrë:

**Jeta sociale e administrative, sfera e kulturës: abetar, adër (me**

---

<sup>16</sup> Te Shtojca nuk ka asnjë fjalë të shënuar si turqizëm dhe asnjë fjalë që gjendet edhe te Kristoforidhi.

*thye adra chacherare), i adhruem, adhruemit (t'), adhrueshëm (i), afat, agor-i, amël (me bâa amël “me u heshtë, me u vullnnesue, me vërtetue” it. provare, aderire, confermare), amëlcim, amëlsi, amëltim, amni (Bog.) “maternita”, amshtë e amtë “në humor të keq”, i amshtë, amshtik, amt-i, i amtë, amti-a “inerzia”, anak-u “serto”, anas “indigeno”, andërrtar, ankesë, ankim, ankoj, ankth, i ankueshëm, anmiksoj, i anmiksueshëm, antar, aradhe, me aradhue “schierare”, ardhacak, argtim, i argtueshëm, arkivi-a “archivio”, arkivol, arktar, armë, artikull “nye, neni, articolo”, i asnjanshëm “neutrale”, asnjansi “neutralità”, asnjanzë “neutro”, ashari, atdhe, atme, atmetar, atmetuer, atmi “patriotismo”, auktori “autorità”, auktoroj “autorizare”, auktuere “autore”, avan “tiranno”;*

**Sfera fetare:** *abaci, abat, apostollik, apostollim, apostolluer, arkidoqez-i, arqipeshkv, arqipeshkvi;*

**Dukuri të natyrës:** *acar (ujë ~), aft-i, ag-u, agim-i, agon, aguemit (t'), agullim-i, ajrii-a, akullim-et, akulluemit (t'), avër;*

**Trupi i njeriut e i kafshëve, njeriu në përgjithësi:** *ajasmë-t<sup>17</sup> (shytat), ajem, ajmit (t'), angur, anikare “sëmundje e mitrës”, arc e arç<sup>18</sup>, artere, ashtnim “ossatura”, avrapë-t;*

**Marrëdhënie hapësinore:** *afërshëm (i), afërtinë, afrim, afris (fol.), afritun (i, e, t'), afruemit (t'), afrueshëm (i), andejë-a, i andejm, i andeshëm, atjehe “la parte di la”, atypari, i atyshëm; e kohore: atbotë, i atbotshëm, i ardhshëm;*

<sup>17</sup> Është përfshirë në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (1954), por jo në fjalorët shpjegues pas tij (1980, 1984, 2002, 2006); është vënë si sinonim krahinor të emri *shyta-t* në “Fjalorin sinonimik” (Red. J. Thomai, 2004); e jep edhe S. Mann në Fjalorin historik si fjalë të Veriut.

<sup>18</sup> Për këtë fjalë jepen kuptimet: *nuca* “zverk, arrëza e qafës”, *grillo* “bulkth”, *talpa* “urith”; kuptimin e parë e jep FGjSh të “arrç”; mbetet për të hetuar për kuptimin e dytë e të tretë.

**Bimë e gjallesa:** *anzë* (maâ mirë se anason), *arashkë* “rapa”, *arishte* “sorte di erba”, *arnêe-ni*, *ashkëz*, *ashtë* “pyll ahesh”; *allore* (lloj peshku);

**Mjete pune, lëvizjeje etj.:** *aksue-aksoi* “bosht” (i karrocës, i qerres); *almice*, *argësh*, *avllani* e *avullore* (“avullanije”)

**Sfera e veshmbathjes:** *acar-i*, *armaç-i*.

Po të bëhet kjo punë për gjithë fjalorin, do të kemi një pamje më të plotë.

Dihet se Fjalori i “*Bashkimit*” ka shërbyer si burim e si mbështetje për fjalorë të tjerë të mëvonshëm. Nga sa kam dëgjuar nga autorët e “Fjalorit të gjuhës shqipe” (1954), ata kanë pasur si mbështetje kryesore Kristoforidhin, “*Bashkimin*”, Gazullin dhe Pano Tasen. Është gjithashtu me interes të hetohet se cilat fjalë të “*Bashkimit*” janë përfshirë te “Fjalori i gjuhës shqipe” dhe si janë shpjeguar.

Një dallim tjetër ndërmjet Fjalorit të “*Bashkimit*” e të Kristoforidhit ka të bëjë me ribotimet e tyre. Fjalori i Kristoforidhit u ribotua, siç shënohet në ballinë, i transkriptuar me alfabet shqip dhe i përpunuar prej A. Xhuvanit. Fjalori i “*Bashkimit*” është ribotuar, ose më mirë rishtypur në formë anastatike me një tirazh prej 3000 copësh (nuk e dimë sa ka qenë tirazhi i parë). Duhet t’u jemi mirënjohës atyre që e bënë të mundshme këtë rishtypje, e cila i dha një jetë të dytë këtij fjalori, pasi ishte bërë shumë i rrallë. Tani duhet një botim i ri, filologjik e kritik, që të zbulojë më mirë përmbajtjen dhe vlerat e tij. Në këtë botim, së pari, do të zbatohet alfabeti i sotëm dhe fjalët do të renditen sipas këtij alfabeti, zanoret dyfishe do të shkruhen me një vizë lart si shenjë gjatësie, do të vihen theksat; së dyti, do të përdreshin shkurtime të sotme gramatikore; së treti, do të tërhiqej vëmendja e lexuesit me shënime në fund të faqes për gabimet e shtypit ose për shpjegime të gabuara të fjalëve,

si ato që ka vënë në dukje Karl Gurakuqi në artikullin e botuar në “*Shêjzat*” me rastin e 50-vjetorit të Fjalorit dhe të ribotuar te “*Phoenix*” (1998, nr. 3-4)<sup>19</sup>; së katërti, fjalët e “*Shtojcës*” do të shkonin te shkronjat përkatëse në trupin e fjalorit; së pesti, do të viheshin shënimet e nevojshme filologjike e kritike për të sqaruar më mirë kuptimin e fjalës.

Puna për këtë ka filluar për një punim magjistrature nga zonjusha Dorianë Tuxhari. Ajo do të shkruajë një tezë për përmbajtjen e Fjalorit të “*Bashkimit*”, për fushat kuptimore të tij dhe pasurinë e tyre. Por për këtë po tejshkruan me alfabetin e sotëm krejt fjalorin. Në këtë mënyrë familjarizohet me të, mëson fjalët e kuptimet e tyre dhe mendon për to, nxjerr probleme për vete dhe për mua. Kur të jemi të bindur se kemi bërë atë që duhet, do të trokasim në dyert e botuesve. *Trokullini e juve t’u jetë nçelë* – thotë Buzuku!

---

<sup>19</sup> Ndër të tjera K. Gurakuqi shkruan: “Ndonji gabim u ká rrëshqitë edhe përpiluesvet të “*Bashkimit*”, por këto janë gabime të falshme, qi mund të qortoheshin në botimin e dytë. Jemi të sigurtë se edhe atyne do t’u jetë rá në sy gabimi i faqes 113, ku fjalës *fnyell* i jepet kuptimi i këpuctarit, kurse don me thânë “biz” ase “feme”; gjithashtu fjala *gjetkëz* nuk e ká kuptimin “campo di patate” (marrë qui pro quo nga Kristoforidhi), por “vend ku mbyllen patat”; do t’a kenë vû ré se fjala *hamurik* (f. 152) nuk don me thânë “fame”, por “talpa”; po, do të kenë vrejte, se fjala *këlcatës* nuk i përgjigjet fjalës italishte “cagnolino”, por fjalës “schizzetto”, qi në Shkodër i thonë *pushkaliqe* e në ndonji krahinë tjetër: *këllcacë, stërfyc, stërlagës, stërkitës*, etj.” (f. 62).

**Enver HYSA**

**LARMIA E MJETEVE DHE E TIPAVE  
FJALËFORMUES TE FJALORI I SHOQËRISË  
“BASHKIMI”**

Në historinë e leksikografisë shqiptare, por edhe të gjuhësisë shqiptare përgjithësisht, botimi i Fjalorit të shoqërisë Bashkimi me titull “Fjaluer i ri i shqipes përbam prej shoqnit “Bashkimi”” në Shkodër, një shekull më parë, më 1908, shënon një ngjarje shumë të rëndësishme kulturore për Shqipërinë e asaj kohe.


Po të marrim parasysh kohën kur u botua, mund të thuhet se ai përbën një gur themeli në ngrehinën e gjuhësisë shqiptare.

Me ndihmesën e dhënë për gjuhën e kulturën shqiptare në fillim të shekullit XX shoqëria “Bashkimi” e Shkodrës, themeluar me nismën e abatit të Mirditës, Preng Doçit, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm. Ndër botimet e shumta që bëri, pasi hartoi fillimisht alfabetin e saj, një vend shumë të rëndësishëm zë *Fjalori* i saj me një numër relativisht të madh fjalësh.

Lënda e përfshirë në këtë vepër, e cila për nga vlera dhe rëndësia që ka, qëndron krahas Fjalorit të F. Bardhit dhe atij të K. Kristoforidhit, paraqet sigurisht jo tërë pasurinë leksikore të shqipes, por sidoqoftë, sot pas një shekulli, na jep mundësinë të gzykojmë për gjendjen e gjuhës shqipe përgjithësisht e të leksikut të saj veçanërisht në fillim të shekullit XX. Vepra na jep dorë kështu për studime të shumanshme gjuhësore, fonetike, dialektore,

gramatikore, leksikore, semantike, fjalëformuese etj. Studimet në të gjitha këto aspekte do të krijonin mundësi për të pasur një pamje më të plotë tipologjike të shqipes së fillimshekullit XX.

Në këtë kumtim të shkurtër në përkujtim të 100-vjetorit të botimit të Fjalorit do të ndalem fare shkurt në vështrimin e lëndës së



këtij Fjalori në aspektin fjalëformues, duke synuar të vë në dukje larminë e mjeteve dhe të tipave e mënyrave fjalëformuese të fjalëve të pasqyruara në vepër.

Për një kumtesë të shkurtër si kjo nuk është e nevojshme të shfletosh gjithë fjalorin për të vënë në dukje pasurinë e mjeteve dhe e tipave fjalëformues, sipas parimit që nuk është e domosdoshme të pish gjithë fuçinë për të provuar cilësinë e verës.

#### ***A. Preng Doçi***

Nga një vështrim i përgjithshëm i disa shkronjave mund të pohohet që në fillim se leksiku i përfshirë në këtë vepër, edhe pse në një numër relativisht të kufizuar fjalësh, rreth 14 000 fjalë, në aspektin fjalëformues paraqitet i larmishëm. Kështu aty dëshmohen dy tipat themelorë të fjalëformimit, prejardhja dhe kompozimi me një lëndë përgjithësisht të pasur për shkronjat e marra në shqyrtim. Natyrisht që duke vlerësuar në mënyrë të veçantë formimet me

ndajshtesa, do të theksojmë se, ashtu si në shqipen e sotme, formimet me parashtesa janë më të pakta sesa ato me prapashtesa, jo vetëm pse numri i tyre është më i vogël se i prapashtesave, por edhe sepse denduria e përdorimit të tyre nuk është aq e lartë dhe nga ana tjetër tipat fjalëformues me parashtesa janë më të kufizuar sesa tipat fjalëformues me prapashtesa. Kujtojmë këtu, p. sh., larminë e temave fjalëformuese me të cilat bashkohen prapashtesat dhe njësitë e reja që dalin nga kjo lidhje.

Mund të pohojmë paraprakisht që në këtë Fjalor janë pasqyruar gjerësisht formimet me parashtesat *për-* dhe *pa-*, që formojnë gjegjësisht një numër të konsiderueshëm foljesh dhe mbiemrash, më rrallë dhe emra. Po sjell këtu pak nga fjalët e shumta të formuara me parashtesën *për-*, që dalin në Fjalor, si *përanem*, *përbaltem*, *i përbashkët*, *përbej*, *përbetoj*, *i përhapshëm*, *përçoj*, *përçudnoj*, *i përçudshëm*, *përdaj*, *përdieg*, *përdiers*, *përdredh*, *përuroj*, *përfaq* (*esternare*, *manifestuare*), *i përfaqshëm*, *përfalet*, *përflak*, *përflas*, *i përfushtë*, *përfys*, *përgiaj*, *përgjak*, *përhimnoj*, *përshosh*, *përkthjelloj*, *përlëpij*, *përleshem*, *përmjalti*, *i përmorttë*, *i përmkatnuem*, *përpajnoj* (*propagginare*), *përpall*, *përs huej*, *përs hkoq*, *përs hoqnoj*, *përs hpirit*, *i përs hpiritshëm*, *përthij*, *përvnerem*, *i përzjarrshëm*, *përlëvdoj*, *përligj*, etj. Siç mund të vihet re lehtë, në shumicën e këtyre shembujve kuptimi themelor që u jep temave fjalëformuese kjo parashtesë është kuptimi intensiv i veprimit ose kuptimi i një tipari të një cilësie më të lartë se ajo që emërton mbiemri si temë fjalëformuese.

Nga formimet me parashtesën *pa-* dalin në Fjalor njësi të tilla, si: *i pabedisshëm*, *pabesni*, *padekni*, *padeksoj*, *i padijshëm*, *i paditëshëm*, *i padhimshëm*, *pafuqi*, *i pagabueshëm*, *i pagjashëm*, *i pagratshëm*, *i pagjinishëm*, *i panjohshëm*, *i panjoftun*, *pahijeshi*, *i pahile*, *i pahumbshëm*, *i pakrye*, *i pamen*, *i pamirë*, *i panafakë*, *i*



*pangishëm, i panjerëzishëm, i papashëm, i paprintueshëm, i parrfyem, i paskajuem, e paxanë, i pasherr, i pashpirt, i patentzonë, i paudhë* etj. Në të gjitha formimet me këtë parashtesë duket qartë kuptimi privativ, mohues, që u jep ndajshitesa fjalëformuese fjalëve të prejardhura. Rregullisht si tema fjalëformuese për formimet me parashtesën *pa-* shërbejnë tema mbiemërore e më rrallë edhe tema emërore e foljore.

Ajo që do të dëshiroja të vija në dukje për formimet me parashtesën *për-*, por sidomos për formimet me *pa-*, është fakti që në Fjalor parashtesat *për-* dhe *pa-* shkruhen gjithnjë bashkë me temën fjalëformuese dhe asnjëherë veçan ose me vizë në mes. Me interes do të ishte të ndiqej praktika gjuhësore e botimeve të Shoqërisë “*Bashkimi*”, si në veprat letrare, fetare, e në tekstet shkollore për të parë nëse një praktikë e tillë shkrimi ishte e ngulitur vetëm në Fjalor apo dhe në botime të tjera. Lëkundje në shkrimin e njësive të formuara me këto parashtesa, sidomos me parashtesën *pa-* vihen re jo rrallë edhe në praktikën e sotme gjuhësore.

Në kuadrin e formimeve me ndajshitesave, duhet vënë në dukje se, ashtu si në shqipen e sotme, dhe në Fjalorin e Bashkimit mbizotërojnë fjalët e formuara me prapashtesa, të cilat janë më të shumta në numër dhe më të larmishme në kuptimet që u japin temave të ndryshme fjalëformuese me të cilat lidhen. Në shkronjat e analizuara nergut për këtë qëllim dalin prapashtesat: *-o, -os, -no, -ro, -so, zo, -to, is* që hyjnë në punë për të formuar folje, si: *qerthulloj, valloj, darkoj, drekoj, firoj, gropoj, piloj, plaçkoj* etj. formuar me prapashtesën *-o* si prapashtesa më prodhimtare në sistemin fjalëformues të foljes edhe në shqipen e pas një shekulli, ose folje si *palos, fundos* (me prapashtesën *-os*), *fatbardhsoj* (me prapashtesën *so-*), *damtoj* (me prapashtesën *-to*), *flakroj* (me prapashtesën *-ro*), etj.

Nuk mungojnë në Fjalor emrat abstraktë të cilësisë ose emrat kolektivë të formuar me prapashtesat përkatëse *-i, -si, -ni, -ri, -ti* në fjalë si: *çmeni, djali* (edhe si emër kolektiv për *dielmëni, djalëri*), *dorxani, dredhi, xhakoni, famulli, foshnji, freski, pekuli, mjeki, gogësi, gjuhësi, dekni, dituni, fmini, fratni, grani, pafajni, funrri, flliqt, flligshi, pjesëti* etj. Po ashtu del një numër bukur i madh emrash abstraktë veprimi të formuar me prapashtesat *-im, je(ie)* e *-esë*, si *damkim, dëshim, dishrim, dredhim, dyzim, freskim, gënjim, grimcim, parashtim, përanim, përftim, përhenim, përimitim; përkulie, përbartie, pannehie; dërgesë, fillesë, pengesë, pennesë, pritesë* etj. Është vendi të theksoj se, krahas emrave abstraktë të formuar me prapashtesat e mësipërme, të cilët po të krahasohen me botimet e shekullit XIX, sigurisht që janë rritur në mënyrë të ndjeshme, dalin dhe një numër jo i vogël emrash prejfoljorë abstraktë të formuar nga paranyjëzimi i pjesoreve, si *t'çmuemit, t'çmenunit, t'damit, t'damunit, t'dalldisunit, t'damtuemit, t'daritunit, t'darkuemit* etj., çka tregon se formimet e këtij tipi ishin ende mjaft të gjalla edhe në fillim të shek. XX, jo vetëm në gjuhën e shkruar, si e dëshmon dhe Fjalori i Bashkimit, por me siguri dhe në gjuhën e folur, po të kemi parasysh pohimin e parathënies së Fjalorit se në të pasqyrohet një thesar i madh “fjalësh shqype prej gjith anësh”, të mbledhura, si shkruan gazeta “Albania” e F. Konicës, jo vetëm “prej njëres a tjetres të folme, por prej të gjitha të folmeve, duke u mbështetur në parimin e drejtë shkencor, sipas të cilit leksiku i shqipes është pasuri e përbashkët kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektor”. (Shih M. Samara).

Pa u zgjatur shumë, do të shtoj se ka dhe prapashtesa të tjera që formojnë emra me përmbajtje semantike të ndryshme, si prapashtesat *-ar / -tar, -nik, -ishtë, -sinë, -icë, -aç, -ushë, -eshë, -li, -xhi-/ -çi*; mbiemra, nga të cilat do të përmendja prapashtesat *-shëm*,

si më produktiven, *-të, -(ë)s, -m, -tuer, -uer*, që formon dhe mbiemra dhe emra, të cilët në trajtën e shquar, ose në gjininë femërore grupin *ue* e mbledhin në *o*, p.sh. *malcuer / malcori, damtuer / damtore, dimnuer / dimnore* etj., prapashtesa që formojnë ndajfolje, si prapashtesa *-isht*: *jahudisht, demelisht, fminisht, folmarnisht (grammaticalmente)* etj., prapashtesat *-thin* e *-as* në fjalë si *fluturimthin, peshimthin, pikalarthin; doras, dredhas, giamas, giuias, pakujtuemas, pitas, damas* etj. Dua të tërheq vëmendjen këtu veçanërisht për prapashtesën *-shim* që del në klasën e ndajfoljeve, në njësi të tilla si *gulshueshim, pahieshim, përgjumshim* etj. Përgjithësisht, nga sa kam vënë re, në këtë Fjalor ka një përpjekje për të bërë një dallim ndërmjet prapashtesës *-shëm* që është përdorur për të formuar mbiemra dhe variantit prapashtesor *-shim* që është përdorur për të formuar ndajfolje. Le të kujtojmë këtu se kjo prapashtesë te Buzuku del në variantin *-shim*. Ky konstatim që del nga njësitë e shqyrtuara është ndoshta një përpjekje e ndërgjegjshme për të bërë këtë diferencim, ku mbiemri del me prapashtesën *-shëm* si te *i pahijshëm* dhe ndajfolja me prapashtesën a variantin prapashtesor *-shim*, si te *pahieshim*. Është me interes të ndiqen formimet e këtij tipi në të gjithë Fjalorin, për të parë nëse ky rregull përfshin të gjitha formimet paralele mbiemërore e ndajfoljore me këtë prapashtesë.

Në Fjalor nuk mungojnë dhe kompozitat e tipave të ndryshëm, si: *dashamirë, dorëdhan,-i, dorëshkresë (manoscritto), dorëcung, dorxanë, dredhalesh, fatmirë, fatzi, feelshues, ferrëbardhë, folmarme, gjuhëfshirë, goilashtë, grykakuq, peshkujë (për pishinë), pjesëbas* etj.

Duke përfunduar do të theksoj se lënda e përfshirë në këtë Fjalor meriton një shqyrtim të imtësishëm në shumë aspekte. Këtu vetëm sa u prekën disa çështje të formimit të fjalëve, të cilat duhen

thelluar më tej në studime e artikuj të ndryshëm. Vepra që Shoqëria “*Bashkimi*” i dha një shekull më parë lexuesit shqiptar, përveç rolit shumë të rëndësishëm që ka luajtur deri sa gjuha shqipe të niste vargun e fjalorëve shpjegues me Fjalorin e 1954-s, ruan dhe sot vlera të padiskutueshme që meritojnë vërtet të bëhen objekt i veçantë studimesh, duke përgatitur për të teza doktorate e tema diplomash me studentët e filologjisë shqiptare.

## FJALORI I SHOQNISË “*BASHKIMI*” DHE ETIMOLOGJIA E SHQIPES

Çdo vepër që botohet, mban vulën e kohës, por ka vepra që i kapërcejnë kufijtë e saj. I tillë është Fjalori i Shoqnisë “Bashkimi”, i botuar para 100 vjetësh, që doli në dritë kur shqiptarët nuk kishin ende shtet të tyre, për më tepër nuk kishin as alfabet të përbashkët për të shkruar gjuhën shqipe; megjithatë, kjo vepër ngrihet mbi nivelin e kohës duke mbetur njëri nga fjalorët më të mirë që u shkruan deri më sot. Në shqyrtimin e fjalësit të tij duket qartë puna e madhe hulumtuese për të nxjerrë në dritë shumë fjalë të rralla, fjalë të shqipes, të hartuara me brumin dhe mjetet e saj. Mjafton lista e emrave të autorëve që janë hulumtuar, si: Frang Bardhi, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Gustav Meyeri, Konstantin Kristoforidhi, Jakë Jungu, si edhe librat, fjalorët dhe shkrimet e dijetarëve tanë e të huaj, për t’i dhënë këtij Fjalori vlera të veçanta në leksikografinë shqiptare. I hartuar si një fjalor dygjuhësh, ai ka shërbyer jo vetëm si i tillë për qëllime didaktike, por shpjegimet e dhëna në gjuhë të huaj janë diçka më tepër se përkthimi i fjalës, meqenëse në to jepen shpjegime të hollësishme duke e bërë atë në të njëjtën kohë edhe një fjalor me pretendime shpjeguese, ndër të parët e këtij lloji. Madje, duke vënë përbri huazimeve më të përdorshme burimin e tyre, nga italishtja, gjuhët sllave a turqishtja, ai merr edhe vlerat e një fjalori etimologjik. Por kontributin më të madh në këtë drejtim e japin fjalët e rralla që janë përdorur, kuptimet e tyre të shumta dhe format e veçanta, disa prej të cilave kanë dalë jashtë përdorimi në shqipen e

sotme, por janë regjistruar në këtë fjalor, duke dhënë kësisoj një ndihmesë të çmueshme për studimet etimologjike. Le të japim disa shembuj.

Emrin *ankth* dhe mbiemrin *i angësht* me kuptimin “i ngushtë”, që janë fjalë të trashëguara, e kanë burimin te një rrënjë *ang*, e cila në shkallë indoeuropiane lidhet me lat. *angustus* dhe me gjerm. *eng*.<sup>20</sup> Rrënjën *ang*, indoeuropiane lidhet me lat. *angustus* dhe me gjerm. *eng*.<sup>21</sup> Rrënjën *ang*, që është më e hershmja, nuk e kanë



*D. Dodë Koleci*

fjalorët e shqipes së sotme. Ajo mungon madje edhe në studimet etimologjike të Çabejt, i cili me mprehtësinë që e karakterizonte, arriti në ekzistencën e saj duke shënuar se *angësht* është rrjedhojë e një primitive *ang*.<sup>22</sup> Por këtë rrënjë e ka Fjalori i Bashkimit (f.23), i cili e shënon për “incubo”, me shënimin “s’ka shumuer”, që do të thotë s’ka formë shumësi.

Emrat *kallëz* e *kallinj*, janë dy

<sup>20</sup> Sh. për këtë grup fjalësh, Alois Walde-Julius Pokorny, *Vergleichendes Wörterbuch der indogermanischen Sprachen*, herausgegeben und bearbeitet von J. Pokorny I. Berlin – Leipzig; 1930, 60.

<sup>21</sup> Po aty, f. 60.

<sup>22</sup> Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II*, Tiranë, 1976, 50 v.; sh. edhe B. Demiraj, *Albanische Etymologien*. Amsterdam, 1997, 79.

forma shumësi, të krjuara me prapashtesat *-zë* e *-inj*, duke nënkuptuar një formë njëjësi *kall*, të pashënuar ndër fjalorë të shqipes. Këtë emër, që lidhet me gjermanishten e lartë të vjetër *hulis* me kuptimin “ferrë”<sup>23</sup>, e ka Fjalori i Bashkimit te zëri *bokë* në shpjegimin “*käll i kollomoqit i pā kokrra*” (f. 47), si edhe te zëri *brumak* në shpjegimin “*i thohet kallit t’kallamoqit t’dobë*” (f.53).

Emri *brisk* në studimet etimologjike është shpjeguar me të drejtë nga emri *brinjë*, në mbështetje të faktit se deri vonë brisqit e xhepit janë ndërtuar me lëndë të britë.<sup>24</sup> Ky shpjegim gjen një mbështetje të re në Fjalorin e Bashkimit, i cili shënon emrin *briskë* për “*pecora cornuta*” (f.52) “dele brinoçe”, që e ka marrë emrin nga brirët e saj, duke u lidhur kështu *brisk*-u me *brirët*.

Emri *lagje* sot përdoret me kuptimin “pjesë e një qyteti ose e një fshati”, por në gjuhë të tjera kjo fjalë del edhe me kuptime të tjera, si p.sh., në greqishten *lóhos*, që ka kuptimin “pusi, pritë, çetë e armatosur”.<sup>25</sup> Nga dy kuptimet kryesore, ai i vendit dhe i grupit të njerëzve, ndërsa i pari ruhet në shqipen e sotme, i dyti del në Fjalorin e Bashkimit (f. 222), që për këtë fjalë ka kuptimet “*torma, partito, gruppo, contrada*”, “*turmë, parti, grup, rrugë*”. Kjo pasuri kuptimore e fjalës së shqipes e afron më shumë atë me gjuhët që e kanë ruajtur këtë fjalë, duke ndihmuar edhe vendosjen e saj pranë gjuhëve të tjera të familjes indoeuropiane.

Për emrin *çfurk* Fjalori jep kuptimin “*specie di serpente molto velenoso*”, “lloj gjarpri shumë helmues”. Kjo fjalë që nuk

---

<sup>23</sup> Gustav Meyer. *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*; Strassburg, 1891, 168; Nobert Jokl, *Beiträge zur alb. Grammatik 3. Der Akkusativ - Nominativ und der Geschlechtwechsel im Albanischen*, Indogermanische Forschungen 36, Strassburg-Berlin, 1915, 124.

<sup>24</sup> Çabej SE II 327.

<sup>25</sup> Sh. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*; Studime filologjike 2, 1964, 12.

është regjistruar në fjalorët e sotëm dhe as në shpjegimet etimologjike, lidhet me *cfurk*, me të cilën është emërtuar edhe hagrepi, duke nënkuptuar për këtë thumbin e tij, kurse për gjarprin pickimin. Buzuku nga e njëjta rrënjë ka *tfurk* për “hagrep”; p.sh.: *O t i lypnjë voenë, e aj t i ndenjë tfurkthinë?* (LXVIII/2b=LXXVIII/2b).

Emri *përpeq*, që Fjalori i Bashkimit e jep për “torta fatta con latte, ova, ecc.”, “tortë e bërë me qumësht, vezë etj.” (f.340), nuk është trajtuar në studimet tona etimologjike. Emri i këtij qumështori me një petë, që bëhet zakonisht për festën e Pashkëve, është formuar nga parashtesa *për-* dhe rrënja *peq*, që lidhet me foljen *pjek*, meqenëse kjo lloj embëlsire piqet në një tepsi. Bashkëtingëllorja qiellzore në vend të grykores shpjegohet me ndikimin e formave që dalin me një fonemë të tillë te kjo folje, si: forma joveprore, mënyra urdhërore etj. Madje, kjo bashkëtingëllore ka qenë edhe faktori i zhdukjes së bashkëtingëllores *-j-*, me një proces asimilimi në shkallën zero, meqenëse janë krijuar dy bashkëtingëllore qiellzore në të njëjtën rrokje, që krijojnë vështirësi në shqiptimin e fjalës.

Emërtimin *gūr kalit* Fjalori i Bashkimit (f.36) e jep si sintagmë të emrit *gur* për “solfato di rame”, “sulfat bakri”. Me këtë emër njihet një lëndë kimike, që përdoret zakonisht për spërkatjen e hardhive. Shtrohet pyetja”: ç’lidhje ka ky lloj guri me kalin? Në të vërtetë, asnjë lidhje gjenetike, por vetëm një lidhje gjuhësore të rastit, sepse ky lloj guri, nga ngjyra e tij, është emërtuar *gur i kaltër*, por me etimologji popullore mbiemri *i kaltër* u kuptua si *i kalit*, meqenëse fjalët kanë ngjashmëri fonetike me njëra-tjetrën, për këtë arsye ai quhet sot *gur kalit*.

Fjalori shquhet për pasuri të madhe formash të fjalëve, gjë që jep mundësi të shumta për shpjegimin e burimit të tyre. Të tilla janë për shembull format që ka ky fjalor për emrin “mëngjes”, si: *mjes e mgjes* (f.266). Duke i krahasuar këto forma me atë më të plotën,



*mëngjes*, duket qartë se të dyja këto kanë dalë prej dukurive fonetike të shkaktuara nga rënia e zanores së patheksuar -ë-, gjë që ka vënë pranë njëra-tjetrës dy a tri bashkëtingëllore. Trajta *mgjes*, që e ka edhe Fjalori i Gazullit për “mëriz”<sup>26</sup>, ka dalë nga rënia e bashkëtingëllores hundore të trajtës së plotë *mëngjes*; kurse trajta *mjes*, që ka përhapje më të gjerë edhe në të folme të tjera, është formuar nga shkrija e grupit -ngj- të formës *mëngjes* në sonanten hundore-qiellzore -nj- (dukuri e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore), si edhe shndërrimin e kësaj të fundit në -j- nga ndeshja me bashkëtingëlloren m- të ballit të fjalës.

Një rrugë afërsisht të tillë ka ndjekur një fjalë tjetër që dëshmohet në këtë Fjalor. Emri *mëngjille* me kuptimin “agjërimit, mosngrënie e mishit, qumështit etj.” (f. 264), që burimin e ka nga lat. *vigilia*<sup>27</sup>, meqenëse agjërimet bëhen në prag festash fetare. Në Fjalor emri del me trajtat *mnjille* e *mgjille*, të cilave mund t’u shtohet edhe një trajtë tjetër, *mille*, që është e gjallë në ditët e sotme në qytetin e Shkodrës. Këto trajta janë krijuar njëlloj sikurse ato të emrit *mëngjes*, si rrjedhim, *mnjille* ka dalë nga asimilimi i grupit bashkëtingëllor -ngj- në -nj-; trajta *mgjille*, që i përgjigjet formës *mgjes* nga *mëngjes*, ka dalë nga rënia e sonantes -n-; kurse trajta e sotme *mille* është krijuar njëlloj si *mjes*, por këtu, pas shndërrimit të grupit bashkëtingëllor -ngj- në -nj- dhe më tej në -j-, kjo e fundit ka rënë, meqenëse ndodhej në afërsi të zanores -i-, me të cilën ka ngjashmëri nyjëtimore.<sup>28</sup>

Mbiemrin *i bryshëm* Fjalori i Bashkimit e jep me kuptimin

<sup>26</sup> Nikollë Gazulli, *Visaret e Kombit*, vëllimi XI, Fjalorth i Ri, Tiranë, 1941, 265.

<sup>27</sup> G. Meyer EW 273, Haralambie Mihaescu, *Les éléments latins de la langue albanaise.*; Revue des études sud-est européennes. Bucaresti, 1-2, 1966; 32.

<sup>28</sup> Sh. për këtë dukuri Kolec Topalli, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, 217 v.

“pemë qi çilin kadalë prej ndo’i lingatet (f.53). Kjo fjalë e rrallë, që nuk është përfshirë në fjalorët e sotëm, mungon edhe në studimet etimologjike. Mbiemri duket i formuar me prapashtesën *-shëm* nga folja *brydh*, prej së cilës është formuar me tjetër prapashtesë mbiemri *i brydhët* me kuptimin “i njomë, i butë, i thyeshëm”, që për Malësi të Madhe Çabej e jep me kuptimet e gjermanishtes *mürbe*, *weichlich* “i kalbur, i brishtë”. Te *i bryshëm* bashkëtingëllorja ndërthembore ka rënë para fërkimores *-sh-* të prapashtesës.

Mbiemri *i bushëm*, që ka ky Fjalor (f.58) nuk është pasqyruar në fjalorët e sotëm të shqipës dhe as në studimet etimologjike. Kuptimi që jepet në Fjalorin e Bashkimit, “*robusto*”, na bën të mendojmë se rrënja e fjalës është emri *bush*, me të cilin emërtohet “shimshiri”, lat. *Buxus sempervirens*, të cilit i është shtuar prapashtesa *-m*. Bushi a shemshiri njihet si dru i fortë, i qëndrueshëm, prej të cilit bëhen orendi të ndryshme, çibukë etj.; prandaj edhe kuptimet “i fortë, i lidhur, i qëndrueshëm”, që nënkupton it. *robusto*, me të cilën është përkthyer ky mbiemër, e kanë burimin te cilësitë e këtij druri.

Një fjalë tjetër e këtij Fjalori me interes gjuhësor, është, *ndoset* (f.305), që jepet në shprehjet *qen a gomar ndoset* “Cane o asino del tutto o al sommo grado”. Kjo fjalë, që përdoret më tepër me kuptim mbiemëror, është e gjallë ende sot në gegërishten e Veriut. Me këtë kuptim del edhe te Cordignanoja<sup>29</sup>; ndërsa Stuart Manni shënon edhe *çelik ndoset* “steel through and through”, “çelik i tëri, tej për tej”.<sup>30</sup> Morfologjikisht, mbaresa *-et* dëshmon se kemi të bëjmë me një emër të rasës rrjedhore numër njëjës, që në të folmet gege veriperëndimore përdoret me nyjen shquese, si: *mish lopet*,

<sup>29</sup> *Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese* (il nuovo Jungg), Parte Albanese - Italiana. Milano, 1934, 125.

<sup>30</sup> *A historical Albanian and English Dictionary*. London, 1938, 311.

*lëkurë dhiet* etj., kurse bashkëtingëllorja hundore në ballë të fjalës mund të jetë një element protetik, ose mund të kemi të bëjmë me parafjalën *n*. Sidoqoftë, formimi i kësaj fjale ka ndjekur pikë për pikë emrin *ndore*, që ka dalë nga *n dore*. Kësisoj, ky mbiemër do të ketë lindur më së pari në shprehjen *dosë n doset*, ku përsëritja e emrit i ka shërbyer përforcimit të cilësive të kafshës, si në rastet: *derr derrit, thi thiut, qen qenit*. Prej këndeje, fjala e ka zgjeruar sferën e përdorimit edhe për kafshë të tjera dhe për sende, madje, duke u shtrirë më tej edhe për njerëz, ku fjala ka marrë kuptim pejorativ.

Foljen *m'u njethë* Fjalori e ka (f. 47) për “mbin, mugullon”, it “germogliare”. Te kjo folje, bashkëtingëllorja *nj-* në ballë të fjalës e ka burimin te grupi bashkëtingëllor *ngj-*, që në krahinë të Shkodrës është asimiluar në *nj-*: si rrjedhim, folja ka pasur trajtën *ngjeth*, duke u lidhur me emrin *gjeth*, që ka dhënë kuptimin “mbin, mugullon”, ashtu si format pa protezën e *-n-së*, *gjethon e gjethëron*, që kanë të njëjtin kuptim.

Folja *argëtoj* me të drejtë është parë si një formim me prapashtesën *-to* nga një rrënjë *arg* me burim nga gr. mesme *argós* “i papunë, i ngadalshëm”<sup>31</sup>. Por një trajtë më e hershme, që qëndron më pranë rrënjës, është *argoj*, të cilën Fjalori i Bashkimit e ka në trajtën *argue* bashkë me mbiemrat *i arguem, i argueshëm* (f.25) dhe shpjegohen me it. “accarezzato” e “carezzevole”, “i përkëdhelur” dhe “përkëdhelës”, si kuptime më të hershme. Këtë fjalë, që mungon në fjalorët e shqipes e shënon së pari Jungu në Fjalorin e tij (f.1\*) dhe e rimerr Fjalori i Bashkimit.

Për foljen *buron* dhe emrin *burim* që rrjedh prej tij, gjuhëtarët kanë paraqitur mendime të ndryshme, shumica e të cilëve kanë si pikënisje formën e sotme me lëngëzoren *-r*. Një mendim të tillë ka

---

<sup>31</sup> Çabej SE II 74.

Gustav Meyeri që e lidh përbrenda gjuhës me *burí* “Überfluss”, “sasi e madhe” dhe sinonimin *vrujon*, duke i nxjerrë të dyja këto nga serbishtja *vrulja*. Kamarda<sup>32</sup> nisat gjithashtu nga një bazë me *-r* dhe e krahason fjalën e shqipes me gr. *vryō* “buroj”; kurse Vasmeri<sup>33</sup> e krahason atë me nordishten e vjetër *byrr* “günstige wind”, “erë e favorshme”. Të gjitha këto etimologji, që nisen nga trajtat *buroj* e *burim*, janë të papranueshme, sepse Fjalori i Bashkimit, që ka trajtat *bunon*, me *bunue*, *i bunuem*, *të bunuemit* (f. 56), dëshmon se *buron* e *burim*, janë forma dytësore të toskërishtes me rotacizëm, që janë përgjithësuar në shqipen e sotme, kurse format më të vjetra, prej nga duhet të nisë shpjegimi i fjalës, janë ato të gegërishtes me bashkëtingëlloren *-n*, që janë pasqyruar në Fjalorin e Bashkimit.<sup>34</sup>

Folja *hulumtoj* “vëzhgoj, gjurmoj” është shpjeguar me të drejtë nga Çabej<sup>35</sup> prej foljes *humb*, që ka krijuar trajtat foljore *hulmëtoj* e *hulëmtoj*, që janë forma të zgjeruara me prapashtesën *-to* nga një bazë *\*humël* të foljes *humb*. Por një trajtë që qëndron më afër foljes *humb*, gjendet në Fjalorin e Bashkimit (f.163). Kjo është folja *humloj*, që jepet me kuptimet “far sparire, cancellare, sbandire”, “zhduk, shlyj” dhe ka për bazë foljen *humb*. Kjo folje, që qëndron më afër burimit të foljes nga kuptimi e nga forma, dhe që shërben si një shkallare ndërmjet foljeve *humb* e *hulumtoj*, do të ishte një e dhënë e re, që shton argumentet për ta bërë më të besueshme burimin e fjalës, të dhënë me saktësi nga Çabej.

Ndër ndajfoljet që përmend ky Fjalor gjejmë edhe *gjithkahë*, *gjithkahmos* e *gjithkraha* (f.142). Kjo e fundit paraqet interes të

<sup>32</sup> Demetrio Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*; Livorno, 1864, 60.

<sup>33</sup> Max Vasmer, *Studien zur albanischen Wortforschung*. Dorpat, 1921, 8.

<sup>34</sup> Sh.. për këtë edhe Çabej SE II 386.

<sup>35</sup> Po ai, *Studime etimologjike në fushë të shqipes IV*. Tiranë, 1996, 380.

veçantë, meqenëse është sinonime me dy të parat dhe dëshmon se emri *krah* është përdorur si element formues për të krijuar ndajfolje. Me këtë jepet, vërtetohet se bashkëtingëllorja *-h* te ndajfolja pyetëse *kah* e gegërishtes, që i përgjigjet formës toske *nga*, e ka burimin te emri *krah*.<sup>36</sup>

Me interes të veçantë është ndajfolja *njeti* (f.147), që në këtë Fjalor jepet me kuptimin “gjetiu”, it.*altrove*. Për burimin e kësaj fjale, Eqrem Çabej<sup>37</sup>, duke e lidhur fjalën e shqipes me ind.vj.*anyátra* “gjetiu” e duke vënë si bazë një *\*niet* nga *\*aniatī*, merr si më të vjetër trajtën me tingullin /nj/, që e ka gegërishtja dhe gjendet edhe në Fjalorin e Bashkimit. Le të më lejohet në këtë rast të mos e ndjek mjeshtrin e madh të etimologjisë së shqipes në mendimin e tij, duke parashtruar një rrugë tjetër, meqenëse pikënisja nga një formë që nis me bashkëtingëlloren *-nj* do të linte pa shpjeguar formën toske *gjetiu*, që ka të njëtin burim. Për këtë le të krahasohet numrori *një*, që del me këtë bashkëtingëllore në të dy dialektet, meqenëse burimin i /nj/-së është bashkëtingëllorja hundore /n/ që është bashkuar me gjysmëzanoren /j/. Për këtë arsye, meqenëse bashkëtingëllorja /nj/ që ka forma e Veriut nuk mund të pajtohet me qiellzoren /gj/ që ka dialekti i Jugut, të dyja këto mund të sillen në emërues të përbashkët, po të mendojmë se forma *njeti*, që jep Fjalori i Bashkimit, është formuar nga *ngjeti* me një *-n* protetike, ku grupi bashkëtingëllor /ngj/ është shndërruar në /nj/, sipas veçorisë së gegërishtes së Veriut; si rrjedhim, forma e përbashkët e të dy dialekteve ka filluar me qiellzoren *gj*-. Raportin e gegërishtes *njeti* me toskërishten *gjetiu* për punë të ballit të fjalës mund të na e sqarojë edhe një fjalë tjetër e këtij Fjalori, emri *njizë*

<sup>36</sup> Ndryshe e mendon burimin e kësaj bashkëtingëlloreje Çabej (SE VI 53).

<sup>37</sup> E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*; Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore, Tiranë, 3, 1962, 65.

(f.456) përkundrejt toskërishtes *gjizë*, ku parësore është *gj*-ja e toskërishtes, kurse *nj*-ja e formës *gege* ka dalë nga grupi bashkëtingëllor *ngj*-, i krijuar nga proteza e sonantes *-n*. Raste të tjera të këtij evolucioni kemi: *Shnjergj* me bashkëtingëlloren *-nj*-prej grupit *-ngj*-, të krijuar nga *Shën Gjergj*; folja njallem përkundrejt mbiemrit *i gjallë, njak* nga një *n gjak*<sup>38</sup> dhe *i njelmët* nga *i ngjelmët*, ku rrënja *\*gjel-* ka dalë nga emri i kripës në gjuhët indoeuropiane, latinisht *sāl, salis*, greqisht *hals, halós.*, irlandishte e vjetër *salann*, të gjitha me kuptimin “kripë”.<sup>39</sup> Me këtë shpjegim të ballit të fjalës në të dyja dialektet ndryshon edhe burimi i saj.

Duke veçuar nga ana morfologjike shtesat e mëvoshme, në dialektin e Veriut zanoren *-i* te *njeti* e në Jug zanoret *-i* dhe *-u* te *gjetiu* (si ndajfolja tjetër *vetiu*) dhe prapashtesat *-kë* e *-zë* te format *gjetkë* e *gjetkëz*, rrënja e fjalës mbetet një *\*gjet-*, baza më e hershme e saj. Për shpjegimin e burimit të fjalës ndihmon kuptimi i saj: *njeti* e *gjetiu* do të thotë “diku tjetër, tjetërkund”, si rrjedhim ajo është formuar nga bashkimi i një ndajfoljeje vendi me një përemër të pacaktuar në sintagmën *ku+jetër*, me trajtën më të vjetër të këtij përemri.<sup>40</sup> Me përngjitjen e këtyre dy fjalëve, zhvillimi fonetik deri në trajtën *\*gjet-*, prej së cilës kanë dalë trajtat e sotme, ka ecur sipas ligjeve fonetike të gjuhës shqipe: rënia e lëngëzores *-r* në fund të

<sup>38</sup> Sh. për këtë Aleksandër Xhuvani – Eqrem Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore 4, Tiranë, 1956, 40.

<sup>39</sup> Sh. Holger Pedersen, *Die Gutturale im Albanesischen* Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete der indogermanischen Sprachen, begründet von A. Kuhn 36. Berlin-Gütersloh-Göttingen, 1900, 285; Nobert Jokl, *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*. Wien, 1911, 64.

<sup>40</sup> Trajta e sotme *tjetër* është formuar nga bashkimi i kësaj trajte me nyjën të (*të +jetër > tjetër*).

fjalës, si te lat.*accipiter* që ka dhënë *qift* dhe lat.*imperātor* që ka dhënë *mbret*; rënia e zanores *-u-* nga pozicioni i saj i patheksuar, kthimi i bashkëtingëllores grykore të shurdhët në të zëshme nga gjysmëzanorja *-j-* dhe shkrirja e këtyre dy tingujve me njëri-tjetrin (*k-j > g-j > gj*). Pas këtij shpjegimi, kjo fjalë e shqipes, e formuar në sand’hi, ka ndjekur të njëjtën rrugë si it.*altrove* nga lat. *altero ubi*, gjerm. *anderswo* nga *anders* + *wo* dhe *anderswohin* nga *anders* + *wohin*, si edhe ang. *elsewhere* nga *else+where*, që të gjitha me të njëjtin kuptim e të ndërtuara me të njëjtat elemente, sikurse fjala e shqipes.<sup>41</sup>

Një ndajfolje tjetër e këtij Fjalori është *ndërdomna*, që jepet me kuptimin “pezull, me dyshim”; *me e lanë a me metë ndërdomna* “lasciare o rimanere una cosa sospesa e dubbiosa” (f.301). E ka edhe Bogdani me kuptimin “në dyshim”; *Prashtu ishte djalli ndërdomënë* “Era perciò il Demonio in dubio”.<sup>42</sup> Fjala është e gjallë edhe sot në Shkodër, *jam ndërdomna* “ndërduzash”. Kjo ndajfolje është formuar nga përngjitja e një togu parafjalor, *ndër* + *domna*, shumësi i një trajte *\*dom*, që, me sa duket, nuk ekziston në gjuhë, veçse në trajtën e shumësit. E. Çabej e nxjerr atë nga emri *drom* “rrugë”,<sup>43</sup> një shpjegim jo fort i sigurt, si për anën kuptimore, ashtu edhe për anën fonetike.

Me sa duket, ky emër ka si bazë numërorin *dy*, duke marrë emri kuptimin “dyshim”, ashtu si vetë emri *dyshim* nga folja *dyshoj* përmban numërorin *dysh* të rasës rrjedhore; ndërsa për rrugën e formimit mund të krahasohet edhe *ndërdym* për “dyshim”, që ka ky Fjalor (f. 301). Kësisoj *ndërdomna* ka kuptimin “ndërdyshas, në

<sup>41</sup> Sh. për këtë edhe Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, 404 v.

<sup>42</sup> Bogdani, Pjetër, *Cuneus Prophetarum*. Patavii, 1685; II 40, 11.

<sup>43</sup> SE III 283 v.

dyshim, më dysh, dymendjesh”. Në rrethana të tilla, bashkëtingëllorja *-m* është në funksion të prapashtesës, sikurse te *ndërdym e dymëztoj*; kurse zanorja e theksuar, që sot del me tingullin *-o-*, mund ta ketë burimin te një *-u-*, duke kaluar nëpër shkallët *-y- > -u->-o-*. Kalimi i parë na çon te një trajtë *dum*, që e jep Cordignanoja si *nderdumna* “me lanë, me mbetë nderdumna; lasciare o rimaner in sospeso, in dubbio”<sup>44</sup> dhe fonetikisht mund të jetë e njëjtë me lidhjen *dy~duq*<sup>45</sup>; ndërsa kalimi tjetër *-u- > -o-* është një dukuri e njohur e disa të folmeve të gegërishtes (khs. *Groftat* nga lat. *crupta, crypta*; *Shkortull* nga *(i) shkurtë, doke nga dukë* etj.

Së fundi, ndajfolja *shqyp* që ka ky Fjalor (f.414), paraqet interes të veçantë përtej caqeve të leksikografisë, meqenëse ka lidhje të drejtpërdrejtë me emrin e ri etnik të shqiptarëve dhe të vendbanimit të tyre. Siç duhet, emrat e lashtë *Arbëni, arbënesh, arbënisht*, që janë ruajtur deri para pak shekujsh, janë zëvendësuar në kohë të vona nga etnikat më të reja *shqiptar, Shqipëni, shqip*, ku vendin e parë për nga origjina e ka emërtimi i gjuhës me ndajfoljen *shqyp*. Kjo ndajfolje në Fjalorin e Bashkimit jepet me dy kuptime: “albanese”, që është kuptimi i veçantë për gjuhën shqipe, dhe “chiaramente, francamente”, “qartë, çiltas”, që është kuptimi i përgjithshëm, prej të cilit ka dalë kuptimi i veçantë. Me këtë dëshmohet se emërtimi i gjuhës shqipe, prej së cilës ka dalë emri i vendit dhe i popullit, e ka burimin nga një ndajfolje me kuptim të përgjithshëm, që është përdorur në kontekste të tilla, si: *flas shqip domethënë “flas qartë”, po ta them shqip* etj. Me këtë shpjegim bëhet e qartë se fjala *shqip* s’ka asnjë lidhje me emrin e *shqipes*, siç është supozuar nga shumë etnologë e gjuhëtarë.

<sup>44</sup> Diz. Alb.-It. 124.

<sup>45</sup> Sh. për këtë: Çabej SE III 359.



Këto ishin vetëm disa prej hulumtimeve që nxorëm nga ky fjalor, i cili përbën një bazë të shëndoshë dhe një mbështetje të qëndrueshme për etimologjinë e gjuhës shqipe.

Në përfundim, sot mbas 100 vjetësh të botimit të këtij fjalori, është koha që lexuesi shqiptar të ketë në dorë një botim më të përdorshëm e më të kuptueshëm me alfabetin e sotëm. Një botim anastatik është bërë në Kosovë më 1978, me rastin e 70-vjetorit. Sot, pas një udhe 100 vjeçare është i nevojshëm një ribotim i tij me alfabetin e sotëm, me atë alfabet që u vendos po atë vit në *Kongresin* e Manastirit dhe ka për bazë alfabetin e Shoqnisë Bashkimi. Për këtë arsye, ky Fjalor mund të quhet preludi i alfabetit të shqipes, me të cilin gjallon sot kombi shqiptar dhe e kaluara e tij.

## **ABSTRACT**

### **The Dictionary of “Bashkimi Association” – Albanian Etymology**

The Dictionary of “Bashkimi”, published before one hundred years, remains as one of the best that were written until today. It has brought out many rare words of Albanian language composed with its material and means.

This Dictionary, composed as a bilingual one, has served not only for instructive aims; at the same time it gets the values of an etymologic dictionary, too. It also gives a valuable assistance on etymologic studies, because in it are included many forms of words which have existed in Albanian, but have disappeared in later times. So, with the intention of a better exploitation, we think that it's the time this Dictionary to be republished in a more usable and more understandable edition, in a contemporary way.

Gjovalin SHKURTAJ

**KAHE TË MBARA FJALËFORMUESE DHE NORMË  
THEMELUESE TË FJALORIT TË “BASHKIMT”**

I përgëzoj organizatorët për idenë e bukur që u ka shkuar në mendje për ta përkujtuar këtë datë me rëndësi shkencore, kulturore e kombëtare dhe, në mënyrë të veçantë, falënderoj prof. dr.Tomor Osmanin, që më ka njoftuar me kohë të jem i pranishëm në tubimin e sotëm, ashtu si edhe në shumë të tjera.

Gjithashtu, përshëndes të gjithë të pranishmit e nderuar në këtë tubim, shumë prej të cilëve i njoh e më njohin qyshkur kisha më pak rrudha e thinja..., të gjithëve ju blatoj nderimin që u takon si studiues e dashamirë të shqipes.

Ideja e bashkarisë dhe e bashkimit kanë qenë, po edhe shpresojmë (e do të punojmë derisa të kemi frymë) të jenë në atë hulli dhe në ato piketa që na i kanë shestuar, vënë dhe ngulitur burra si ata të Shoqërisë “*Bashkimi*”, me shembullin, punën dhe veprat e tyre të mëdha, si njerëz me dije e atdhetari të theksuar. Le t’u themi sot, me solemnitetin më të madh: “**Ndjesë e dritë paçin!**”, duke vlerësuar Fjalorin e hartuar prej tyre.

Roli i gjuhës së shkruar, të përbashkët e sa më të njësuar për bashkimin kombëtar del qartë e pohohet më shkoqur se në çdo nismë a organizëm tjetër të Shoqëria “*Bashkimi*” dhe të Fjalori i saj, si **dëshmia dhe gjurma më e vyer dhe e pavidrë e bëmave**

**atdhedashëse e kombësipohuese** të asaj yllësie burrash të shquar që aderonin në të.

Përkujtimi i 100-vjetorit të botimit të Fjalorit të Bashkimit, për të cilin jemi tubuar sot këtu në Shkodër, për hir të nismës dhe kujdesit të Sektorit Shkencor të Albanologjisë dhe të drejtuesit të tij, prof. dr. Tomor Osmanit, na imponon që, krahas vlerësimeve që u takojnë atyre që e hartuan, e gatitën për shtyp dhe e botuan veprën “*Fjauler i Rii i Shcypes*”, t’ua themi një “*Dritë e ndjesë paçin!*” edhe të gjithë pararendësve të tyre, burra të cilët, ndonëse të shpërndarë e të përhapur nëpër botë si zogjtë e korbit, bënin të mundurën që të tregoheshin faqe të huajve si **bij të shqipes** dhe për këtë arsye, ndonëse në përmasa e mjedise të ndryshme, synonin të njëjtën gjë: **krijimin e një gjuhe shqipe të përbashkët**, ta pajisnin atë me abëcënë e përbashkët, pastaj edhe me fjalorë e gramatika.<sup>46</sup>

Fjalorët dhe gramatikat vlerësohen gjithandëj si vepra të vështira dhe, pikërisht për atë arsye, i krahasojnë me ndërtimin e veprave arkitektonike shumëvjeçare, të veprave që rrallë e tek ndodh të kryhen nga ai që i nis. Domosdoshmëria e fjalorëve dygjuhësh të shqipes shtrohej nga nevojat e shprehjes e të bashkëjetesës së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, më herët në kundruallësi me latinishen, sikundër bëri në mesjetën e vonët Imzot Frang Bardhi, pastaj me aq shumë sprova për fjalorë **shqip-italisht** (dhe anasjelltas), qysh nga fjalorët e Nikollë Ketës dhe Andrea Darës në Sicili, i Pjetër Kamodekës në Kalabri, deri te Fjalori i Bashkimit më

---

<sup>46</sup> Përmendim, me këtë rast, se Arbëreshët e Italisë u kujtonin bijve e bijave në rrjedhë të moteve se “*Kush bjerr gjuhën, mbytet vetë*” dhe kjo i shtynte në sprova e veprimtari për të shkruar fjalorë, gramatika dhe për të mbledhur këngë e histori të atilla që synonin të pasuronin shqipen deri përtej brigjeve, siç e pat thënë aq bukur Nikollë Keta në hyrje të Fjalorit të tij: “...*Si krymp mëndafshi gjith u svis vet`hej,/e këtë vistar tuar, qëndisi e shkroi,/se t`e qosnej gjith Arbërin ndjera përtej.*”

1908. Ndërkaq, sikundër e kërkon e mbara e ecurisë së veprave të tilla, **janë edhe njëqind vjet të plota** që hullia e fjalorëve dygjuhësh **shqip-italisht** dhe (anasjelltas) ka vijuar<sup>47</sup> dhe, natyrisht, në ngrehinën e lartë të shumë fjalorëve të tillë, *Fjalori i Bashkimit* ka vendin e vet dhe meriton t'ia lëvdojmë anët e ndryshme të tij.

(Bashkohem plotësisht ma sa thanë kumtuesit parafolës dhe do të përpiqem të mos rimarr shumëçka që përmendën ata, por pa qenë e mundshme plotësisht për arsye se vetë tema e parasheh një gjë të tillë.)

Fjalori titullohet “*Fjaluer i Rii i Shcypes*”, me shënimin e thjeshtë: “*përbam prèie Shocniiet t’ Bashkimit*”. Me atë nënshkrim anonim, autorët mund të njëjtësohen vetëm tërthorazi, duke u mbështetur në rrethanën se “Bashkimi” qe shoqëri gjuhësore-letrare e drejtuar nga abati i Mirditës Prenkë Doçi dhe kishte anëtarë një yllësi burrash të nderuar e të dalluar jo vetëm për atdhetari, por edhe për dijet e gjera të shqipes e të gjuhëve të huaja, veçanërisht të italishtes, si: Gjergj Fishta, Ndoc Nikaj, Dodë Koleci, Jak Serreqi, Luigj Gurakuqi etj<sup>48</sup>. Deri sot, për autorësinë e këtij fjalori ka bërë udhë mendimi se “*simbas të gjitha gjasave duhet të jetë vepër e Dodë Kolecit*”<sup>49</sup>. Dijetarëve që do të merren edhe më tej me vlerat e këtij Fjalori, u takon barra të hulumtojnë e të ndriçojnë se çfarë përfaqësonte ai që vuri në letër fjalët e shpjegimet e kësaj vepre,

---

<sup>47</sup> Mund të përmendim, ndër të tjerë, fjalorët: *Vocabolario Italiano-Epirotico* (nga Francesco Rossi), Stamperia della S. Congregazione Propaganda Fide, Roma, 1866, (ribotur dhe më 1875 nga Tip.Poliglota); Fjalorin e K. Kristoforidhit: *Lexikon tis Alvanitiqis Glossis*, Athinë, 1904; *Dizionario Albanese-Italiano* di Angelo Leotti, Istituto per l’Europa Orientale, Roma, 1937 dhe, sidomos, *Fjalori i gjuhës shqipe* i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1954.

<sup>48</sup> Shih: T. Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999, f.371.

pavarësisht se mban autorësinë kolektive të shoqërisë “Bashkimi”.

Në kufijtë e kumtesës sonë (nevojishtë të kufizuar) do të pykëzohemi në një anë të vetme të veprës e pikërisht në **kahet e mbara gjuhëpasuruese e normëthemeluese** të Fjalorit të Bashkimit.

## 1. VLERËSIMET PËR SHOQËRINË “*BASHKIMI*” DHE PËR FJALORIN E SAJ.

Vlerësimet për shoqërinë “Bashkimi” deri vonë kanë qenë të pamjaftueshme dhe, ashtu si përgjithësisht për punë e ndihmesa të vyera të së shkuarës së mjediseve Veriore, sidomos të anëve Veripërendimore, kanë qenë edhe të padrejta. Për këtë mjafton të hapim FESH-in, botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH-së, i vitit 1985, ku, në zërin prej gjithsej nja 15 rreshtash, thuhet: “Shoqëria “Bashkimi” (1899). Shoqëri klerikale letrare, e krijuar në Shkodër më 1899, nën drejtimin e abatit të Mirditës Prengë Doçit. Ndër të tjera ajo hartoi një alfabet me shkronja latine, në të cilin disa tinguj paraqiteshin me dyshkronjësja. Botoi edhe libra shkollorë (abetare, gramatika, libra leximi, aritmetike etj.) dhe fetarë për shkollat katolike. Botoi edhe një fjalor shqip-italisht (“Fjaluer i ri i shqypes”, 1908, me rreth 11 mijë fjalë...Shoqëria “Bashkimi” dërgoi përfaqësuesit e vet edhe në Kongresin e Manastirit (1908).<sup>50</sup>

Shpreh bindjen se, me rastin më të parë të ribotimit të FESH-it, po edhe në botime të tjera, sidomos të “Enciklopedia shqiptare”, zëri për Shoqërinë “Bashkimi” duhet të jetë patjetër “**zë i madh**”

---

<sup>49</sup> Shih: A.Kelmendi, *Dy fjalë me rastin e ribotimit*, f. VI dhe J.Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare, ???*

<sup>50</sup> Shih: Akademia e Shkencave e RPSSH-së, *Fjalori enciklopedik shqiptar*, Tiranë, 1985, f.1028.

dhe të zhdavariten në të ato cilësime e vlerësime që i takojnë asaj, duke u mbështetur sidomos në hulumtimet dhe ndihmesat e dhëna nga prof. dr. Jup Kastrati dhe prof. dr. Tomor Osmani, **si binomi që kanë bërë shumë për të nxjerrë në dritë veprat atdhetare e shkencore të Shoqërisë “Bashkimi”**. (Kam parasysh, sidomos dy veprat e tyre madhore, përkat.: “Histori e gramatologjisë shqipe” dhe “Udha e shkronjave shqipe”). Vijim e kurorëzim i asaj pune shumëvjeçare dhe i synimit të mbarë për ta ndriçuar sa më mirë ndihmesën madhore të asaj Shoqërie është edhe tubimi i sotëm shkencor, kushtuar 100-vjetorit të botimit të “Fjalorit” të Bashkimit.

Mendoj, gjithashtu, se sot, në këtë veprimtari shkencore në 100-vjetorin e këtij Fjalori, është rasti t’i blatojmë **vlerësimin dhe nderimin** që i takon prof. Ahmet Kelmendit, i cili, më 1978, plot 30 vjet më parë, e ribotoi veprën në Prishtinë, në kolanën e botimeve të “Rilindjes”, kolanë meritore për kohën, në të cilën i lartpërmenduri ka botuar edhe shumë vepra të tjera me vlerë, ndër to, për herë të parë, edhe gjashtë vëllimet e veprave të prof. Eqrem Çabejt. Por, ajo që i takon këtij studiuesi të nderuar, do të ishte e mangët, po të mos përmendnim edhe vlerësimin objektiv e të menduar mirë që ka shprehur në parathënien e shkurtër, ku nënvizon: *“Derisa nëpërmes të folklorit shprehet shpirti i një popullit, me gramatikë pjekuria logjike-gjuhësore-shprehimore e kombëtare etj., me fjalor shprehet pasuria kulturore, shkalla e gjerësisë kulturore dhe historike të një populli. Prandaj edhe fjalori u bë objekt interesimi i Rilindasve tanë. Meritë të posaçme në këtë fushë ka edhe Shoqëria “Bashkimi” e Shkodrës”*.<sup>51</sup>

---

<sup>51</sup> A. Kelmendi, *Dy fjalë me rastin e ribotimit*, f. V.

## 2. VLERAT GJUHËPASURUESE DHE NORMËTHEMELUESE TË FJALORIT TË “BASHKIMT”

Kur marrim në dorë një libër të shkruar e të botuar 100 vjet më parë dhe e lexojmë tashmë me synime vlerësuese, natyrisht, kryekreje na bie në sy **prania në të e shumë fjalëve që sot na duken të vjetra**; kjo vjen, nga njëra anë, për arsye se gjuha qysh atëherë ka pasur edhe zhvillimet e veta dhe mjaft fjalë e terma, që në atë kohë ishin në përdorim të gjerë, por edhe që hartuesit i mendonin me të drejtë si “gurë themeli”, si “piketa” të një norme leksikore dhe më gjerë. Të tilla janë, p.sh.: **atme,-ja** (për it. *patria*), **atmëtaar,-i** (për it. *patriota*), **atmii,-a** (për it. *patriotismo*) etj. që, me kohë, e kanë bjerrë parapëlqimin dhe janë zëvendësuar më dysorë që ngjajnë më të pëlqyeshëm (përkat.: **atdhe,-u, atdhetar,-e; atdhetarizëm,-i**), porse ato, sidoqoftë, kanë pasur **rol prijës e hullitregues**; po kështu edhe në raste të tjera, si p.sh. për **baakeq,-i e baakeqe,-ia** (që në Fjalor jepeshin për it. *malfattore, malfattrice*), në kohët e reja do të dilnin në përdorim të gjerë dysorët përkatës: **keqbërës, keqbërëse**; në vend të **buqar,-i** si fjalë e përdorur gjerë në mjediset përkatëse, me kohë, vjen e parapëlqehet **bujk,-u**; po ashtu **grykse,-a** ia lëshon hapësirën **përparëses** së sotme etj. E, megjithatë, që nga faqet e Fjalorit, si dhe nga të folmet e gjalla të trevave tona, fjala **buqar** (bashkë me variantet fonetike *buoqar, bueqar, bujqar*) ta bën me sy e të duket e bukur dhe e lakmueshme si një qershi e pjekur që shkëlqen në degë. Kjo ndodh sepse fjalët me prapashtesën-**ar** në shqipen, janë si e bardha në veshjet shqiptare, që shquajnë e dallohen, po edhe pëlqehen më shumë. Le të kujtojmë vargun e gjatë të fjalëve me **-ar**, që emërtojnë mjeshtëri a zeje të shqiptarëve, ku po

të fillojmë me *buqar*, ecim aty me *argjendar*, *këpucar* e *opingar*, *qethtar*, *rrogëtar* e deri te *kështjellar*, po edhe te **muziktar**, që aq bukur tingëllon në gojën e ndonjë mjeshtri fjalëbukur, qoftë edhe në vend të termit muzikant. Me sa më sipër, pa u ndalur gjatë, desha të përthekoj idenë se fjalorët në përgjithësi, jo vetëm grumbullojnë e pasqyrojnë sa nden gjuha, po edhe e krahasojnë dhe e bëjnë lëndën leksikore të atillë që jetë edhe si **drithë bloje**, po edhe si **farë drithi**.

Në vijim, edhe më qartë, mund ta shohim këtë në rastin e fjalëve me rrënjën **lirë**, si: **lirii,-a** (për it. *libertà*), **lirim,-i** (për it. *libertà*), **liroj** (për it. *liberare*, *dispensare*, *alleggerire*); **liuem,-e** (për it. *liberato*), të cilat, në kohët e reja, do të mënjanoreshin nga dysorët përkatës me përforcuesen **ç-** (përkat. **çlirim,-i**, **çliroj**, **çliruar (i,e)**).

Shumë fjalë të Fjalorit të Bashkimit, sidomos emërtime të zejeve, të bujqësisë e të blegtorisë që pasqyrohen gjerë në të, **kanë ecur në një rën prej dy kaheve të ditura për leksikun e çdo gjuhe**: disa kanë dalë nga përdorimi bashkë me vetë sendet a objektet që emërtonin, duke u zëvendësuar me të rejtat përkatëse; të tjera, ndonëse janë fjalë shqipe e të atilla që duhet të kishin përparësi në përdorim, për fat të keq, janë zëvendësuar me fjalë të huaja që duken më “moderne”, si p.sh.: **laradash**, që është mposhtur nga fjala e huaj **pelikan** (<it. *pellicano*); **ballinë,-a**, që kot më kot shumëkujt i pëlqen ta japë me **frontespice** (it. *frontespizio*); **buej, buen, me buejt**, fjalë e tabanit dhe nga më të përshtatshmet, sot ka prirjen të zëvendësohet me fjalën e huaj **akomodohem**; ashtu si **bukurshkrojë,-a** ka dalë krejt nga përdorimi në dobi të dysorit të huaj **kaligrafi,-a**; në FB jepet fjala shqipe **qethtar,-i** (për it. *barbiere*), porse me kohë gjithandej ka hyrë dhe është rrënjësuar tashmë fjala e huaj **berber**; në FB gjejmë fjalë të tilla si **qetim,-i**;



**qetoj, qetuem,-e** (i,e) (për it. *tranquillità, calma* etj.), kurse në kohën tonë, sikundër po e dëgjojmë ditë për ditë me shqetësim të natyrshëm, mediat po parapëlëqejnë fjalën e huaj **relaks** dhe formimet mbi bazën e saj, si: **relaksoj, relaksohem, relaksim**. Në FB jepet çerdhja e fjalëve: **qortim, qortoj, qortuem,-e** (i,e), porse sot në vend të tyre gjithandej përdoren dysorët e huaj (përkat. **korrigjoj, korrigjim, korrigjuar** (i,e); në FB jepet **qinnrak,-u** (për it. *resistente*) dhe **qinnresë,-a** (për it. *resistenza*), kurse më vonë, sikundër po e shohim edhe në ditët e sotme, kanë marrë përparësi fjalët e huaja (përkat. **rezistent,-e, rezistencë,-a**).

Në FB jepet fjala **derëtaar,-i** (për it. *portiere*); **dërgesë,-a** (për it. *spedizione*) etj., të cilat sot shihen si të papërshtatshme dhe në vend të tyre kanë zënë vend dysorët e huazuar.

Fjalori dhe krejt veprimtaria kulturore e letrare e atyre që drejtonin Shoqërinë “*Bashkimi*” ishte **pjesë përbërëse e vijim i mëtimeve të mbara gjuhëpastruese e gjuhëpasuruese** të Rilindjes dhe kjo shfaqet dukshëm anembanë faqeve të Fjalorit. Mjafton të përmendim se aty, shumë terma të fushave të reja për kohën, që do të përdoreshin edhe në shkollat shqiptare, dalin ashtu si i ideonin mendimtarët e asaj kohe, pra **si kalke nga gjuhë të tjera, por me brumin e shqipes**. Mund të përmendim, ndër të tjera: **dhemasë,-a** (për it. *geometria*), **dhengritëse,-a** (për it. *miniera, minerale*); **dheshkroje,-a** (për it. *geografia*), **dheshkroituer,-ori** e **dheshkrojtore,-ia** (për it. *geografico*) etj. Këtu, natyrisht, mund të përmendeshin edhe shumë fjalë të tjera shqipe, të bukura për kohën e të vyera edhe për sot, si **goitaar,-e** (për it. *eloquente, facondo*); **latuer,-ori** (për it. *scultore*); **gjiitaar,-e** (për it. *mammifero*), **grashtoj** e **grazhdoj** (për it. *governare le bestie alla mangiatoia*); çerdhen e fjalëve **gropoj, gropore,-ia, grupuem,-e** (përkat. për it.

*scavare la fossa; cavità, incavatura; scavato*); **grunar,-i** (për it. *granaio*), **kahershëm** (i,e) me kuptimin e it. *antiquato*; **kallëzuer,-ori** (për it. *indice*); **kashtore,-ia** (për it. *pagliaio*); **kremte,-ia** (për it. *fiesta*) dhe **kremtoj** (për it. *festeggiare*); **krushkohem** (për it. *imparentarsi*); **kryekëput** (për it. *totalmente, identicamente*); **kryeneç,-e** (për it. *testardo*); **mohuesuer,-ori** e **mohuesore,-ia** (për it. *che rinnega, che rinunzia* ); **nye,-neni** (për it. *nodo, articolo*); **nxehtësii,-a** (për it. *calore, ardore, fervore*); **paar e paar** (për it. *a schiere, in ordine, in fila, in coro*); **pashëm (i,e)** (për it. *visibile*); **paqoj** (për it. *pacificare, quietare*) dhe **paquem,-e** (i,e) (për it. *pacificato, quietato*); **palavii,-a** (për it. *laidezza, disonestà*), **parabirni,-a** (për it. *primogenitura*); **paralinnie,-a** (për it. *primogenitura*); **paraprak,-e** (për it. *preliminare*); **paraveshe,-a** (për it. *schiaffo*); **parim,-i** (për it. *principio*); **përbinnsh,-i** (për it. *monstro*); **përbinnshëm** (i) (për it. *mostruoso, orribile*) etj.

Sigurisht, 100 vjet, që kanë kaluar qysh nga viti 1908 deri sot, janë **pak** në vargun e gjatë të moteve qyshkur përmenden shqiptarët si popull e gjuha e tyre si gjuhë më vete, por ato **nuk janë aq pak**, po të mendojmë se, në atë hark kohor prej një shekulli, shqiptarët kanë kaluar nga mëdyshja e sprovat e mundishme për të mbetur shqiptarë dhe për ta shkruar shqipen, për të krijuar një alfabet të përbashkët e të vetëm për të, i kanë arritur ato plotësisht e në atë mënyrë që të gjithë dashamirët e shqiptarëve e të shqiptarisë i kanë lëvdur e vijnë t'i përmendin **si një rën nga punët më të mbara që kanë bërë shqiptarët** dhe bijtë e tyre që u ka rënë barra e nderi të merren me gjuhësi.

Ndërkaq, qysh në fundshekullin XX kemi ardhur në periudhën e luftës së ethshme për të hyrë në Evropë, gjë që ka shtuar dukshëm kujdesin për anglishten dhe gjuhët e tjera të mëdha të BE-

së. Po ashtu, ka shenja se puna dhe kujdesi për gjuhën shqipe janë shpesh në rënie. Ka rrezik se, po të mos kujtohemi sa nuk është vonë t'i japim vlerën e rendësinë që i takon gjuhës shqipe, mund të shkojmë në mëdyshjen tjetër, tashmë “moderne”, që mund të formulohet kështu: a thua do të mbetet gjallë gjuha jonë pas asaj ploje të madhe e asaj rendjeje marramendëse pas anglishtes, apo do të tretet shqipja si kripa në ujë në procesin e hyrjes në Evropë?

Kjo pyetje do ta ketë përgjigjen vetëm pas 100 vjetëve të tjera. Sot mund të themi vetëm një urim: **u shtofshin edhe më tej ata që veprojnë sot, sipas shembullit të mbarë e të bukur të autorëve të Fjalorit të Shoqërisë “*Bashkimi*”.**

Mimoza PRIKU

## FJALËSI DITURAK NË FJALORIN E SHOQËRISË “BASHKIMI”

Njësimi i një alfabeti të shqipes si dhe botimi i librave në gjuhën amtare ishte qëllimi kryesor i Rilindasve tanë. Vetë gjendja e Shqipërisë nën presionin otoman e shtronte këtë detyrë parësore, si e vetmja mundësi për ruajtjen e identitetit kombëtar.

Duke e ditur forcën e gjuhës së shkruar, Turqia i kishte ndaluar me ligj librat dhe shkollat në gjuhën shqipe sepse “*shkrimi e leximi asht porsì një ziarm,- shkruan Ndoc Nikaj,- i mbuluem që ndezet për kadal në terr e me ma të paren rasë qi një guximtar i largon hinin, shpërthen në flakë*”<sup>52</sup>.

Kjo domosdoshmëri solli një ndërgjegjësimit dhe impenjim serioz të të gjitha forcave intelektuale, atdhetare, shkencore e filologjike.

Vetëm njësimi i një alfabeti do të sillte botimin e librave e kështu do të vinte arsimimi i popullit, përparimi i një kombi. Përhapja e diturisë do të sillte zgjimin e vetëdijes së popullit për pavarësinë, krijimin e një kombi të pavarur dhe arsimin në gjuhën amtare.

Pas njësimit të një alfabeti si detyrë shtrohej edhe mbledhja e thesarit të gjuhës së popullit, i cili po humbiste në rrjedhën e shekujve, për të arritur më vonë drejt një gjuhe të kodifikuar.

---

<sup>52</sup> Dom N. Nikaj, *Kujtime të një jetës së kalueme*, Tiranë, 2003, f. 126.

Rezultat i kësaj pune të palodhur është nxjerrja në dritë në fillimin e shek. XX i fjalorëve të Kristoforidhit “Fjalor i gjuhës shqipe” (Lexikon tis alvaniqis glossis, Athinë, 1904), “Fjaluer i Rii i Shcypes” (1908) nga Shoqëria “*Bashkimi*”. Guri i parë i themelit në



*Kumtues dhe disa pjesëmarrës të konferencës*

lëmë të leksikografisë shqipe ishte hedhur më parë nga Frang Bardhi, i cili më 1635 botoi të parin fjalor, “Fjalor latinisht-shqip” (Dictionarium latino-epiroticum), duke ndjekur nga fjalorë dy a më shumë gjuhësh të hartuar nga F. M. Da Lecce më 1702 Fjalor italisht-shqip (Dizionario italina-albnese), T. Kavalioti. I. R. Von

Xylander etj.

Shoqëria “*Bashkimi*” u krijua më 1899 dhe mblodhi rreth vetes emra intelektualësh, patriotësh mjaft të njohur, si Preng Doçi, Gjergj Fishta, Pashko Bardhi, Dodë Koleci, Ndoc Nikaj etj. Me këtë shoqëri u bashkua fillimisht edhe Ndre Mjeda, por do të largohej shumë shpejt prej saj për arsye se nuk u pajtua me alfabetin e kësaj shoqërie. Shoqëria “*Bashkimi*” kishte hartuar një alfabet duke u nisur nga qëllimi “*që alfabeti i shqipes të jetë me shkronja latine*”<sup>53</sup> dhe ky alfabet “*ti përgjegjin nevojave t’ona*”<sup>54</sup>. Ky fakt do të ndihmonte edhe shtypjen e librave në vende të tjera. “*Me këtë alfabet u shkruen librat e parë të këndimit, kur shqypja nisi të hËjte zyrtarisht me u mësue nder shkollat e Gegnis*”<sup>55</sup>. Mirëpo Mjeda kishte si qëllim një alfabet ku çdo tingull të ketë vetëm një shkronjë dhe kur kjo nuk plotësohej të përdoreshin shenja diakritike, ndaj dhe me largimin e tij hartoi një alfabet të vetin. Por, edhe ai vetë nuk e zbaton deri në fund këtë kriter. Studiuesi Tomor Osmani në lidhje me këtë alfabet vëren se “*Ndre Mjeda, ndonëse nisej nga i njëjti parim, që një tingull-fonemë të jepej me një shkronjë, plotësimin e shkronjave të alfabetit latin nuk e bën me të njëjtën mënyrë*”<sup>56</sup>.

“Fjaluer i Rii i Shcypes” u botua në prag të Kongresit të Manastirit, i cili do të mblidhej po atë vit kur u botua fjalori. Mbajtja e tij kishte rëndësi gjuhësore, patriotike, historike duke u përpjekur në hartimin e një gjuhe të përbashkët, atëherë kur Shqipëria nuk ishte akoma një shtet i pavarur.

Në lidhje me këtë fjalor gjuhëtari i madh Aleksandër Xhuvani shprehej se “*Fjalori i “Bashkimi” tue përmirësuem e tue u*

---

<sup>53</sup> J. Rrota, *Për historin e alfabetit shqyp*, Shkodër, 2005, f. 81.

<sup>54</sup> Dom N. Nikaj, *Kujtime të një jetës së kalueme*, Tiranë, 2003, f. 174.

<sup>55</sup> J. Rrota, *Për historin e alfabetit shqyp*, Shkodër, 2005, f. 81.

<sup>56</sup> T. Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Tiranë, 1999, f. 386.

*shtuem gjithnjë, të zają vendin e një Fjalori Akademik në gjuhën tonë*<sup>57</sup>, ndërsa në parathënien e këtij Fjalori, në edicionin e ribotuar ai konsiderohet si “*një ndër veprat kapitale të leksikografisë sonë*”<sup>58</sup>. Për studiuesen kosovare Shefkije Islamaj “ky fjalor ravijëzon rrugën për një fjalor shpjegues të shqipes”<sup>59</sup>.

Në fokusin e studiuesve të huaj, albanologu E. P. Hamp në punimin e tij *Albanian*<sup>60</sup> vëren se Fjalori i Bashkimit ishte hartuar në pjesën më të madhe nga Dodë Koleci, duke u bazuar tek fjalori i Jungut, i hartuar 13 vjet më parë, më 1895. Ndërsa, linguisti italian Carlo Tagliavini në librin *Shtresimi leksikut të shqipes. Elemente indoeuropiane* duke folur për leksikun e bazën e tij dialektore thekson se ky fjalor “*kontribon në njohjen e dialekteve të asaj zone interesante*”<sup>61</sup>.

Në kontekstin në të cilin u hartua ky fjalor është e rëndësishme që të theksohet se pavarësisht se cili ishte alfabeti që përdori kjo shoqëri, të metat e tij ky alfabet dhe hartimi me anë të tij të fjalorit, gramatikave e teksteve shkollore, veprave letrare e fetare, mbart në vetvete një rëndësi jo thjesht filologjike, por edhe kombëtare.

Kundrimi i këtij fjalori me një largësi kohore prej 100 vjetësh, si dhe pamundësia e studimit të tij për disa dhjetëvjeçarë na vë përballë vështirësish, por edhe na vë para përgjegjësish që të nxjerrim në dritë vlerat e tij dhe ta vendosim atë në vendin që i

---

<sup>57</sup> A. Xhuvani, *Vepra gjuhësore*, II, f. , Tiranë, 1990.

<sup>58</sup> “Dy fjalë me rastin e ribotimit”, *Fjalori i “Bashkimit”*, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. VI.

<sup>59</sup> Sh. Islamaj, “Fjalori i Bashkimit”, në “*Kultura gjuhësore dhe përdorimi estetik i gjuhës*”, Tiranë, 2002, f. 272.

<sup>60</sup> E. P. Hamp, *Albanian*, “Current trends in linguistics”, vol. 9, Mouton, 1972.

<sup>61</sup> *La stratificazione del lessico albanese (Elementi indoeuropei)*, Bologna, Casa Editrice “La Grafolito”, 1943, f. 32.

takon.

Çdo fjalor është një thesar dhe nuk është thjesht një pasqyrë e fjalëve, por është pjesë e visarit të asaj gjuhe, që ngërthen në vetvete vlera historike, gjuhësore, kombëtare, etnolinguistike etj.

Ky fjalor është dëshmi e pasurisë leksikore të gjuhës shqipe, të mjeteve fjalëformuese, larmisë së termave, formave dialektore, krijimit të neologjizmave etj.

Objekt i këtij punimi do të jetë studimi i një pjese të fjalësit diturak të këtij fjalori. Për këtë qëllim kemi shqyrtuar terminologjinë në fusha të tilla, si gjuhësia, flora e fauna, duke parë më konkretisht kontributin e këtyre gjuhëtarëve në këto fusha, masën e vjeljes së materialit si dhe prurjet e reja, të cilat do t'i shohim më konkretisht më poshtë.

Do të shqyrtojmë fillimisht terminologjinë gjuhësore .

## 1. TERMINOLOGJIA GJUHËSORE

Si në të gjitha lemat e tjera edhe në terminologjinë gjuhësore secili emërtim është i pajisur me përkthimin përkatës në italisht. Ia vlen të kujtojmë që para botimit të Fjalorit kjo shoqëri kishte hartuar një broshurë me titull “Oroe përmi abetar shqyp”, në të cilën gjejmë një terminologji të pasur gjuhësore, e cila ka shërbyer si burim për hartimin dhe pasurimin e e këtij fjalori në këtë fushë. Gjuhëtari J. Kastrati ka vërejtur se “*pjesa dërmuese e këtyre botimeve të shoqërisë “Bashkimi” shquhen për një gjuhë të pastër dhe për një terminologji, relativisht të mirë dhe mjaft të njësuar, e cila vazhdoi deri me Komisinë Letrare (1916)*”.<sup>62</sup> Emërtimet në këtë fushë u përkasin si termave të përgjithshëm, ashtu edhe

---

<sup>62</sup> J. Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944)*, Prishtinë, 1980, f. 227.



nënsistemeve të gjuhës. Në këtë nomenklaturë gjejmë terma të përgjithshëm, si: **giuhsii**- it. *linguistica* me çerdhen **giuhsuer**- it. *linguistico* dhe **giuhtaar**-it. *linguista*, por edhe **filologhii**; it. *filologia*- duke e dhënë gjatësinë me dyfishimin e zanores dhe përballë saj **filolog** - it. filologo.

Do të përpiqemi që ta analizojmë këtë terminologji në disa rrafshe.

### 1.a. Fonetikë

Në planin fonetik gjejmë emërtimet e këtij nënsistemi me termat **fonetike**- it. *fonetica*, por edhe **fonetik**- it. *fonetico*, për të vazhduar me njësitë minimale, deri tek njësitë më të mëdha si rrokja, por edhe të njësive prozodike, si theksi; dukuri të ndryshme fonetike. Emërtimet fillojmë që me alfabetin, të cilin në këtë fjalor e gjejmë me **abee**- it. *alfabeto*.

Hartuesit e këtij Fjalori ishin mjaft të përgatitur për problemet gjuhësore dhe kjo gjë vihet re edhe në dallimin tingull-shkronjë, dallim i cili është specifikuar me emërtimet përkatëse, kështu për tingullin gjejmë **tingell**- it. *suono* dhe **shkroie**- it. *lettera*. Për këtë term të fundit, studiuesi J. Kastrati mendon se “ka shumë të ngjarë që këtë termë “Bashkimi” ta ketë marrë nga Kristoforidhi (1872), por me këtë ndryshim, se gjuhëtari i madh elbasanas e ka me kuptimin “shkrim”, kurse shoqëria në fjalë e përdor për “germat”.<sup>63</sup> Megjithëse nuk mund të themi se kemi një term të ri kemi të bëjmë me një veshje të re semantike të tij.

Nga dukuritë fonetike veçojmë: **epenthesi**- it. *epentesi*, **metheteze**- it. *metatesi*; terma që lidhen me keqtingëllimin është dhënë me **kakofonii**- it. *cacofonia* ndërsa për drejtshkrimin **bukurshkroje**- it. *calligrafia*.

---

<sup>63</sup> J. Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare* (1635-1944), Prishtinë, 1980, f. 227.

Interesant është emërtimi **thekse**- it. *accento* së bashku me çerdhen e fjalëve **theksoi**- it. *accentare*, **theksuem** (i, e)- it. *accentato*. Për theksin tonik gjejmë **gumues**- it. *accento tonico* dhe **gumuër**- it. *accento tonico* dhe përkrah tyre kemi edhe emërtimin **thekse**. Termin **thekse** kjo shoqëri “duhet ta ketë marrë nga Kristoforidhi”<sup>64</sup>. Që në Parathënie gjejmë të saktësuar edhe llojet e theksve: **thekse rânnie**- it. *accento grave*, **thekse hiedhse**- it. *accento acuto* dhe **thekse hunnxe**- it. *accento nasale*. Dy të parat duhet të jenë fjalë të krijuara nga shoqëria.

Brenda këtij fjalësi përfshihen edhe tingujt e klasifikuar në zanore dhe bashkëtingëllore me emërtimet **xântore**-it *vocale*, **nnerxâne**- it. *consonante*. Për tingujt nistorë ndeshim **fillestuer**-it. *iniziale* dhe për ato fundorë **marim**-it. *fine, termine*. Tiparet e këtyre tingujve mund të jenë: **i,e giate** – it. *lungo*, **paxâne** – it. *muta*, **hunnuer,ore**- it. *nasale*, **dhântore**-it. *dentale* dhe për tingullin qiellzor **çjellxuer**-i t. *palatale*, ndërsa grykori ka dy variante me ndryshime tingullore duke shënuar njëri gjininë mashkullore e tjetri gjininë femërore **gryktuer, gryktore**- it. *gutturale*.

Rrokja shënohet me **rroke**-it *sillaba* duke u ndjekur nga emërtimet e tjera **rrokesim**-it. *sillabare*, **rrokesues**-it. *sillabario*.

### 1.b. Gramatikë

Një vend të veçantë zënë edhe termat gjuhësorë të rrafshit gramatikor. Përveç termave tradicionalë **gramatike**- it. *grammatica*, **gramatikuer**-it. *grammaticale*, pikasim edhe emërtime të tjera të pandeshura më parë, si **folmareme**-it. *grammatica* dhe mbi këtë bazë emërtimet e formuara prej saj, si **folmarnisht** –it.

---

<sup>64</sup> J. Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare* (1635-1944), Prishtinë, 1980, f. 227.

*grammaticalmente, folmarmsuer- it. grammaticale.*

### **Pjesët e ligjëratës**

Pjesë e këtyre emërtimeve janë prurjet **ftillk-it. verbo** për foljen dhe të specifikuar me emërtimet **ftillk veprues- it. verbo ativo** dhe **ftillk asngânxe-it. verbo neutro, ftillk veprues asgnanxe – it. verbo ativo neutro, ftillk perpaltuer -it.verbo riflesso o reciproco.**

Emrin e gjejmë me termin **vetepasuer- it. sostantivo** dhe sipas me ndarjes së tyre në gjini: **vetepasuer mashkullor- it. sostantivo maschile, vetepasuer femnuer- it. sostantivo femminile, vetepasuer asngânxe- it. sostantivo neutro**; mbiemri është dhënë me emërtimin **pershtueshem-it. aggetivo**, ndërsa përemri ka si bazë rrënjën **êmen, perêmen- it. pronome**; pjesëza ka si pjesë të saj prapashtesën zvogëluese **–xe, fialxe-it. particella.**

Për të emërtuar ndajfoljen gjejmë termin të paraqitur edhe me ndërrime fonetike **parftillk** dhe **paraftillk –it. avverbio**, pasthirrma është pasqyruar me **neperse- it. interiezione**; ndërsa parafjala *me papriise, parpriis- it. preposizione.* Interesant është edhe termi për fjalinë, i cili në fjalor jepet me **parvuus, parvuuse- it. proposizione.**

Llojet e rasave jepen me emërtime të tilla, si **dhântore- it. dativo, êmentore- it. nominativo, vênntore- it. locativo** etj.

Emërtimet e disa mënyrave janë: **lidhtore- it. congiunzione, binntore- it. ammirativa, diftore- it. indikativa, dishrore-it. ottativo** etj.

### **1.c. Dialektologji**

Në lëmë të dialektologjisë të bie në sy termi **e folme**, i cili shënohet në italisht me dy kuptime **veprimtari ligjërimore** (it. *linguaggio*) dhe **dialekt** (it. *dialetto*), ndërsa tek Shtojca gjejmë

emërtimin më të specifikuar **dhialekt**-it. *dialetto*. Për dy dialektet janë dhënë **gegnishte**-it. *dialetto albanese ghego* dhe **tosknishte**-it. *dialetto Tosco*.

### 1.d. Leksikografi

Për këtë fushë gjejmë termat: **fialorth**- it. glossario **fialuer**-it. *vocabolario*.

Siç vërehet nga lënda e grumbulluar, ky Fjalor është mjaft i pasur me terminologji gjuhësore. Kjo terminologji ka rëndësi, sepse ravijëzoi rrugën për të mbledhur e krijuar një terminologji gjuhësore shqipe. Hartuesit e tij kontribuan në krijimin e termave të rinj, por edhe në veshjen me kuptime të reja të emërtimeve ekzistuese duke hapur kështu rrugën drejt një terminologjie gjuhësore shqipe.

“Për historinë e terminologjisë gjuhësore shqipe, kanë një vlerë sado relative, pavarësisht se nuk zënë vend të gjitha”<sup>65</sup>.

### 2. Flora dhe fauna

Pjesë e rëndësishme e fjalësit diturak të këtij fjalori janë edhe emërtimet e florës dhe të faunës. Hartuesit e këtij Fjalori kishin mbledhur një lëndë mjaft të pasur në këto fusha duke u udhëhequr edhe nga qëllimet e kësaj shoqërie për të mbledhur sa më shumë lëndë leksikore, prandaj për këtë qëllim u udhëzuan famulltarët të mbledhnin “*fjalë të rralla bimësh, pemësh, zogjsh dhe kafshësh’ duke dhënë edhe përgjegjësen italisht ose latinisht dhe duke i shpjeguar ato*”<sup>66</sup>.

---

<sup>65</sup> J. Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare* (1635-1944), Prishtinë, 1980, f. 243.

<sup>66</sup> T. Osmani, *Komisia Letrare në Shkodër* (1916-1918), Shkodër, 2004, f.138.

Një vend të veçantë zënë fillimisht emërtimet e përgjithshme për **florën** dhe **faunën**, si **ghitaar**- it. *mammi fero*, **peshk**-it. *pesce*, **shtase**- it. *germoglio, pianto, vegetale*; **shpexe**-it. *animale, selvaggio*; **xog**- it. *uccello*. Le t'i shohim me radhë disa klasa të veçanta të këtyre fushave me emërtimet përkatëse.

## 2.a. Emra zogjsh

Kjo klasë është mjaft e pasur me emërtime zogjsh nga të cilët veçojmë: **gheracine**-it. *falcone*, **harabel**-it. *canestro*; **hutfi**-it. *gufo*, ndërsa për lejlekum gjejmë emërtimin **kanushe**-it. *cicogna*. Emërtime të tjera që hasen janë: **kolumrii**-it. *prugnola*; **korb**-it. *corvo*; por për **kukuvajkën** e ndeshim emërtesën në dy variante **kukuvaie** dhe **kukuvatse** dhe të dyja me përgjegjësen në italisht *civetta*. Në dy varinate gjenden edhe **pllum** e **pullum**- it. *colombo*; **shkurte** e **shkurtez** – it. *quaglia*; **shkabe**, **shkaboie**, **shkabogne**-it, *grande avoltoio* etj.

Tek emrat e zogjve ka raste kur bëhet dallimi i gjinisë, kështu **vidaa**, për gjininë mashkullore (it. *polombo*) dhe për gjininë femërore **vide**- it. *polombella*, por edhe emërtime me zvogëlim në, **trumts**- it. *passero* dhe **trumtsak** – it. *passerotto*.

## 2.b. Emra kafshësh

Në nomenklaturën e kafshëve ndeshemi me një pasuri të madhe leksikore. Kështu për **ariun** është dhënë emërtimi **arii**, shumë afër trajtës së përbashkët, por edhe ai dialektor me një tingull protetik. Në këtë rast të dytë gjejmë edhe specifikimin e gjinisë **harushe** -it. *orsa* për gjininë femërore dhe **harushâa** –it. *orso* për gjininë mashkullore. Dallimin e gjinisë e shohim edhe në emërtimet **luaa** – it. *leone* dhe **luâne**-it. *leonessa*; **maghar**, **maghaare**- it. *asino*; **mushk**- it. *mulo*, **mushke**- it. *mula*; **syke** – it. *pecora con*

*muse nero*, **sykun-** it. *monton con muse nero*. Edhe në këto emërtime ndeshemi me variante fonetike, si **muxat, mxat** –it. *toro*; por edhe me sinonimi, si **nusex-nuse e lalës**-it. *donnola*.

Interesant është edhe emërtimi **tamlatore** (it. *animaleche da latte*) për të shënuar të gjitha kafshët që japin qumësht.. Në këtë klasë mund të gjejmë në të rrallë ndonjë huazim nga turqishtja, siç emërtimi i *tigrit* **kapllan-** it. *tigre*.

### 2.c. Zvarranikët

Një vend të veçantë zënë emërtimet e gjarpërinjve, duke i specifikuar ato sipas llojeve. Ndeshemi gjithashtu edhe në dallimim e gjinisë me anë të prapashtesave, si **gharpen** –it. *serpente* dhe **gharnushe**-it. *femmina del serpente*. Pjesë e kësaj pasurie leksikore janë edhe llojet e ndryshme të gjarpërinjve, si **rrshaie-** it. *specie di vipero*; me variante **soval, kastric** -it. *specie di serpente*. Gjinia dallohet edhe tek **bretkotse-** it. *rana* dhe për gjininë mashkullore **bretk**-it. *machio della rana*. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe emërtimet, si **hardhutse**-it. *lucartola*, **breshke-** it. *tartaruge* dhe për **breshkën e ujit** emërtimi **breshkujtse-** it. *tartaruga d'aqua*.

### 2.d. Insektet

Një tipar i këtij fjalori është edhe pasqyrimi i një numri të madh të emërtimeve të insekteve, si **greth-** it. *stroppa*, **ghingalle-** it. *cicala*, **pupaghel**-it. *cavalletta*, **mushkaie-** it. *zanzara*, **katerdhetkâmsh-** it. *millepiedi, iulo*

Me ndryshime tingujsh janë dhënë: **karabishte, karrabishte-** it. *forbicina*; **perdhetse, perdhese**-it. *formica*; **antse, anxe**-it. *vespa*. Me më shumë variante jepet emri e **merimangës**, si **marimânge, mirmânge, bairimage, bramage-** it. *ragno*. Vetë hartuesit e këtij

fjalori janë të ndërgjegjshëm se mund të jetë regjistruar disa herë e njëjta fjalë në variante të ndryshme. Kështu ata shprehen se “tui kënë mbledhun fiale shcype preie ghith ânesh e tui kënë shum here t’nnryshueme n’ t’ folun t’popullit u vënnuene n’fjaluer”<sup>67</sup>.

## 2.e. Emra peshqish

Në këto lloj emërtimesh vërejmë llojshmëri të pajisura edhe me varinate tingullore, si p.sh. për **njalën** janë dhënë **ghale**, **gnale**-it. *anguilla*. Ka raste kur përgjejjësen në italisht e gjejmë me një emërtim të përgjithshëm apo perifrazim gjë që dëshmon për një pasuri të shqipes në këto emërtime, si **kubel**, **kulbe**-it. *sorte di pesce*. Këtë gjë e shohim edhe tek **mlysh**-it. *specie di pesce simile al carpio*; **rribe**-it. *piccolo pesce*. Emërtime të tjera të kësaj klase janë edhe **koran**-it. *trota*, **levrek**-it. *branzino*, **barbuu**-it. *barbone*. Përkrah emërtimit të **krapit** – it. *carpione* gjejmë edhe emërtimin **krapulic**-it. *specie di pesciolino* për të shënuar peshqit me të vegjël me anë të prapashtesës zvogëluese.

## 2.f. Emra bimësh

Ndeshim emërtime me variante fonetike **kepurdhe**, **kpurdhe**-it. *fungo*; **labot**, **llabot**-it. *sorta di erba*; **shermashek**, **sharmashek**-it. *ellera*;

Një nëngrup mund të formohet me merta e erëzave të ndryshme, si **menner**-it. *menta*; **mullage**-it. *malva*; me dy varinate emri i **sherbelës**: **sherbel**, **sherbele**-it. **salvia**. Sërish në disa raste vëret perifrazim në përgjejjësen në italisht, si **trumxe**-it. *specie di sopo con fiori celesti*, **babanik**-it. *specie di erba medicinale*. Emërtime të tjera **mâare**-it. *corbezzolo*, **lushterik**-it. *alga*,

---

<sup>67</sup> PARATHÂNIE, *Fjalori i “Bashkimit”*, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. V.

**tershâne**-it. *avena*; ndonjë huazim nga turqishtja, si **shimshiire** –it. *bosso* nga turq. *Bush*.

## 2.g. Emra drurësh

Lënda që përfshihet në këtë fjalor përfshin edhe mjaft emra drurësh, si **laar**- it. *alloro*, **lis**- it. *albero*, *quercia*, **plep**- it. *pioppo* etj., por edhe ndonjë emërtim të huazuar nga turqishtja, si **selvii**-it. *cipresso* nga turq. *cyparis*

Kjo lëndë përmban edhe emërtime me variante fonetike, si **kshtëie**, **keshtëie**- it. *castagna*; **laithi**, **leithi**- it. *nocciuolo*; **mendull**, **mennull**- it. *mandorla* etj.

## 2.i. Emra lulesh

Nga turqishtja gjejmë: **ghenghefil**- it. *zenzero*; **xymbyl**- it. *giancito*.

Interesante janë edhe varinatet fonetike të këtyre fjalëve, si **karaifil**, **karanfil**- it. *garofano*; **trandofill**, **drannfille**- it. *rosa*; **iasemin**, **iesemin**- it. *gelsomino*

Si përfundim, mund të themi se ky Fjalor, rezultat i një pune të palodhshme të këtyre atdhetarëve, mbart në vetvete vlera të mëdha leksikografike dhe përditësimi i tij ka rëndësi pasi një pjesë e këtyre fjalëve “mund zënë shtat e të përdoren sot e gjithë ditën në standard, në vend të lumit të fjalëve të huaja të kota, që nuk kanë ndalur e herëpashere po e mbyt fjalën shqipe”<sup>68</sup>.

Pra, detyra jonë si gjuhëtarë është që të rinxjerrim edhe një herë në dukje vlerat e këtij fjalori duke e studiuar atë më në brendësi, sepse një pjesë e tij mund të shërbejë në të ardhmen për

---

<sup>68</sup> Sh. Rrokaj, *Disa parime leksikografike të zbatuaranë fjalorin e “Bashkimit”*, “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007, f. 110.



zgjerimin e fjalësit ekzistues me struktura të reja kuptimore, duke pasuruar edhe më tej standardin e shqipes, por ky fjalor mund të bëhet patjetër pjesë e fjalorit thesaurus, kur ai të hartohet, si trashigimi e vyer e leksikografisë shqiptare. Studimi i tij do të na ndihmojë edhe në njohjen e pasurisë leksikore të dialektit gegë.

### **BIBLIOGRAFI:**

1. *Fjalori i "Bashkimit"*, Prishtinë, 1978.
2. Kastrati, J., *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944)*, Prishtinë, 1980.
3. *Leksikografia e shqipes-trashigimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005.
4. Nikaj, N., *Kujtime të një jetës së kalueme*, Tiranë, 2003.
5. Osmani, T., *Udha e shkronjave shqipe*, Tiranë, 1999.
6. Osmani, T., *Komisia Letrare në Shkodër (1916-1918)*, Shkodër, 2004.
7. Rrokaj, Sh., *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007
8. Rrota, J., *Për historin e alfabetit shqyp*, Shkodër, 2005.
9. *Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, II, Tiranë, 1972.
10. Xhuvani, A., *Vepra gjuhësore*, II, Tiranë, 1990.

**The sciential wordbook in the vocabulary of  
“Bashkimi” Society**

**ABSTRACT**

In this article the author tried to analyze the vocabulary of this society in these aspects: the linguistic nomenclature, considering the terminology in general and the subsystems, such as phonetic, grammar, dialectology etc. Part of this survey is the denomination of flora and fauna.

The author adds up to occlusion that this vocabulary in the future can contribute with words from the geg dialect to enrich the Albanian standard.

## PASTË JETË TË GJATË MË SE NJË SHEKULL!

*Plus quam maneat perenne saeclo!*

Po ta kishin uruar kështu parsimin e Shoqnisë Bashkimi, në janar të 1908-ës, atëherë kur u përshfaq ky fjalor, them se do t'ishin ndjerë mirë. Po t'i kishin uruar që, veç kontributit që dha n'atë kohë, ky fjalor të ripropozohet pas njëqindvjetësh, edhe në këtë kohë, druaj se ata hartues të prunjtë do ta kishin konsideruar urimin e dytë më fort si një entuziazëm dashamirë. E pra *Fjaluer i Ri i Shqypes* sot po gatitet për t'u ribotuar në gjerdanin *Excipere*, jo vetëm si shenjë e këtij kremti jubilar, por edhe për faktin se ai ka ende për t'u ofruar dashamirëve të shqipes së mijëvjeçarit të tretë; siç ka, ende shumë, për t'iu ofruar *shkolla e fjalëve dhe e sendeve*, nën dritën e së cilës ky *Fjalor* u pat formësu.

Do ndaloj këtu në analizën e një leme të vetme nga fjalësi i këtij *diksioneri*. Them *Diksioner*, pasi me ngarkesën e vet alfabetike dhe shpjegimore, për kohën kur u pat bërë, ai paraqitet më tepër se një *vokabular* (fjalor). E kjo lemë është fjala “*atme*”, e cila pëveç ngarkesë patriotike që ka, është po aq e mbuluar me mister për secilin prej nesh. E sa më shumë studiohet përshfaqja e kësaj fjale, aq më e ndërlikuar bëhet situata historike dhe gjeografike - posë asaj semantike. Këtu nuk kam parasysh vetëm studiuesit e sotëm, që thujse nuk janë ndalur në eksplorime të mëtejshme të domethanies dhe përshfaqjes së shenjuesit “*atme*”, por kam parasysh edhe turbullinë që karakterizon shpjegimet e albanologëve të traditës.

Dua të sqaroj, për aq sa mundem, dy çështje. E para: koha relative e vendit të këtij shenjuesi në historinë e gjuhës shqipe – e natyrisht edhe shtegtimin gjeografik të fjalës në kohë. Dhe e dyta, një fthillim mbi shkallën e arbitraritetit mes shenjuesit dhe të shenjueshmit të kësaj fjale, nëpërmjet një rragimi semanto-etimologjik.

Kështu pra, duke i qëndruar çështjes së parë, mund të themi se deri në studimet e E. Çabejt fjala *atme* konsiderohej si e përshfaqur për herë të parë pikërisht te “Fjalori” i Bashkimit. Çabej në *Studimet* e tij etimologjike shkruan se “*neologjizmi atme ‘atdhe’ me atmetar ‘atdhetar’ e rretheve letrare të Shkodrës, del së pari te ‘Bashkimi’*”<sup>69</sup>. Por ndërsa për fjalën *atdhe* shprehet se “*topika e pjesëve përbërësve të tij është një formim artificial, jo një kompozit i formuar pas frymës së gjuhës popullore*”<sup>70</sup>, për fjalën *atme* nuk shprehet më, duke e konsideruar thjesht si neologjizëm. Pra konsiderohet se kjo fjalë ka lindur bashkë me shek. XX sikundër edhe *atdhe* – krijuar së pari prej Konicës më 1899. Edhe për nga ngjashmëria duket sikur këto fjalë kanë lindur në të njëjtën kohë, njëra në gegnisht e tjetra në toskërisht. Por ndërsa kemi sigurinë mbi kompozitin *atdhe*, fjala *atme*, edhe për nga përbërësit, nuk na e ofron një shkallë të tillë njohje. Mjegullia që mbështjell shenjuesin *atme* shpie në një shteg shumë më të hershëm se viti 1908, kur kjo fjalë shfaqet në Fjalorin “Bashkimi”, pasi sipas përvojës etimologjike sa më i errët t’jetë kuptimi i një fjale, aq më e vjetër është ajo në kohë. Dhe në fakt është për t’u habitë të konsideruarit e kësaj fjale si kaq e re në kohë edhe nga studiues të tjerë si Lek Gruda<sup>71</sup>, që në kapërcyell të shek. XIX e rendit bashkë me

<sup>69</sup> E. Çabej, *Studime Etimologjike* II (A-B), Tiranë 1976

<sup>70</sup> Ibidem

<sup>71</sup> (*Fjalorth shqyp-frengjisht e frengjisht-shqyp i fjalëve të reja*)

neologjizmat *mëmëdhe, atdhe, patriidhe, priunvenn* etj, apo si Mustafa Kruja në vitet '50 (*Fjalor Kritik*, Germa "A"<sup>72</sup>) – i cili shprehet për të si një "*neologjizëm tashma i vdekun*".

A vërtet bëhet fjalë për një neologjizëm? At Justin Rrota nuk e rreshton këtë fjalë në syzimin "Neologjizmat" tek "*Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*". Afërmendsh këtu nuk kemi të bëjmë me harresë ngase françeskani gjuhëtar e njihte fort mirë historikun e motos "*Për Fé e Atme*" që pat shoqëruar të gjithë aksionin e fretënve të vogjël prej fillimeve të shek. XVII e tekëndej. Dhe në fakt motoja e jezuitëve "*Për Zot, Atme e Përparim*" që shenjonte stemën e Kolegjit Saverian, themeluar në 1877 ishte e huazuar bash prej Franceskanëve.

Po si shpjegohet atëherë që fjala 'atme' nuk gjendet ndër fjalorë të shqipes hartuar nga von Hahni, Meyeri, Kristoforidhi etj.? Veç faktit se fjalësi i këtyre fjalorëve ishte pak a shumë i kufizuar, duket se kjo fjalë nuk është përdorur gjerësisht në leksikun aktiv të shqiptarëve. Pra këtë moto, me gjasë, fretnit e kanë sjellë në Shqipërinë Osmane nga jashtë vendit, aty ku dhe studiohej e lirë gjuha shqipe e ku gatuhej doktrina specifike për vendet nën pushtimin osman. E ky vend ishte Italia e Jugut me Kolegjet e saj Arbënore nën Patronimatin e Selisë' Shëjtë.

Po të kthehemi sërish në kohë të reja, shohim se në "Fjalorin e Arbëreshvet t'Italisë" (Bari 1963), E. Giordano, fjalën *atme* e konsideron ende aktive. Kjo fjalë duket se ndër arbëreshë regjistrohet së pari nga Zef Serembe që në vitin 1883, *atme* = *patria*, kur shkruante "*se atmen e dishe mirë për mot e mot*" (Se 123). Them

---

<sup>72</sup> M. Kruja, *Fjalor Kritik*, daktiloshkrim ruajtur pranë arkivit të familjes. Dorëshkrimi i plotë, me rreth 41.000 lema, konsiderohet i humbur pas Luftës. Aktualisht ruhen pjesërisht vetëm germa "A" dhe "B", të cilat së shpejti do të përshfaqen në një botim të gjerdanit "Excipere" nga botimet "Çabej".

‘duket’ pasi disa vjet mbas Serembes botohen nga Zef Skiroi “Canti tradizionali” – Këngë Tradicionale arbëreshe dhe ‘atme’ del pikërisht në vargjet “*pranë katundin e të bukurën Atme i dua*” (C. Tr. 510) apo “*për ‘ta ku mirë, isht atmeja*” (C. Tr. 510). Dy ilustrimet e mësipërme të Skiroit ku del lema jonë, nuk janë nga krijimtaria e tij vetanake, sikundër ajo e Serembes më 1883; Skiroi e ka vjelë këtë fjalë nga Folklori Arbëresh i Jugut t’Italisë. Kjo don të thotë se fjala ‘*atme*’ në këtë diasporë është tepër e vjetër, e me gjasë në kohë të shpërnguljes së tyre të dhuntë.

Si rrjedhojë kleri i kolegjeve ilirike, i destinuar për shërbim në Shqipëri, nuk krijoi një neologjizëm për ndërtimin e motos së aksionit për ringritjen shpirtnore të gjindjes shqiptare. Ai e përftoi atë, pra ‘*atmen*’, nga e folmja e Shqiptarëve t’Italisë, tek të cilët ky shenjues gjëllinte. Koncepti i atdheut kish mbijetuar atje jo vetëm i patrazuar nga feja e re, e cila sillte me vete zhdukjen e dallimeve etnike dhe të çdo ndjenje me natyrë patriotike, por për më tepër, të shpërngulurit kishin pasur edhe arsye nostalgjike për evokimin e atdheut të humbur në këngë, poezi e shfaqje të tjera kësodore. Fenomeni i konservimit është mëse i natyrshëm në kushtet e mësipërme, pasi i shkon parimit të mirënjohur të Shkollës së Fjalëve dhe të Sendeve (*Les Mots et les Choses*), i cili parim, mbijetesën e fjalës e sheh të njinjishme me mbijetesën e idesë apo sendit që fjala shenjon. M’anë tjetër, me po këtë parim spjegohet edhe arsyeja e bdarjes së kësaj fjale në Shqipërinë Osmane, bdarje e cila ndoqi dora-dorës terratisjen e idesë ‘atdhe’ n’ato kohë.

(Të jemi të qartë këtu e të mos kuptojmë me *atdhe*, në shek. XVII apo XVIII, atë që kuptojmë sot, pasi nocionet *atdhe* e *komb* kanë evoluar pa prerë, madje edhe pas rënies së mureve ideologjike si në Evropë dhe në Shqipëri) .

Pra, sikundër thamë, përsa e hershme dhe burimore që fjala ‘*atme*’, ajo nuk gjeti përhapjen e mjaftueshme në masën e shqipfolësve, por pikërisht se që gjymtyrë e një sitangme e cila u identifikua edhe me një aksion klerikal, ‘*atmeja*’ pati veç një qark të ngushtë përdoruesish diturorë (Mjedja, Fishta etj). Ndonëse krejt i ri, shenjuesi ‘*atdhe*’ e konkuroi me sukses ‘*atmen*’, pasi u zhvillua në terren laik dhe barti kumt thjesht e vetëm patriotik, duke u rrokur kësisoj nga shumica dërrmuese e shqiptarëve jo katolikë.

Së dyti, duke dashur të ndriçojmë sadopak shkallën e arbitraritetit të shenjuesit ‘*atme*’ (e për rrjedhojë edhe të çerdhes së tij leksikore: *atmì, atmetar, atmetuer* – Fj. *Bashkimi* f. 28), po bëjmë edhe një cekasë në etimonin e kësaj leme.

Ndonëse në pamje të parë duket se fjala jonë ka lidhje me rrënjën *Atë* – sikundër atdheu në gjuhët romane: *patria, patrie*, etj – në rastin e tonë, evolucioni i fjalës prej kësaj rrënje duket i pagjasë, pasi vështirësisht mund të justifikohet formanti *-me* fill pas rrënjës *Atë* - posë mungesës së një shpjegimi mbi fjalën *Atë* në rolin e shenjuesit për atdheun. Për pasojë po analizojmë “*amë*”-n si rrënjë referuese.

Te Bardhi del *mamë, amë* = për nënë, zoja e shtëpisë (*mater*), [Bardhi; *Dict. Latino-epiroticum*. f. 55-56], po ashtu *maternus* = *s’amet, maternus sanguis* = *prei ame*, por nga ana tjetër do të ketë bërë një *lapsus kalami* kur shënon lemën *materna* me gjegjësen shqipe *emta* në vend të *amta*; me lemën *emta* ai shënon me të drejtë lemën latine *amita, zia* [Bardhi; *Dict. Lat-epirot.* f. 195 tek *Nomina Foeminarum Parentum*]. Lidhur me gabimet e Frangut t’Bardhë na ndriçon shpesh M. Kruja në punimin e tij të posabotuar “*Nji studim analitik – Gjuha e Frang Bardhit dhe Shqipja Moderne*”. Gjatë shoshitjes së përimitë të Dictionariumit, Kruja vëren dhe pohon se shtypi i këtij teksti të vjetër nuk është i kthjellët, përveçse plot me

gabime, e madje sipas analizës së tij përfundimtare “*gabimet e qërtueme nuk përbâjnë mâ tepër se nja të njiqindën e gabimevet qi ka libri gjithë, të cilat nuk besoj se janë për t’i u veshun të tana shtypit, por edhe pakujdesisë s’Auktorit vetë*”. Këto gabime të Bardhit, të marra si pikë referimi janë përcjellë mandej edhe ndër albanistë a leksikografë të tjerë pas tij. Sërish Kruja e dikton ndër të tjerë këtë bartje dhe përmes shembujsh na dëftën se “*Mann-i e Kristoforidhi këto fjalë i kanë marrë me gabime*”. Gjithsesi *lapsus kalami* i Bardhit mbetet një hipotezë, së cilës i vëmë në krah gjithashtu dyshimin për një evolucion të *amte*, me përfundim mandej homonimik mes *emta* “teze” dhe *emta* “prej s’amet, amtare”. Për këtë hipotezë të dytë bëhen shkak “Studimet Etimologjike” të Çabejt, i cili në fund të analizës së lemës *emta*, dëshmon se ndër skaje linguistike të Shqipes, si b.fj. në Shupal, ky shenjues bart (apo ruan?) kuptimin *nënë*. Gjendemi përballë këtij dyzimi hipotezash, ku gjasa më të mundshme paraqet ajo e *lapsus kalamit*.

Duke iu rikthyer *Dictionariumit* të Bardhit, në këtë fjalor *materna* nuk ka si të jetë *emta*, pra shqip *teze*, pasi lema latine përkatëse do të ishte *matertera*. Pra te Bardhi, lemës *Materna* duhet t’i korrespondojë *Amte* (gjithë sipas vargut *mater = amë, materna = amte, maternitas = amni*), ndërkohë që *emta* e shqipes shenjon *tezen* apo *hallën* ende sot ndër vise shqiptare.

Kështu, për të shenjuar nocionin e *dheut amë* dikur me gjasë është thënë *dheu amte*, sikundër dëshmohet në literaturë sintagma e njohur *dheu inë*. Sa i përket fjalës *amte*, si gjymtyrë e togut të lartpërmendur, mendojmë se mbi të ka ndodhur një prapësim i trajtës *amte ~ atme*; trajtë kjo e dyta, fonetakisht më e zhdërvjellët. Modele të ngjashme me këtë shndërrim metatezik ka shumë si b.fj. *diktoj ~ dëtkoj*; *baglë ~ balgë*; *cikroj ~ cirkoj*; *pekt ~ petk* etj., etj. Metateza rezulton të jetë një nga shtigjet që gjuha zgjedh për



diversifikimin e shenjuesve, duke u pasuruar kësisoj, pasi jo rrallë metateza sjell edhe ndryshim të kategorisë gramatikore, dmth zgjerimin funksional të çerdhes. Kështu mund të ketë ngjarë edhe me togun *dheu atme* ku *atme*, tashmë e prapësuar, nga mbiemër i panyjshëm nis e sillet si emër, pra ‘*atmeja*’. Shqipja vazhdon të ruajë një mori rastesh ku e njëjta fjalë është edhe mbiemër i panyjshëm edhe emër, gjithë në varësi të kontekstit, për shembull si tek *djalë trim – trimi*. Sintagma nistore emër + mbiemër bëhet emër + emër, duke mbizotëruar gjymtyra e dytë, *atmeja*, që është përcaktuese e kumtit.

Por cila mund të ketë qenë arsyeja semasiologjike që për shenjuesin *atdhe* është përzgjedhur pikërisht rrënja *amē*? Kjo fjalë me origjinë të mirfilltë indoeuropiane, në shqipe nuk shenjon vetëm idenë e *nënës* por edhe idenë e *burimin*; ashtu si tek *ama e voevet*, *ama e lumit*, *ama e ujit*<sup>73</sup>, apo ku i del lirimit *ama*<sup>74</sup>. Në këtë mënyrë merr kuptim fjala *atdhe* si *vendi prej nga vihet, burohet*, dmth sikundër nga *nëna* (= ama) ashtu edhe nga *burimi* (= ama).

Në përfundim të këtij rragimi, ngulmoj të them se qëllimi tij nuk ishte thjesht e vetëm përcaktimi i moshës së fjalës *Atme* (në fakt mëse e moçme!) apo i viseve ku ajo rrugëtoi, por falë edhe *Fjalorit* të Bashkimit, që tash u bë shekullor, kjo fjalë mund të “rinohet” duke e hedhur në tregun tonë gjuhësor të këtij shekulli. Dhe natyrisht jo më si shenjues i një atdheu fizik, i cili tashmë për ne ekziston, por i një atdheu metaforik e ideal që ne mund të mos e gjejmë kurrë, porse gjithnjë do ta kërkojmë. Atë atdhe që qëndron në themel të ëndrrave tona!

---

<sup>73</sup> N. Gazulli, *Fjalorth i Ri me fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnis*, 1941, f. 45.

<sup>6</sup> N. Mjedja, “Liria”, 1887.

## FRAZEOLGJIZMAT NË FJALORIN E “BASHKIMIT”

Pajisja e Fjalorit të “Bashkimit” edhe me një numër relativisht të lartë të frazeologjizmave (janë rreth 210), mendojmë se është një tregues cilësor i hartimit të një fjalori dygjuhësh për kohën kur u krijua.

Autori (apo autorët) kanë pasur parasysh që në fjalësin aktiv të regjistruar, të sjellin mjaft frazeologjizma, të cilat i kanë gjetur të rrafshit të ligjërit të përditshëm nga veprimtaria e thjeshtë e konkrete e njerëzve dhe është e natyrshme që në një fjalor para një shekulli të kërkojmë ato zhvillime dhe nivele të frazeologjisë që pasqyrojnë vetë nivelin e gjuhës në përgjithësi; pa u përpjekur të gjejmë tek Fjalori i “*Bashkimit*” frazema apo shprehje të figurshme të rastit, të quajtura ndryshe edhe “fjalë fluturake”, si: *vret larg, gjuan lart* etj., që, në një farë mënyre janë produkt i zhvillimit të figurshëm të letërsisë artistike, apo që mund të grupohen të një niveli intelektual të veçantë.

Duhet thënë se “*studimi i frazeologjisë bëhet gjithnjë brenda kufijve të tekstit (të mikrotekstit a të makrotekstit) dhe në dritën e analizave stilistike*”, pasi, siç nënvizon Jani Thomai, “*teksti lingvistik merr rëndësi të veçantë, sepse në përmbajtjen e tij njësitet frazeologjike, në shumë raste, zënë pozitë kyçe...në lidhje me sqarimin e raportit “semantikë // funksion”, apo edhe “denotacion // konotacion”*”.<sup>75</sup>

---

<sup>75</sup> Jani Thomai, *Frazeologjizmat në gjuhë shqipe*, Tiranë, 1999.

E theksojmë këtë pasi, për të gjykuar në thellësi e në gjerësi për frazeologjizmat e këtij Fjalori njëqindvjeçar, hulumtuesit i duhen patjetër përdorime më konkrete të këtyre njësive në tekste të shkruara të kohës, të cilat mund të silleshin në Fjalor, siç është vepruar me fjalorët shpjegues pas Luftës II Botërore, përndryshe në vitet 80 e këndej.

Në Fjalor kemi vërejtur se, si njësi frazeologjike, janë marrë togje fjalësh me kuptim të figurshëm (me substancë idiomatike) të ngurosura dhe me ngjyrim emocionues – shprehës, si: *me mete a me u bâa hardap, me marre malin etj.*

Kjo vepër leksikografike pasurinë e frazeologjizmave më së shumti e sjell si zgjerim a metaforizim gjatë shpjegimit të fjalëve, si psh.: te leksema *hap-i* – folje shpjeguar me italishten *tendere, aprire, schiudere, divulgare e spalancare (italisht)* - gjendet hapësira për të shënuar përfitim e frazeologjizmit “ *me i hape syt kuie(shqip)* – semantikisht e barabartë me “ *aspettarsi un favore da qualche d’uno*” (italisht), ( *me pritë një nder prej dikujt*) (shqip).

Por, nuk janë të rralla rastet kur gjejmë të regjistruar zëra frazeologjikë më vete, si: *lkurem (unit), u lkura, m’u lkure unit* (me folje – siç e quan autori – ftper = *ftillk perpaltuer* – folje rifleksive ose reciproke; semantikisht : *attacarsi la pelle alle ossa dalla fame, morir di fame* (italisht) – *me vdekë prej unit (shqip)*.

Mund të themi pa mëdyshje, se kushdo që ia hyn të vështrojë frazemat e Fjalorit, arrin në përfundimin, se në mënyrë praktike, hartuesi ka zbatuar parimin se “ *Frazeologjia nis atje, ku kuptimi i lirë leksikor i fjalës mbulohet nga kuptimi i figurshëm i togfjalëshit të qëndrueshëm*”, duke pasur përherë vlerë shënuese dhe shprehëse.

Me anë të frazeologjisë së pasur, të përdorur tek ky Fjalor, shfaqet veçoria kombëtare e gjuhës sonë, historia e zhvillimit të saj, karakteri dhe psikologjia e vetë popullit, doket dhe zakonet e asaj

periudhe. Prania e frazeologjizmave (të tipave të ndryshëm)-shënuar në këtë Fjalor, që po bëhet objekt i kësaj Konference – dëshmon dhe fikson më së miri një rrafsh të caktuar të gjuhës së folur dhe asaj të shkruar, pëndryshe variantit më të përparuar të gegërishtes letrare.

Shumica e frazeologjizmave janë të ligjëritimit bisedor. Ky karakter shprehet në gjymtyrët përbërëse të tyre. Disa nga ato ndërtohen me fjalë që shënojnë pjesë të trupit, psh.: *me vuu ag syyt, coke doren, me derdhe xorret pertoke, kam goie, me i gnite doren, me i hape syyt kuie, me hieke me krye, me marre vesht, me e marre m'syysh, me marre n'café, me marre n'per kame, me marre n'per dore, me marre m'thue* etj; me sende që i ndeshim çdo ditë psh.: *me raa m'braxe, me marre malin, me lnue varren a xemren, me marre fushat, me maree ghakun a t'kecen, me i marre hanes, me marre udhe, me thane a me chue meshe, me mushe pushken, ngrehi shpiin, ngrehi rrasa a kurthe, me pree paxarin* etj; me fjalë që shënojnë bimë ose kafshë psh.: *kalit ia merr ana, xuna qeet, me pre thekun, me vuu n'shoshe* etj, etj.

Meqenëse në gjuhën shqipe njësitë frazeologjike mund të kenë strukturën e një togfjalëshi ose strukturën e një fjalie, një klasifikim të tillë kemi bërë edhe për frazeologjizmat e Fjalorit të “Bashkimit”, i cili vjen si më poshtë:

a) njësi frazeologjike me strukturë togfjalëshi, sipas kategorisë leksiko-gramatikore të gjymtyrëve përbërëse gjejmë:

- **folje + emër**: *coke doren, kam goie, lkurem unit, asht me lnii, me marre fryme, me marre vesht, ngrehi shpiin, me ngrehe rrasa a kurthe,*

*me marre dheen, me vuu oroe, me bâa palle, perxihet moti, shuke xanin, me vuu doreme marre malin, me dale fare, me ra fashe, me chue meshe* etj.

- **folje + ndajfolje:** *me bâa gadi, me marre mprapa, me dale shpraxte, me raa t'pakte, me cite perpara, me prite mire, me marre xhari, me marre m'thue, me vuu ne shoshe etj.*

b) **njësitë frazeologjike me strukturë fjalie:** *ghit ban, ghit thue, me mete a me u bâa hardap, me lidhe me fiale, me i dhane maie, kalit ia merr anna, me e marre me menn, me m;i marre meet, me e marre m'lavd, me thane a me mushe pushken, me mete m' udhe t'madhe, ia bâa nakel, me bâa pale me menn, iam plaste me t'paa, nuk m'del red a renn, m'u vuu syy me syy, me cite mas shpinet, me i raa me teste, m'trete e gnyemia e ftyres, asht m'vlug t'vet, m'baine syyt ylber , i ka ketsye murdari etj.*

Një tjetër klasifikim që u kemi bërë frazeologjizmave të Fjalorit të “Bashkimit”, është edhe ai sipas vlerës leksiko-gramatikore.

a) **njësi frazeologjike mbiemërore:** Kanë kuptimin kategorial të mbiemrit. Si të tilla mund të përmendim: *lueitun mennsh* ( i krisur ); *me mete shah* ( i palëvizur ); *me m'shperblee giuha* ( i shkathët në të folur ); *me mete toper* ( i izoluar, konfuz); *me i vuu mennen* ( i kujdesshëm );

Vemë re se këto njësi frazeologjike nisin me parafjalën me.

b) **njësi frazeologjike me vlerë foljore,** të cilat mund t'i klasifikojmë në këto nëngrupe:

- **folje + emër:** *me paa annerr, me bjerre uxdajen, me bâa beian, me ia blee mennen, me u bâa vena blude, coke doren, me bâa chevre, me marre fryme, me marre fushat, me lueit kurtine, me raa kopos, m'kaa âna, shuke xanin, me marre udhe, me hieke meshen, me maite mnii, me rrudhe krahet, me raa t'pakte, perxihet moti, me vuu kunore, me cite xhigla etj.*

- **folje + ndajfolje:** *me bâa beli, m'u bâa berllok, m'vjen bet, me marre m'syysh, me marre mrapa, me dale shpraxte, ia bâa nakel, me kene per ngute, me cite perpara, me dale perpara, me mete shah,*

*ma bâa amel* etj.

Përsa u përket ndërtimeve me pjesë të tjera të ligjëratës, ato nuk i kemi ndeshur në këtë Fjalor, çka s'mund të dëshmojë që mungonin në përdorim në gjuhën e gjallë të popullit, por duhet thënë se autorit, ose i kanë anashkaluar, ose nuk ka arritur t'i regjistrojë.

Në këtë vepër gjuhësore ka frazeologjizma, shpjegimi i të cilave jepet në shqip, por pjesa më e madhe e tyre shpjegohen drejtpërdrejtë me italishten, kjo sepse italishtja asokohe njihej mjaft mirë në nivelet intelektuale (sidomos midis klerit katolik), fakt që tregon se ishte më e thjeshtë të jepej një shpjegim krahasues në gjuhë të huaj sesa në shqip. Disa prej tyre janë përdorur më shumë se një herë psh.: *me vu oroe, me vu kunore*. Gjatë hulumtimit kemi gjetur një numër jo të vogël frazemash, që sot nuk kanë më fushë përdorimi, ndërkohë që nuk janë të pakëta edhe ata që kanë arritur me përdorim bindës deri në kohët tona duke i dhënë ende forcë e shprehësi ligjërit bisedor, apo edhe në rrafshin e shkruar, si psh.: *me vuu agg syyt, me pre thekun, me ma lane shtupe, me vuu n'shoshe, me ba lanet a nalet* etj.

Gjithashtu në këtë Fjalor ndeshim shumë frazeologjizma, të cilat duke i bërë një krahasim të hollësishëm me fjalorët frazeologjikë të sotëm, siç është ai i J. Thomait (1999), apo duke u nisur nga numri i madh i turqizimeve, me fjalorin e T.Dizdarit dhe të L.Latifit, vërejmë se ato nuk kanë përdorim, dhe si të tilla mbesin pa shpjeguar. Kështu, mund të përmendim: **me paa -nnerr** - *ëndërroj* (shpjegimi në italisht), (f. 24); **m'vjen bet** - *m'vjen kec a ranne jose marre* (f. 41); **coke doren** - *afroj dorën për t'u përshendetur* (shpjegimi në italisht), (f. 67); **m'u enne** - *shëtis, vrapoj lart e poshtë* (shpjegimi italisht), (f. 103); **me ba fet** - *me fitue, me ngadhgnye* (f. 108); **me raa humak** - *të zhyturit e kafshëve* (shpjegimi në italisht), (f. 130); **ghit b-n, ghit thue** - *çfarë bën, çfarë*

*thua* (shpjegimi në italisht), (f. 142); **me mete a me u b-a hardap - jam i shëndoshë ose i pandjeshëm si trung** (shpjegimi italisht), (f. 154); **me hieke mire** - *jetoj mirë në mirëqënie* (shpjegimi në italisht), (f. 159); **me hieke keq** – *vuaj (nga uria)*, (shpjegimi në italisht), (f. 159); **me b-a iasak** - *mos me l-ne, me nnalue* (f. 166); **me b-a kail** - *me i'a shtii n'krye a me vullnnesue* (f. 175); **m'u chue kakush** - *fryhem* (shpjegimi në italisht), (f. 176); **me raa kop»s** - *gjindem në siklet* (shpjegimi në italisht), (f. 201); **me lueit kurtine - tall, vë në lojë** (shpjegimi në italisht), (f. 219) etj., me radhë.

Një tjetër element të rëndësishëm, që vërejmë tek frazeologjizmat e Fjalorit të Bashkimit, është fakti, se shumë prej tyre, kanë një shpjegim të ndryshëm sot, madje mund të përdoren edhe në një trajtë tjetër. Kjo mund të ndodhë sepse vetë leksemat sot nuk gjejnë më fushë përdorimi, duke kaluar në arkaizma, dhe si të tilla zëvendësohen me fjalë të tjera. Gjithashtu, kemi edhe fjalë turke, të cilat sot janë mënjanuar nga ligjërimi bisedor (ndonëse ka shumë prej tyre të cilat përdoren edhe sot, kjo varet nga zonat, të cilat kanë ruajtur edhe sot të folmen tradicionale), dhe si të tilla, edhe shprehjet e formuara prej tyre nuk përdoren më. Kështu mund të përmendim: **m'kaa -nna** - *më pëlqen* (shpjegimi në italisht), (f. 24). Një shprehje e tillë tek Fjalori i sotëm (1999) nuk e takojmë, por e ka sinonimin e saj, duke zëvendësuar arkaizmin *anna (anda-ënda)*, një fjalë tipike e gegërishtes veriore, me fjalën *qejfi*. Atëherë, kemi frazeologjizmin **ia ka qejfi** - *e do, e pëlqen, e dëshiron, do që ta ketë e ta shtjerë në dorë* (f. 815), (FFGJSH 1999); **Me bjerrë uzdajen - heq shpresën** (shpjegimi në italisht), (f. 24). Kjo shprehje nuk gjen vend tek Fjalori i sotëm (1999), por gjejmë sinonimen e saj, sepse fjala *uzdajë*, tashmë i përket stilit bisedor. Në vend të saj përdorim *shpresë* dhe kemi frazeologjizmin **m'i preu shpresat** - *nuk më la më*

*të shpresoj për diçka, më bindi që të mos shpresoj kot* (f. 958); **M'u mledhë n'vedi** - *vërvitem, vërsulem* (shpjegimi italisht), (f. 53). Tek FFGJSH (1999) e ndeshim këtë shprehje, por në një trajtë tjetër dhe me dy kuptime të përafërta me njëra-tjetrën; **e mblodhi veten** - **1. u çlodh, 2. u qetësua e u përmbajt si duhet; nisi ta zotërojë veten e të përmbahet (f. 1094); **Me dale fryma** - *jap shpirt* (shpjegimi italisht), (f. 311). Të njëjtën shprehje frazeologjike e kemi edhe tek Fjalori (1999), por në dy trajta me kuptime të ndryshme; **i doli fryma** - **1. vdiq, 2. u lodh, u këput** dhe **i ka dalë fryma** - *është bërë pa shije* (përdoret zakonisht për pije, duhan etj), (f. 311); **Me shkue giobe** - *shkatërrohem fare* (shpjegimi në italisht), (f. 140). Këtë shprehje me të njëjtën trajtë si tek “Bashkimi”, nuk e kemi tek Fjalori i sotëm (1999), por ekziston një formë tjetër që mund t'i përafrohet asaj; **ia prenë gjobën** - *e detyruan të përgjigjet për fajin që ka bërë, e dënuan sipas fajit* (f. 396); **Me i gnite doren** - *ndihmoj* (shpjegimi në italisht), (f. 147). Në Fjalorin e sotëm frazeologjik (1999) e kemi një shprehje të tillë, përsa i përket kuptimit, por në një trajtë tjetër; **të jep dorë** - *të lehtëson punën, të vjen në ndihmë; të leverdis, të intereson* (f. 222). Shprehjen e mësipërme (tek Bashkimi) e kemi më të përdorshme në ligjërimin bisedor edhe sot; **Me i hape syt kuie** - *pres një nder nga dikush* (shpjegimi italisht), (f. 153). Këtë shprehje frazeologjike e kemi në shumë trajta tek Fjalori i sotëm (1999), por asnjëra prej tyre nuk jep shpjegimin që kemi tek Fjalori i “Bashkimit”; **hap sytë** - **1. çuditë nga diçka e papritur, befasohem 2. kam kujdes të mos më ndodhë gjë, jam syçelë, 3. arsimohem, marr dije e njohuri; i hapi sytë(dikush)** - **1. ka filluar t'i shohë gjërat ashtu siç janë në të vërtetë, po i kupton drejt 2. është arsimuar, ka marrë dije e kulturë; i hap sytë(dikujt)** - **1. i jap dije e kulturë, i zgjeroj horizontin, e zhvilloj 2. e bëj t'i shohë****



gjërat ashtu siç janë në të vërtetë, i zbuloj të vërtetën, e bëj të kuptojë si qëndron puna; **hapi sytë** - ki kujdes!, ruaju! Mos rri i shkujdesur **2.** shih mirë e kupto se si qëndron puna; **i hap syrin dikujt** - e përkëdhel shumë a i bën lëshime, duke e përkrahur në veprime të palejueshme, e mëson keq, e llaston; **iu hap syri (dikujt)** - **1.** mori guxim, **2.** e kanë përkrahur jashtë mase a e kanë llastuar **3.** është përvëlur për dikë a për diçka, mezi e ka pritur; **iu hapën sytë(dikujt)** - **1.** ka filluar t'i shohë gjërat ashtu siç janë në të vërtetë **2.** ka marrë arsim, dije e kulturë, merr vesh ç'bëhet, ka njohur njerëz e vende të tjera, (f. 895). Pra, kemi një shpjegim krejt të ndryshëm nga ai që na jepet tek "Bashkimi"; **Me hieke me krye** - shlyej me humbjen e kokës (shpjegimi në italisht), (f. 159). Një shprehje me të njëjtën trajtë nuk e gjejmë sot, por nga kuptimi afrohet me shprehjen: **ia hëngri kokën** - **1.** e mërziti shumë duke i kërkuar vazhdimisht diçka **2.** e çoi drejt vdekjes, e shpuri në varr e vdiq (f. 519); **Me i dale kuie n'balle** - kundërvihem, i rezistoj dikujt (shpjegimi në italisht), (f.178). Nuk e ndeshim si shprehje frazeologjike tek Fjalori frazeologjik (1999), por e kemi një trajtë sinonime: **bëj ballë** - **1.** i qëndroj pa u përkulur, e përballoj, **2.** arrij të bëj diçka; **Me marre male a malin** - rebelohem (shpjegimi në italisht), (f. 254). E gjejmë këtë frazeologjizëm në dy kuptime; **mori malet-1.** iku shumë larg e për një kohë të gjatë a për t'u fshehur, **2.** u cmend, s'e kontrollon më veten (f, 1999, f. 642); **Me marrë m'syssh** - magjepsem (shpjegimi në italisht), (f. 254). Në këtë trajtë nuk e gjejmë tek Fjalori i sotëm (1999), por kemi sinonimen e saj; **e hëngri me sy** - **1.** e shikoi me ngulm a me vëmendje të madhe ngaqë e dëshironte shumë, **2.** e shkali; e mori mësysh (f. 894); **Me marre dielli a hyit** - përcënim i diellit ose i yjeve (shpjegimi në italisht), (f. 254). Këtë shprehje frazeologjike nuk e ndeshim tek FFGJSH

(1999). E vërejmë vetëm tek Fjalori i 1954; **ka marrë dielli dhenë** - *perëndoi* (f. 83); **Me pree paxarin** - *fiksoj çmimin* (shpjegimi në italisht), (f. 362). Këtë shprehje e gjejmë sot me dy kuptime, ndër të cilët vetëm i pari përkon me atë të “Bashkimit”, ndërsa i dyti është kuptim i figurshëm; **e pres pazarin** -1. *e ndaj fjalën, merrem vesh përfundimisht*, 2. *këput çdo lidhje me të* (F, 1999, f. 740) etj.

Fjalori i “Bashkimit” i vitit 1908 (së bashku me atë të Kristoforidhit), jo vetëm që është vepra leksikografike më e përparuar dhe më e pasur në këtë fushë, krahasuar me të gjithë fjalorët dygjuhësh të dy shekujve më parë, por rreshtohet denjësisht për nivelin shkencor edhe me fjalorët e hartuar më pas (si dygjuhësh ashtu edhe ata shpjegues), që u hartuan më pas deri në Fjalorin e vitit 1954.

#### **BIBLIOGRAFIA:**

1. Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë: *Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Vepra I – II, Tiranë 1972; Vepra III, Tiranë, 1989.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë: *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2006.
3. Ashta, Kolë: *Leksiku Historik i gjuhës Shqipe II*, Shkodër, 1990; III, Shkodër, 2000; IV, Shkodër, 2002.
4. Cipo, Kostaq; Çabej, Eqrem; Domi, Mahir; Krajni, Anton; Myderrizi, Osman: *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1954.
5. Demiraj, Shaban: *Rëndësia e alfabetit të Shoqërisë “Bashkimi”* (1899) “Gjuha Jonë” 3 – 4, Tiranë, 2000.
6. Dizdari, Tahir: *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
7. *Fjalori i Bashkimit* (1908), Prishtinë, 1978.

8. Latifi, Lindita: *Mbi huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit*, Tiranë, 2006.
9. Lekaj, Ferdinand; Simoni, Zef: *Fjalor italisht - shqip*, Tiranë, 2000.
10. Mansaku, Seit: *Përmasa historiko-etimologjike në leksikografinë e shqipes*, në *Leksikografia shqipe Trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005.
11. Osmani, Tomor: *Shoqëria “Bashkimi” e Shkodrës dhe ndihmesa e saj për lëvrimin e gjuhën shqipe*, “Komisia Letrare Shqipe në Shkodër”, 2004.
12. Osmani, Tomor: *Udha e Shkronjave Shqipe*, Shkodër, 1999.
13. Quku, Mentor: *Mjeda 3, Libri i parë*, Shkodër.
14. Rrokaj, Shezai: *Disa parime leksikografike të zbatuara në Fjalorin e “Bashkimit” në botimin “Çështje të gjuhës shqipe”*, Tiranë, 2007.
15. Samara, Miço: *Rreth vlerave leksikografike të Fjalorit të Shoqërisë “Bashkimi” (1908) në botimin “Hulumtime në Leksikografi”*, Tiranë, 2000.
16. Shkurtaç, Gjovalin: *Elemente etnokulturore në fjalorë të shqipes*, në *Leksikografia shqipe Trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005.
17. Xhuvani, Aleksandër: *Fjalori i “Bashkimit” (1911) në botimin, Vepra II, “Trashëgimia kulturore e popullit shqiptar”*, Tiranë, 1990.

**The Dictionary of “Bashkimi Association” - Albanian  
phraseology**

***ABSTRACT***

The author (or authors) have represented in the active dictionary registered, to bring a lot of kind of phraseologies, that are found in the linguistic plain, in the simple and concrete activity of people and is natural to search these developments and levels of phraseology in a dictionary made hundred years ago, that represent, in common, the level of our language.

By means of affluent phraseology used in this dictionary, appears the national feature of our language, the development of her story, the character and psychology of our people, the customs of this period of time.

Presents phraseology in this dictionary gives us a given plain of the spoken and written language, nevertheless of the advanced edition of the literary geg.

Artan HAXHI, Tefë TOPALLI

## SHTRESA STILISTIKORE NË FJALORIN E SHOQËRISË “BASHKIMI”

Fjalorët e ndryshëm shpjegues njëgjuhësh apo dygjuhësh qofshin mund të vështrohen nga pikëpamje të ndryshme, si : nga norma leksikore dhe zbatimi i saj, nga fondi vendas e huazimet, nga gramatika, etnokultura, fjalëformimi, etimologjia, pasuria frazeologjike, semantika e fjalësit, terminologjia, fushat e përdorimit, nga çështje të sintagmatikës etj., por ato mund të kundrohen edhe në rrafshin e stilistikës gjuhësore, të regjistrave dhe të përdorimit në variantet ligjërimore.<sup>76</sup> Parë historikisht dhe sipas traditës sonë leksikografike, që nga hartimi i të parit fjalor dygjuhësh prej Frang Bardhit e këndej, të dhënat e mësipërme zakonisht i përkasin periudhës së gjuhësisë moderne (tek ne pak më e shkurtër se njëshekullore). Kështu, për shembull, në fjalorin më të madh italisht shqip, prej 1 147 faqesh, hartuar njëqind vjet më parë nga misionari italian Antonio Buseti<sup>77</sup>, dëshmohen të dhëna të tilla

---

<sup>76</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë*, “Mësonjëtorja”, Tiranë, 2005; shih tematika e Konferencës Shkencore, 3 dhjetor 2004.

<sup>77</sup> Antonio Buseti, *Vocabolario Italiano-Albanese*, compilato dal P. Antonio Buseti S.J., Scutari d’Albania, Tipografia dell’Immacolata, 1911. Ky autor i huaj, por që ka dhënë një ndihmesë të njohur për zhvillimin e arsimit në Shqipëri (Kolegja Saveriane – Shkodër), ndër të tjera, ka hartuar edhe dy gramatika: *Pratica e Grammatica della Lingua Albanese*, con 158 Esercizi ed un rispettivo Vocabolario, Shkodër, Shtypshkroja e Zojës s’Paperlyeme, 1914 (me 293 faqe), dhe *Grammatica Albanese*, seconda edizione interamente rifatta, Scutari, Tipografia Immacolata Concezione, 1933 (me 167 faqe).

të përdorimit stilistikor të fjalësit; ndërmjet 26 shkurtimeve të përdorimit të fjalorit si shënime gjuhësore (për kategoritë gramatikore të numrit, të gjinisë, të lakimit, të zgjedhimit, të etimologjisë - kryesisht për fjalët turke e arabe), gjejmë gjithmbarë edhe 4 vërejtje me karakter stilistikor, si: *fig.* (figuratamente – kuptimi i figurshëm); *fis.* (físicamente – fizikisht); *mor.* (moralmente - fjalë e përdorimit në sferën morale); *n.* (neutro – asnjëse, pa ngjyrim stilistikor).

Kjo mangësi e fjalorëve tanë dygjuhësh, por jo vetëm për këta, ka vazhduar deri tek Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954<sup>78</sup>, në të cilin gjejmë vetëm 26 shënime stilistikore dhe përdorimi, ndërkohë që Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe (1980) ka plot 100 shpjegime të tilla<sup>79</sup>. Ali Dhrimo nënvizon se *e metë tjetër e këtyre fjalorëve është mungesa e shtresëzimit stilistik të fjalëve, ku përdoruesi nuk dallon dot fjalët e gjuhës vulgare a të gjuhës së folur nga ato të stilit të lartë a poetik, si dhe ato që përdoren në fusha të ndryshme, si: në bujqësi, në kimi, në fizikë etj.*<sup>80</sup> Studiuesi Dhrimo thekson me të madhe : *“Nga gjithë ky parashtrim del se në hartimin e fjalorëve dygjuhësh problem mbetet mungesa e jetës së fjalës.”*<sup>81</sup>

Ndërkohë Fjalori i Shoqërisë “*Bashkimi*”, i dalë në vazhdën e gjatë të fjalorëve dygjuhësh që ishin hartuar deri atëherë<sup>82</sup> (kryesisht

---

<sup>78</sup> Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë, Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1954.

<sup>79</sup> Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 1980, f. XXI – XXIII.

<sup>80</sup> Ali Dhrimo, *Probleme teorike dhe praktike për hartimin e fjalorëve dygjuhësh*, në Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë*, “Mësonjëtorja”, Tiranë, 2005, f. 223.

<sup>81</sup> Po ai, po aty, f. 226.

<sup>82</sup> Shih: Ali Jashari, *Përimtime rreth frazeologjisë shqipe*, në Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë, “Mësonjëtorja”, Tiranë, 2005, f.142,

nga dijetarë të huaj), është cilësuar nga leksikografia jonë dhe studiuesit tanë si fjalori më i mirë i botuar deri më 1908, i cili, sipas Aleksandër Xhuvanit, “*tue u përmirësuem e tue u shtuem mund të zejë vendin e një fjalori akademik të gjuhës sonë.*”<sup>83</sup>

Sa i takon kësaj vepre të çmuar leksikografike, Miço Samara ka vënë në dukje mjaft vlera, duke theksuar se Fjalori “*u hartua dhe u botua në rrethana të veçanta historiko-kulturore, në fund të shekullit XIX e në fillim të shekullit XX...ai, megjithëse ka pamjen e një fjalori dygjuhësh (shqip-italisht), ka disa arsye që mund të quhet Fjalor i shqipes, sepse ai u nis të hartohet si i tillë dhe në mjaft raste aty pasqyrohet vetëm fjala shqipe, pa përgjegjësen italisht...ai pasqyron një thesar të madh shprehjesh dhe fjalësh shqype prej ghith anësh*”.<sup>84</sup>

Është e natyrshme të mendohet se dijetarët dhe filologët, autorë të Fjalorit të vitit 1908 (nëse kjo vepër është kolektive dhe jo vetëm e Dodë Kolecit), mund ta kishin pajisur fjalësin e pasur të tij edhe me shënime stilistikore, së paku, në nivelin e fjalorëve të tjerë para tij, por duket se kjo e metë ka ardhur si kërkesë kategorike për ta publikuar atë sa më shpejt, në zbatim të detyrës së shtruar nga Shoqëria “*Bashkimi*” për bashkim të dialekteve dhe njësimin e shqipes në një gjuhë të vetme të përbashkët<sup>85</sup>. Prandaj Fjalori i “*Bashkimit*”, në faqen 15, tek zëri *T’discaruem t’fjalve t’shkurtueme* (Spiegazione delle parole abbreviate), ka vetëm të dhëna dhe shënime për gramatikën formale të leksemave, madje, edhe me

---

nota7. *Këtu kemi ndër sy fjalorë të tillë, si: F.Rossi, Vacabolario Epirotico-Italiano, v.I. Roma, 1866; Jak Jungu, Fjaluar i voghel scryp e ltinisct, N’Scoder, 1895.*

<sup>83</sup> Sipas Miço Samarës, në *Hulumtime në leksikografi*, Panteon, Tiranë, 2000, f. 32.

<sup>84</sup> Po ai, po aty, f. 33.

<sup>85</sup> Miço Samara, *Hulumtime në leksikografi*, Panteon, Tiranë, 2000, f. 33.

përpjekje për një terminologji të veçantë, si: *vetepasuer* (emër), *pershtueshem* (mbiemër), *perfillak* (ndajfolje), *shumuer* (shumës), *vechuer* (njëjës), *lidhtore* (lidhëz), *ftillk* (folje), *ftillk vepruer* (folje veprorë). Nga ana tjetër, një cilësi jo aq e pohuar e këtij fjalori është fakti i shënimeve kompetente për etimologjinë e shumë fjalëve, duke i përcaktuar ato si: *italiane*, *sllave*, *turke*, që kanë hyrë prej atyre gjuhëve e përdoren prej kohësh në ligjërimet e shqipes. Me rëndësi është të nënvizohet fakti se studiuesit tanë kanë vërejtur që hartuesit e Fjalorit janë mbështetur tek vepra e Kristoforidhit (sa i përket anës shkencore dhe vjeljes) dhe tek shkrimtarët e vjetër të Veriut (Bardhi, Budi e Bogdani) sidomos për burimin leksikor.

*“Termi shënime stilistike, - shkruan Xhevat Lloshi, - nëpër fjalorë merret me kuptim të gjerë, praktikisht, për gjithçka tjetër, me përjashtim të shënimeve gramatikore, semantike (figurative, sinonimet, antonimet etj.) dhe etimologjike, duke i dalluar ato në katër grupe :*

- A. Shënime për ngjyrimet subjektive ose emocionale-shprehëse (keqësuese, përkëdhelëse, tallëse etj.),*
- B. Shënime për karakterizimin kohor (historizma, fjalë të vjetruara),*
- C. Shënime për sferat e përdorimit funksional,*
- D. Shënimet për shtresat stilistike, që quhen regjistra të gjuhës.”<sup>86</sup>*

Për të gjitha këto klasifikime, për të qenë të saktë, natyrshëm, çdo hulumtuesi leksikograf (*qëmtuesi e gardiani të fjalës*, siç i

---

<sup>86</sup> Xhevat Lloshi, *Shënime stilistike në fjalorët e shqipes*, në Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë, “Mësonjëtorja”, Tiranë, 2005, f. 111.



karakterizon studiuesi Bulo<sup>87</sup>), do t'i duhej jo vetëm fjalori, por më së pari teksti sipas regjistrave dhe stileve të ndryshme të gjuhës, nga letërsia, legjislacioni, publicistika e kohës kur hartoheshin këto vepra etj.. Por, duhet theksuar se edhe me grupimin që përmban burimet etimologjike të një fjalori, mund të nxirret roli stilistik i kësaj shtrese, pasi turqizmat, italianizmat apo sllavizmat – të përcaktuara filologjikisht në fjalorin e “Bashkimit”, kanë shërbyer për krijimin e stilemave të ndryshme dhe karakterizimin e personazheve në letërsi, duke pasqyruar sjelljen e botën e tyre psikike. Kështu, me fjalët orientale të këtij Fjalori : *aba* (zhgun), *abolla* (me qëllim që), *açik* (qartë), *açikoj* (shfaq qartë), *açikllëk* (kthjelltësi, qartësi), *açikshëm* (kthjelltas), *i açikuem* (i qartë, i kthjelltë) apo me çerdhen e fjalëve me burim turk: *adet* (doke, zakon), *adetçe* (dokisht, simbas dokes), *adetshem* (i zakonshëm)<sup>88</sup>, mund të kalojnë në koherencë semantike dhe, në pikëpamje gramatikore, kanë mundësinë të krijojnë bashkëlidhje me pjesë të tjera të ligjëratës, çka kushtëzohet nga dukuria e valencës, të cilën e kanë jo vetëm foljet, por edhe kategori të tjera morfologjike (emrat). Duke iu drejtuar një konteksti të kohës, fare mirë mund të mendojmë se fjalët e mësipërme do të krijojnë çifte a grupe me vlerë stili në thënie të ndryshme, si :

*Ç' e ke atë abë fustani !*

*Ti bën kështu, abolla të dukesh i mençur!*

*Fol më açik, se nuk të marrim vesh!*

*Açikoje fjalën, se nuk e kuptojmë ku do të dalësh!*

*Pse, açikllëk i thua ti kësaj, kur gjysma e fjalëve nuk të*

<sup>87</sup> Jorgo Bullo, *Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë*, “Mësonjëtorja”, Tiranë, 2005, f. 8.

<sup>88</sup> Fjaluer i Rii i Shcypes, Perbam Prei Shoqniit t’ Bashkimit, Shkoder, Kallnuer 1908, f. 17, 18.

*kuptohet!*

*Më açikshëm shprehu!*

*Duhet të jesh më i açikuem, bre djalë!*

*Eja të bëjmë adetet që duhen!*

*Të sillemi me adete, se kështu e kërkon vendi ku ndodhemi!*

*Është djalë me të vërtetë i adetshtëm!*

Kuptohet që një e folur e tillë sot na tingëllon arkaike e na shkakton të qeshur, po edhe në fillim të shekullit XX mund të kenë qenë të tilla, sipas situatës dhe përdoruesve të gjuhës; apo kanë përbërë thjesht elemente të të folurit informal.

Po kështu, me fjalën turke *ashash*<sup>89</sup> - *lule ghelet, lulëkuqe e opiumit*, mund të bëjmë lidhje të tilla sintagmatike :

*ke marrë ashash,*

*përdor ashash,*

*pi ashsh,*

*të ka dehur ashsh,*

*klani i ashshit etj..,*

të cilat, përveç karakterizimit të drejtpërdrejtë, marrin edhe kuptime të figurshme për të paraqitur një gjendje anormale të sjelljes apo veprime jo të zakonshme në familje ose në shoqëri.

Në raste të ndryshme turqizmat (orientalizmat) e Fjalorit kanë vlejtur e mund të vlejné për të përcaktuar një shtresë apo një mentalitet të tejkaluar të kohës; për shembull, ne jetuam me emërtesat administrative të qyteteve nga: *bashki* (para Luftës II Botërore), në *Komitet Ekzekutiv* (për më se 5 dekada të regjimit totalitar) dhe përsëri në *bashki*; por emërtesa *beledii,-a* i takon një

---

<sup>89</sup> Fialuer i Rii i Shcypes, Perbam Prei Shoqniiet t' Bashkimit, Shkoder, Kallnuer 1908, f. 27.

periudhe tepër të largët të administratës turke dhe vështirë të gjesh më përdorues të saj; kështu, edhe fjala mund të dalë në ligjërimin bisedor intelektual, kryesisht midis gjuhëtarësh e leksikologësh, por të përdoret edhe për humor e ironi. Në të njëjtën mënyrë edhe semat *bidat-i* (*ligj i ri, barrë*), *bigarihak* (*pa arsye, kot së koti*), *bihuude* (*per t'kote, me t'paa bef*),<sup>90 91</sup> etj., në një situatë të caktuar, mund të bashkëlidhen në ligjërim :

*Prapë me këto bidate ti?!*

*Pse më bie në qafë, bigarihak, unë jam në punën time?!*

*Është një bihude ai që s'i gjendet shoku!*

Ndodh që ndonjë term si *bohchallék-u* (*darí,a. i thohet kshtu dhantiis ci bjen nusja me vedi per me e fale dasmoreve e ghinniis t'dhännerrit. Dono della sposa*)<sup>92</sup>, jo vetëm vazhdon të përdoret, bie fjala, në familjet shkodrane, por edhe shënon një përkatësi besimi (muhamedan), në ndryshim me familjet e krishtera që për *darí* kanë termin *dhantí-a*<sup>93</sup> (një formim prejfoljor nga pjesorja *dhanë*).

Më gjerë, studiuesi Hajri Shehu<sup>94</sup> ka treguar se lidhjet *sintagmatike* që mund të hetohen në fjalorë të ndryshëm shpjegues apo dygjuhësh, gjenden në rrafshin leksikor të fjalive, jashtë

---

<sup>90</sup> Po aty, f. 43.

<sup>91</sup> Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f.102, shpjegon: *Bihude*, ndf.bosh, kot, pa dobi; *njeri bihude*- që shkon kot më kot, që s'di çka ban e ku të kapet.

<sup>92</sup> Fialuer i Rii i Shcypes, Perbam Prei Shoqniit t'Bashkimit, Shkoder, Kallnuer 1908, f. 47.

<sup>93</sup> Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954 ka këtë shpjegim: *dhanë-a*, dhuratë, dhanti, peshqesh, kurse për *dhanti-a*, shpjegon *dhunti*; f. 99. Kjo fjalë mungon në Fjalorin e vitit 1980.

<sup>94</sup> Hajri Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*, në *Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë, "Mësonjëtorja"*, Tiranë, 2005, f. 158 – 168.

kontekstit, në thëniet që kanë të bëjnë me fjalorin e tipit aktiv, ku del ç'është e mundshme ose e pamundshme, mbasi sintagmat në fjalor ilustronë sjelljen gramatikore të fjalës etj.. Autori thekson se *me bashkëlidhjet e fjalëve mund të merret një disiplinë e veçantë - kontekstologjia, që studion ndërvarësinë përmbajtje - strukturë në rrafshin e sistemit të gjuhës (por edhe në rrafshin e faktorëve socialë, historiko-kulturorë etj..)*<sup>95</sup>

Ka mjaft shembuj në Fjalorin e “Bashkimit”, si te germa **B**, ku një numër jo i vogël leksemash me burim vendas (sipas autorëve), kanë mundësi të bashkëlidhen në koherencë semantike me fjalë a grupe fjalësh, si: *bube-a*,<sup>96</sup>(*krym, “bube mnnashit” krym mnnashit. Por thohet mââ teper per kryma ci përftohen n'bark t'nierit. Vermi*), e cila gjendet edhe ne Fjalorin e vitit 1980. Në këtë çerdhe fjalësh mund të vazhdojmë me :

*Bubis, ite, ita, me bubitë, ft.vep. Spidocchiare (çmorrit)*, fjalë që mungon në Fjalorin e 1980-ës;

*Bublishte, a, vf. shum, bublishta, t. Mazzetto di fuschellini (tubëz me fije kashte)*;

është në fjalorët e gjuhës shqipe, 1954, 1980;

*Bublise,a. vf. shum.bublisa-t Scopatura (të fshirat)*, mungon në fjalorët e mësipërm.

*Bubrríá, vf. shum. bubrrina,t.Fjale ci difton ch'do sênne t'mledhuna bashke, por t'votsrra e t'imta. Minutaglia*, mungon në këtë kuptim në Fjalorin e vitit 1980, i cili shënon vetëm : *Tërësia e punëve të vogla, vogëlsirat, çikërrimat. Merret me bubërrí. (f.186).*

---

<sup>95</sup> Hajri Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*, në Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë, “Mësonjëtorja”, Tiranë, 2005, f.168.

<sup>96</sup> Kjo fjalë gjendet edhe në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980, me shënimin *zool. Vemje e rritur, para se të shndërrohet në flutur ose në krimb, zakonisht e mbuluar me push,krimbalesh, krimb mëndafshi.*

*Bubrrroj, on, ova, me bubrrue, ft.vep. Me punue pak a sënne t'vogla. Thohet edhe per Shtâse kuur s'kan kullose e shkojnë tue hanger n'sgrip.Savoracchiare, il pascolare degli anomali.*

*Bubrruem (i,e,t')persh. Edhe si mbiemër femëror. Më tej takojmë fjalën e bukur:*

*Bushurdisi, ise, isa, me bushurdise, ftvep. Me mushe bulshijt me uje per me sterpike duhan, petsa et.et. Riempire la bocca d'acqua per spruzzare tabacco, pani ecc.ecc.*

Të gjitha këto e të tjera fjalë të përdorimit të rrallë (të cilat sot gjenden vetëm nëpër fjalorë) mund të shërbejnë në stilin e letërsisë artistike për të dhënë tipa e karaktere letrare apo për të përcaktuar ngjyrimin e një kohe ose epoke të caktuar; pse jo edhe një mënyrësjelljeje gjuhësore. Janë të shpeshta aktivizimet e fjalësit të këtij rrafshi, për shembull, nga shkrimtari Martin Camaj, në disa poezi të të cilit gjejmë :

*Desha një vashë  
Në shpinë e vogël rrethue n'shimshir...*

*E rrezja të lodrojë me valë  
Për kënaqje të zemrës e të mendës sonë...*

*Poezia niset marrshëm, kinse tue u endë  
Shikon e dashunueme në vete  
Shembllesën e vet n'pasqyrën e brakave...*

*Tash që s'na shkandullon asgja hap derën  
E sendeve t'veta që s'gjinden n'tokë...*

*Motet e trishta lanë*  
*Në bebzat e syve të tynë vrraga...*<sup>97</sup>

Janë të gjitha fjalë shqipe, që gjenden në Fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi”, të aktivizuara poetikisht nga poeti këtu e gjysmë shekulli më parë, por që edhe sot tingëllojnë të tilla në raste përdorimi në vend të leksemave të standardit : *shimshir-i* (bush-i); *kënaqje-ja* (kënaqësi); *marrshëm* (nd.-veshur me një hije); *shembllësë-a* (shembëlltyrë); *brrakë-a*, (pellg, hurdhë); *shkandullon* (skandalizon); *motet* (vitet), *e trishta* (të trishtuara), *vrraga* (këtu: përshtypje, mbresa).

Nga ky Fjalor mund të nxjerrim edhe disa kategori leksiko-gramatikore që realizojnë tipa të ndryshëm të lidhjeve sintagmatike, koherente, si:

*Valenca e foljeve:*

Folje + emër (*idhnoj shokun, irnoj tokën, imtoj dheun, kremtoj festën* etj..)

Folje + folje ( *nisi me u krepatue, u largua duke u gnimendue, hyri pa u frigue* etj..)

Folje + ndajfolje (*fshâaj fort, ffillkoj bukur, giziloj lehtë, kalli menjëherë, eci kâadoras, marr kaliboch* etj..)

Emër + folje (*hudhër për të ngrënë, kall dram për të shtruar, karafil për t’u mbjellë, brexnii për t’u respektuar* etj.)

*Valenca e ndajfoljes:*

Ndajfolje + ndajfolje (*shumë bujarisht, tepër bukur, pak cortueshem*

---

<sup>97</sup> Martin Camaj, *Poezi 1953 – 1967*, “Biblioteka shqipe” (Albanische Bibliothek), Tipografia Detti, via Savonarola 1, Roma – 1981, f. 11, 69, 73, 96, 111.

etj..)

Folje + ndajfolje (*cortoj egërsisht, charkoj mirë* etj..)

Emër + ndajfolje (*chubardh fort, daii gjithkund* etj..)

Ndajfolje + mbiemër (*mjeft i damshëm* etj..)

*Valenca e mbiemrit:*

Mbiemër + emër (*i dâmtuem nga trupi, i derguem nga larg* etj..)

Emër + mbiemër (*lum i depertueshem, dordolets i vogël* etj..)

Me këto e të dhëna të tjera, parë në një vështrim të veçantë, mund të themi se Fjalori dygjuhësh i Shoqërisë “Bashkimi”, i vitit 1908, është hartuar mbi baza shkencore, në nivelin më të lartë të kohës, çka dëshmon se hartuesit e tij kanë pasur përgatitjen e duhur filologjike jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe më gjerë.

## **BIBLIOGRAFI:**

1. Fjaluer i Rii i Shcypes, Perbam Prei Shoqniit t’Bashkimit, Shkoder, Kallnuer, 1908.
2. Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë, *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 1954.
3. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë, 1980.
4. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, *Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë*, “Mësonjëtorja”, Tiranë, 2005.

5. Antonio Buseti, *Vocabolario Italiano-Albanese*, compilato dal P. Antonio Buseti, S.J., Scutari d'Albania, Tipografia dell'Immacolata, 1911.
6. Miço Samara, *Hulumtime në leksikografi*, Panteon, Tiranë, 2000.
7. Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2005.
8. Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
9. John Lyons, *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*, Dituria, Tiranë, 2001.
10. Ndre Mjeda, *Vepra letrare 1*, Tiranë, 1988.
11. Martin Camaj, *Poezi 1953–1967*, “Biblioteka shqipe” (Albanische Bibliothek), Tipografia Detti, via Savonarola 1, Roma – 1981.



**DISA PARIME TË ZBATUARA NË FJALORIN E  
“BASHKIMIT”,<sup>98</sup>**

Një ndër përpjekjet më të mëdha të Rilindësve tanë ishte qëmtimi i thesarit gojor, me qëllim normësimin e tij në fjalorë dhe gramatika. Kjo vepër e madhe e tyre buronte nga dashuria për fjalën shqipe, ashtin e dheut të tyre. Sepse ishte gjakuar ndër shekuj që kjo fjalë e truallit amë të shprehte shpirtin e popullit, ashtin e palcën e identitetit të tij.

Në vijim të Fjalorit Latinisht-Shqip të Bardhit (1635), të punës së palodhur leksikografike të De Radës, Mitkos, Dines, Kamardës, Sami Frashërit, Vaso Pashës e Kristoforidhit, një vend të posaçëm zë edhe Shoqëria “*Bashkimi*” e Shkodrës. Që me themelimin e saj më 1899, kjo shoqëri ishte ndër të parat që filloi të botojë në gjuhën shqipe me alfabetin latin. Botimet nuk ishin vetëm me karakter fetar, por edhe laik, kryesisht shkollor, në kushtet e një pushtimi otoman, që ua ndalonte shqiptarëve arsimin në gjuhën amtare. Në këtë shoqëri ishin figura të shquara, si: Prenkë Doçi, Luigj Gurakuqi, Dodë Koleci, Ndoc Nikaj, etj. Për një periudhë të shkurtër nëntëvjeçare, përveç “Fialuer i Rii i shcypes” në fjalë (1908) dhe librave me karakter fetar, u botuan mjaft tituj me karakter shkollor, didaktik e letrar si: “Gramatikën ja folmarmjen

---

<sup>98</sup> Shezai Rrokaj, në përmbledhjen e autorit “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007.

shcyptare” të Dodë Kolecit (1901), “Oroe përmbi Abatar Shcyp”, “Vargnimi” i Luigj Gurakuqit, por edhe manuale të thjeshta si: “Këndonjtore”, “Dheshkronjë” “Numërtore”, “Kalendarë shcypтари”, “Historia e Shcypniis”, etj.

***Fjalori i ri gjuhës shqipe del nën emrin e kësaj Shoqërie, po, sipas të gjitha gjasave, ai duhet të jetë vepër e Dodë Kolecit, ku ndihet dukshëm ndikimi i fjalorit të Kristoforidhit. Për nga koha dhe vlerat e këtij fjalori, studiuesi Jup Kastrati do ta vlerësonte si më të rëndësishmin deri në botimin e fjalorit nga Instituti i Shkencave (1954).***

Fjalori i “*Bashkimit*”, sikundër zuri të quhej, mbështetet në alfabetin latin dhe, si i tillë, ishte një dokument i rëndësishëm në prag të Kongresit të Manastirit (1908).

Për kohën kur u botua, ai përmbledh një pasuri të madhe leksikore. Pjesa integrale dhe Shtojca, të dyja së bashku, kanë rreth katërmbëdhjetë mijë fjalë (13.798). Megjithatë, po të kqyret më afër, ky numër është edhe më i vogël, nëse kihet parasysh se mjaft fjalë janë variante të njëra-tjetrës, si: katunnii/ katunnuarii; gugsoi/gogsoi; gugsine; kecem/kecohem; kafeane/kafehane; nrrichim/nrritechim; rrufee/rrfee; shati/fshati; vonoi/vanpi; veshtirë/vshtirë; urtii/urtësi; labot/llobot; ladi/lavdi, lagoi/largoi; leroi/livori; liftoi/luftoi; manitem/mahnitem’ mieft/miaft, etj.

Në këtë fjalor nuk jepet numri i rrethinës së saktë nga janë marrë fjalët, por më 9 janar 1908, në parathënie theksohet se burimet kryesore kanë qenë gurra popullore, letërsia e shkruar dhe tradita leksikografike e traditës dhe e huaj: “*Po e cekim n’drate ket fialuer m’t’tsilin kemi mbledhe mâa t’shumen, saa ku kemi muite, t’atyne fiale sikurse fliten nneper ghytete, fusha e male t’dashtunes atmes s’one. Mas ktyne, kemi pase kuides me shtii mrenne edhe ato ci ghinnet t’shtyuna n’libra, n’fialore e n’shkrime t’shnnrichemve*

*dietarve t'one e t'hueive ci ac me xelle iâne munnue me i dhâne shkelzim e hieshii gjuhes s'one, sikurse Dom Pieter Budi, Frang Bardhi, Pietre Bogdani, Gustav Meyer-i, ate Iake Iungg-u, Kostandin Kristoforidhi e disaa tiere t'ashem edhe mâa”.*

Përveç këtyre burimeve, nga vëzhgimi i afërt në përjasje me italishten, vihen re disa raste edhe fjalë që janë gjetje në gjuhën shqipe të fjalëve përkuese të kalkuluara nga italishtja.

Ka 34 shkronja; kuptohet mungon ë-ja dhe q-ja. Krahasimisht me alfabetin e sotëm standard, shkronjat e përdorura për shprehjen e tingujve kanë dallime të tilla, si: **ch** për **sh**, **c** për **sh**, **x** për **xh**, **xh** për **zh**, **z** për **x**, **ts** për **c**, **ç** për **sh**, **c** për **q**, **i** për **j**, **gh** për **gj**, **gn** për **nj**, **x** për **z**.

Grumbulli i fjalësit, shkrimi e shqiptimi mbështetet në të folmen e Shkodrës e në rrethinat e saj. Kësisoj, për nga pasuria dhe larmia e fjalësit, tiparet e tij të veçanta, fjalori merr vlerë shumë të vyer dialektologjike. Kjo vlerë është e madhe, sepse ai shpreh tërë mozaikun e kësaj treve, të pasuruar me prurje nga letërsia e kohës, ajo e vjetër (kryesisht Buzuku, Budi, Bogdani duke vënë në dukje fjalët e marra prej tyre). Rëndësia e tij bëhet edhe më e madhe për krahasime me standardin e sotëm, por edhe për studime të dialektologjisë historike.

Një tipar tjetër është se i ndan fjalët me burim nga gjuhët e tjera në dallim nga fjalët me burim autokton ose që ka herë e kanë fituar të drejtën e qytetarisë në shqipe, duke përdorur përbri tregues të tillë, si: **I** për fjalët me burim gjuhën italiane, **S** për fjalët me burim gjuhët sllave dhe **T** për fjalët me burim gjuhën turke. Kësisoj ky fjalor është një referim i rëndësishëm për studime krahasimtare të raportit të shqipes me gjuhët, me të cilat shqipja ka qenë historikisht në kontakt.

Për çdo fjalë jepen të dhëna gramatikore, si: treguesi i klasës, gjinia dhe numri, si dhe shpjegime të karakterit drejtshkrimor e drejtshqiptimor lidhur me gjatësinë a shkurtësinë e zanoreve, hundoret, disa bashkëtingëllore tipike, etj. Në fund të çdo fjale jepet edhe gjegjësjë në italishte.

Fjalori është njëherazi shpjegues, pasi aty jepen shpjegimet e fjalëve, sinonimet e mundshme, por edhe dygjuhësh (shqip-italisht), duke dhënë një ndihmesë të madhe për kohën në fushën përkthimore.

Në fushën e leksikografisë shqiptare, së bashku me fjalorin e Kristoforidhit, ai përfaqëson padyshim një vijëmësi të punës leksikografike të paraardhësve të tyre, por dhe një visar të rëndësishëm për fjalorët e mëpastajmë, të cilët do të rritnin murin e kështjellës, ku do të zinte shtat thesari i shqipes.

Më një pikëpyetje jepen fjalë me burim nga gjuhë të tjera, kurse me tri pikëpyetje janë fjalët, kuptimi i të cilave nuk jepet, me mendimin se vënia e tyre në fjalor do t'u krijonte mundësinë leksikografëve të ardhshëm t'i shpjegojnë gjatë ribotimeve të tij.

Mjaft fjalë jepen nga letërsia e vjetër e kohës, nga tradita gojore krahinore shkodrane e nga rrethinat, të cilat mund të zënë shtrat e të përdoren më së miri sot e gjithë ditën në standard, në vend të lumit të fjalëve të huaja të kota, që nuk kanë të ndalur e herëpashere po e mbyt fjalën e bukur shqipe. Ne kemi qëmtuar vetëm disa prej tyre, të cilat nuk i kemi gjetur në fjalorët tanë standardë, në cilësinë e fjalëve të para a të varianteve, qoftë edhe duke respektuar rregullat e drejtshkrimit të standardit të sotëm, si: *animirë*, *ape* (vëlla i madh), *argoj* (përkëdhel, gjendet edhe tek Budi), *i arguar*, *asses*, *atbotë*, *barat* (privilgj, gjendet tek Buzuku), *bareshtoj* (niveloj), *barith* (bari i vogël), *besatoj* (bëj paqe), *binohem* (nderohem, gjendet edhe tek Bogdani), *brinosh* (kur të tradhton

gruaja), *bukurisht* (krahas *bukur*), *bukurim* (krahas *zbukurim*), *djelmosh*, *dëftoj*, *ndjellakeqi/ndjellakeqja*, *dëshirak/e*, (për llupës), *dobis* (për fitoj, pushtoj), *dhelka* (krahas *dhele*), *eroj* (për parfumoj), *fatbardhësoj*, *i fatuar* (për me fat), *gabimtar* (nga gabim), *gabueshëm* (si ndajfolje), *gjobëtar* (ai që vë gjobë), *gjuhëvështirë* (për fëmijën që ka vonesë në të folur), *gomlush* (kokë e këmbë bashkë), *gumshoj* (bëj shaka, gjendet edhe tek Bogdani), *gjerdhac* (fëmijë i përhedhur), *i gjumshëm*, *hovem* (veproj me hov), *mërdhij* (me kuptim vdes), *meritim* (nga meritoj), *i kapur* (për i pasur), *jetësim* (krahas gjallërim), *ndërtym* (varur), *përrshllij* (krahas kripas), *i përziarshëm* (krahas i zjarrtë), *rrafshtinë* (vend i rrafshhtë), *tallaçit* (krahas llokoçit), etj.

Një pjesë e mirë e këtyre fjalëve mund të zënë vend në fjalorët e sotëm normativë në formën e fjalëve hyrëse a të varinateve, pasi shprehin realitete aktuale, me qëllim që të vihen në qarkullim. Pjesa tjetër e tyre duhet të grumbullohet e të shërbejë për fjalorë thesaurus, si dhe për fjalorë historikë.

Në përfundim mund të themi se Fjalori i Shoqërisë “*Bashkimi*” shënon, padyshim, një arritje të gjuhësisë sonë të fillimit të shekullit të kaluar. Ai është fryt i punës këmbëngulëse e të palodhur, i pasionit dhe i dashurisë për gjuhën shqipe, për traditat dhe kulturën e këtij populli. Rëndësia e tij nuk qëndron thjesht për shërbimin që u bëri përdoruesve të kohës, për nevojat historike e shoqërore që kishin populli ynë asokohe. Rëndësia e tij qëndron edhe në faktin se ai përbën një monument të shkruar në lëmin e leksikografisë shqiptare, se shërben për studime në fushën e dialektologjisë historike e sinkronike, njëkohësisht edhe si material i grumbulluar për pasurimin e standardit me fjalës që sot e gjithë ditën është aktual.

Miço SAMARA

## RRETH VLERAVE LEKSIKOGRAFIKE TË FJALORIT TË SHOQËRISË “*BASHKIMI*” (1908)<sup>99</sup>

Fjalori i Shoqërisë “*Bashkimi*”, i botuar në vitin 1908, me titull “Fjaluer i Ri i Scqypes”, ka një rëndësi të veçantë në historinë e leksikografisë shqiptare.

Në “Parafjalën” e ribotimit të tij në Prishtinë (në vitin 1978) thuhet se ky Fjalor “*simbas të gjitha gjasave duhet të jetë vepër e Dodë Kolecit*”<sup>1</sup>. Ndërsa studiuesi Pal Doçi në një monografi për “Imzot Prend Doçin - Abati i Mirditës” (botuar në vitin 1997) shkruan se ky Fjalor ka nisur të hartohet (në vitin 1899) “*sipas kërkesës së Doçit*” dhe nën drejtimin e tij, i cili “*i kishte caktuar çdo anëtar të mbledhë fjalë e t’i hartojë ato sipas shkronjave*”.<sup>2</sup> Nuk mund të dyshohet se njëri prej anëtarëve të këtij grupi hartues, dhe pikërisht më kryesori, ka qenë Dodë Koleci. Por, kuptohet vetiu, se pa interesimin dhe organizimin e punës nga Prend Doçi, kryetari i shoqërisë “*Bashkimi*”, nuk do të ishte bërë i mundur as hartimi, as botimi i tij (pas tetë vjetësh), i cili bëri jehonë të madhe në qarqet intelektuale patriotike shqiptare të asaj kohe, duke u cilësuar si një ngjarje e rëndësishme e gjuhësisë shqiptare, pas botimit të Fjalorit të F. Bardhit (1635) dhe atij të K. Kristoforidhit (1904). Qysh në atë

---

<sup>99</sup> Miço Samara, *Shqyrtime albanologjike*, Shkup, 2000.

<sup>1</sup> Shih këtë “Parafjalë” në Fjalor i “*Bashkimit*”, Prishtinë, 1987, f. VI.

<sup>2</sup> Shih, P. Doçi, *Imzot Prend Doçi – Abati i Mirditës*, 1997.

kohë A. Xhuvani e ka vlerësuar atë si fjalorin më të mirë të botuar deri atëherë, i cili “*tue përmirësue mun e tue u shtue mun ai mund të zezë vendin e një fjalori akademik të gjuhës sonë*”.<sup>3</sup> Me të drejtë ribotuesit e tij në Prishtinë shkruajnë në Parathënie se ai “*është një ndër veprat kapitale të leksikografisë sonë ... dhe ndër më të mirat deri në botimin e Fjalorit të vitit 1954*”.<sup>4</sup>

Për rëndësinë e kësaj ngjarjeje të shënuar në historinë e leksikografisë shqiptare dhe për vlerat kryesore shkencore të këtij Fjalori dëshirojmë të theksojmë:

*Së pari*, ai u hartua dhe u botua në rrethana të veçanta historike – kulturore, në fund të shek. XIX e në fillim të shek. XX, kur kërkoheshin e bëheshin përpjekje të mëdha që të vihej në jetë programi i rilindësve për hapjen e shkollave në gjuhën amtare dhe përgatitjen e teksteve për to. Shoqëria “*Bashkimi*” për bashkimin e dialekteve dhe njehsimin e shqipes në një gjuhë të vetme të përbashkët, ishte vijim i drejtpërdrejtë i punës së ndjekur nga “Shoqëria e Shkronjézave” të Stambollit (1897), ku zhvillonin veprimtarinë e tyre Rilindësit tanë më të shquar.

*Së dyti*, megjithëse Fjalori i shoqërisë “*Bashkimi*” ka pamjen e një fjalori dygjuhësh (shqip – italisht), ka disa arsye që ai mund të quhet Fjalori i shqipes, sepse ai u nis të hartohet si i tillë dhe në mjaft raste aty pasqyrohet vetëm fjala shqipe, pa përgjegjësen në italisht. Ai pasqyron një thesar të madh shprehjesh dhe “*fjalësh shcype prej ghith anësh*”<sup>5</sup> - mbledhura - siç shkruante gazeta “Albania” e F. Konicës - jo vetëm “*prej njëres a tjetres të folme*”<sup>6</sup> -

<sup>3</sup> Aleksandër Xhuvani, *Fjalori i “Bashkimit”*, në “Shkreptima”, 1911, nr. 15.

<sup>4</sup> *Fjalori i “Bashkimit”* P.1978, f.IV dhe Sh.Islamaj. U ribotua *Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi”* në “Gjurmime albanologjike”, Shkencat Filologjike, IX. 1979, P.1980.

<sup>5</sup> Shih “Parathënie”, në *Fjalori i “Bashkimit”*, P. 1978, f. 9.

<sup>6</sup> Shih “Albania”, 1902, nr.3, f.59.

por prej të gjithë të folmeve, duke u bazuar në parimin e drejtë shkencor - të zbatuar edhe nga K. Kristoforidhi, sipas të cilit leksiku i shqipes është pasuri e përbashkët kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektikor; prandaj, duke bërë një përjasje të këtij Fjalori me atë të Kristoforidhit (botuar në vitin 1904), na del se është e vërtetë ajo çka është thënë se në këtë Fjalor “*ka gjurmë të ndikimit nga Fjalori i Kristoforidhit*”,<sup>7</sup> si për nga parimet ashtu edhe për nga struktura e tij. Korpusi i këtij Fjalori, së bashku me “Shtojcën” përfshin rreth 14,000 njësi leksikore, mjaft prej të cilave janë sinonime dhe formime të bukura (me parashtesa e prapashtesa shqipe, kompozita etj.). Ashtu si në Fjalorin e Kristoforidhit, raporti i fjalëve autoktone ndaj fjalëve të huaja është dukshëm më i madh në të mirë të shqipës, se sa në fjalorët e mëparshëm botuar deri atëherë.

*Së treti*, krahas vlerave në fushën e leksikut, ky Fjalor ka edhe vlera historike, në fushën e gramatikës, sidomos në fushën e drejtshkrimit, meqë aty pasqyrohen edhe përpjekjet për njehsimin e drejtshkrimit, në përputhje me detyrën që kishte caktuar Shoqëria “*Bashkimi*” për hartimin e rregullave drejtshkrimore dhe të një gramatike, e cila duket se kishte përfunduar para botimit të Fjalorit. Kështu, megjithëse ky fjalor ka si bazë drejtshkrimin e dialektit të Veriut, gjejmë në të edhe fjalë, ku ruhet i paasimiluar, si në dialektin e Jugut, togu bashkëtingëllor *mb* (p.sh., *mbruj* “gatuj”) ose fjalë ku ruhet zanorja *ë* e patheksuar, në pozicionin para e pas theksit (si p.sh.. *i ngushtë, ballëhapët, prapësi* etj.). Një traditë të tillë e gjejmë të pasqyruar më vonë edhe në Vendimet e Komisionit Letrar të Shkodrës (1916-1917); e cila synonte të afronte sa më shumë

---

<sup>7</sup> Pal Doçi, *Imzot Prend Doçi*, vepër e cituar, f. 103.



drejtshkrimin e greqishtes me atë të toskërishtes së atëhershme.

Ky vështrim shumë i përmbledhur për vlerat leksikografike të Fjalorit të “*Bashkimit*” dha ndihmesën (kontributin) e kësaj Shoqërie në fushën e gjuhësisë shqiptare është jo thjesht vetëm një homazh përkujtimor, por edhe një detyrë për të thelluar në të ardhmen studimet për vlerat historiko-kulturore të Shoqërisë “*Bashkimi*” në fushën e alfabetit, të filologjisë (në përgjithësi) dhe të gjuhës letrare në veçanti, të arsimit kombëtar etj.

## Shefkije ISLAMAJ

### U RIBOTUA FJALORI I SHOQËRISË “*BASHKIMI*”<sup>100</sup>

Leksikografia shqipe ka një jetë të gjatë. Fillet e saj i gjejmë rreth tre shekuj e gjysmë më parë (1635, tek fjalori Latinisht-Shqip i Frang Bardhit). Por zhvillimi më i hovshëm i saj është bërë krahas me zhvillimin e përparimin kulturor të shqiptarëve në kohën e Rilindjes Kombëtare. Periudha e Rilindjes Kombëtare është padyshim periudha kur u vunë bazat e gjuhës sonë letrare, është koha kur gjuha shqipe u përpunua me zell të madh, më shumë se kurrë, nga ana e popullit shqiptar, duke e bërë atë armë të fuqishme në luftë për çlirimin kombëtar. Rilindësit ditën të marrin ç’ishte më e vlefshme nga letërsia jonë e kaluar dhe nga gjuha e gjallë e popullit. Kjo gjë bëri që gjuha shqipe të përpunohet mirë dhe të zhvillohet gjerë në një nivel të lakmueshëm e cilësor, që i hapi shteg pastaj zhvillimit të gjuhës së sotme letrare. Kjo gjë vërehet si në leksik, ashtu edhe në strukturën gramatikore. Leksikografia, si degë e gjuhësisë, në kohën e Rilindjes dhe më pas, pati një zhvillim të dukshëm. Deri në çlirim u botuan një numër i madh fjalorësh (afro shtatëdhjetë sish). Kjo, padyshim është një trashëgimi e pasur dhe me vlera të mëdha, e që më vonë u bë një bazë e mirë për hartimin e fjalorëve të mëvonshëm. Në këta fjalorë u përfshi një pasuri e madhe leksikore e frazeologjike e mbledhur drejtpërdrejt nga goja e popullit, duke i shpëtuar zhdukjes. Në këtë mënyrë ata kanë shërbyer

---

<sup>100</sup> Shefkije Islamaj, *Gjurmime albanologjike*, IX, 1979, Prishtinë, 1980.

si burim e pikëmbështetje për të gjithë fjalorët e hartuar më pas. Veç kësaj, ata i kanë plotësuar secili në kohën e vet nevojat e veprimtarive të ndryshme shoqërore. Këta fjalorë dhanë material të vlefshëm edhe për studimet rreth shqipes, si dhe për studimet krahasuese të shqipes me gjuhë të tjera. Në përgjithësi, hartimi i fjalorëve para çlirimit nuk udhëhiqej nga qëllimi i pasqyrimin objektiv të pasurisë leksikore–frazologjike të shqipes, sepse mungonte një bazë e shëndoshë shkencore, por më shumë nga nevoja e studimeve të ngushta të praktikës e të tjera.

Drejtimet e leksikografisë shqipe para çlirimit, si në çdo periudhë e në çdo gjuhë tjetër përcaktoheshin nga rrethanat historiko-shoqërore në përgjithësi. Kushtet shoqëro-ekonomike, pushteti i atëhershëm, ideologjia e klasës sunduese, kërkesat politike të kohës, domosdo ndikojnë jo vetëm në bazën metodologjike, por edhe në tipat e fjalorëve që botoheshin, si dhe lëndën që përfshijnë ata. Në rrethana e kushte të tilla, që dihen para çlirimit, u hartuan kryesisht fjalorë dygjuhësh, fjalorë dialektorë dhe fjalorë etimologjikë. Vendin kryesor e zë leksikografia dygjuhëshe. Shumica e fjalorëve qenë italisht-shqip dhe shqip-italisht. Ndër më të njohurit janë fjalorët e Bardhit, Buzzetit, Kordinjanos, Leotit, Lukajt, Tases, Gazullit, Majerit, Dizdarit, Kujunxhiqit. Në mesin e këtyre dallohen, Fjalori i Kristoforidhit (1904) dhe ai i shoqërisë “*Bashkimi*”, që shënojnë një etapë të rëndësishme të leksikografisë shqiptare.

Fjalori i shoqërisë “*Bashkimi*” doli pikërisht më 1908 në Shkodër, këtu e shtatëdhjetë vjet më parë, e u ribotua tani tek ne, mu në jubileun e Kongresit të Manastirit.

Shoqëria “*Bashkimi*” e formuar në Shkodër më 1899, prej Imzot Prenk Doçit, luajti një rol të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare shqiptare. Ndërpjesëtarë të saj qenë Emzot Jak Serreqi,

Luigj Gurakuqi, D. Dodë Koleci, D. Ndoc Nikaj, At Gjergj Fishta e të tjerë. Kjo shoqëri kishte për qëllim lëvrimin e gjuhës shqipe. E para punë e shoqërisë, që caktimi i një alfabeti me të cilin do t'i botonin librat e vet. Ky alfabet që mori për bazë shkronjat latine duke zëvendësuar edhe shkronjat e veçanta të përdorura prej të vjetërve me grupe gërmash, iu kundërvu alfabetit të Stambollit, atij të Agimit dhe ca të tjerëve, që fjala vendimtare pastaj të merret në Kongresin e Manastirit (1908). Me këtë alfabet u shtypën më se 30 e sa botime e ndër to vepra didaktike, letrare, shkollore e fetare si “Oroe përmbi Abetar shcyp”, “Vargnimi” i Luigj Gurakuqit, “këndonjtore”, “Dheshkronjë”, “Numërtore”, “Kalendarë Shcypitari”, “Histori e Shqypniis” e të tjera. Gjithashtu me këtë alfabet u shtypën edhe shumë fletore të përkohshme jashtë atdheut si “Albania” e Faik Konicës, “La nacione albaneze” në pjesën shqipe e tjera. Po me këtë alfabet doli në dritë edhe “Fjaluer i Rii i Shcypes”, hartuar nga kolektivi i shoqërisë “*Bashkimi*” nën udhëheqjen e D. Dodë Kolecit, që njëkohësisht është autor edhe i “Gramatika ja folmarmja shcyptare”(1901). Ky fjalor së bashku me atë të Kristoforidhit janë veprat më të rëndësishme të leksikografisë shqiptare deri në botimin e Fjalorit shpjegues të Institutit të Shkencave (1954). Fjalori i “*Bashkimit*” siç u quajt më vonë, është një fjalor dygjuhësh, shqip-italisht. Është i shkruar me alfabet me bazë latine. Për kohën, kur u botua ka një pasuri mjaft të madhe fjalësh e frazeologjish. Ky fjalor nuk pasqyron tërë leksikon e shqipes, por është bazuar kryesisht në të folmen gegërishte, veçmas në atë të shkodranishtes e së këndejmi del se ka më shumë rëndësi e karakter dialektor.

Me ribotimin e këtij fjalori është bërë një punë mjaft e vyer, në mënyrë që edhe lexuesi ynë të ketë mundësi të njihet me këtë veper të rëndësishme gjuhësore të leksikografisë.

Është punë e vështirë të jepet një vlerësim i drejtë rreth një fjalori që është botuar para shumë vitesh, sepse gjuha shqipe gjatë kësaj periudhe ka pësuar ndryshime, ka bërë një zhvillim të shpejtë e bashkë me të edhe leksikografia shqiptare ka ecur përpara.

Fjalori i “*Bashkimit*” është një hap përpara në krahasim me fjalorët e tjerë dygjuhësh të shqipes, të hartuar më parë edhe për disa të mëvonshëm. Është ndër fjalorët më të mëdhenj që kanë dalë gjatë asaj kohe. Së bashku me “Shtoitsen” përmban afro katërmëdhjetëmijë fjalë (13614). Fjalori është mjaft i vëllimshëm (538 faqe). Nuk kemi shënime, nga është marrë njëra apo tjetra fjalë. Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi mbështeten kryesisht në të folmen e Shkodrës. Autorët në përpilimin e fjalorit kanë pasur për qëllim t’u sjellin dobi studiuesve fillestarë, por edhe atyre që dëshirojnë të plotësojnë njohjen e gjuhës.

Pas parathënies jepen disa udhëzime që janë shfrytëzuar në përpilimin e Fjalorit. Autorët në rend të parë, janë mbështetur në fjalorin e veprave të Bogdanit, Budit, Bardhit e njëkohësisht në Fjalorin e Kristoforidhit, që në Fjalor i ndeshim me shkurtesat (Bog), (Bu.), (B.)(Kri.). Alfabeti i përdorur në këtë Fjalor, siç e cekët edhe më parë, është ai i shoqërisë “*Bashkimi*” që kishte germa latine të formuara me digramë. Prej këtij, alfabeti i manastirit pat marrë mjaft shkronja. Për disa shkronja ky alfabet kishte grupe tingujsh të formuara mes shkronjën h: dhe (dh),th(th), sh(sh),xh(zh)zh (xh),ch(ç)gh(gj). Të tjerat u morën prej alfabetit të hershëm shkodran, ose iu dha vlerë e posaçme shenjave latine gn-nj, n’n-nd, l-l,ll-ll,ts-c, c-q etj.

Gjatësia e zanoreve shënohet me dyshimin e zanoreve si ma a rikaa, nmi, doraas, marsi i gozhdaar, i ri i etj. Shkronja j nuk është marrë në kujdes por u mbarua punë me i. shembull *biit*(bijt), *bliit*(blijt), *shiiim* (shijim). Shkronja “i” gjithashtu brenda në a në

mbarim të saj po të ketë para ose prapa ndonjë zanore bëhet “j” p.sh. *ffjale*, por edhe fjala *laai* edhe *laaj*. Përdoren pra të dy rastet. Për ë-n tonë u rregullua shkrimi deri diku sipas frëngjishtes: kështu zanores e iu vu theksi i prehtë (e) kur ishte e zëshme: e-ja e thjeshtë shqiptohet e zëshme ndër fjalë monosilabike e ndër ato që fillojnë me e, përndryshe njihej e pazëshme, sikur në rastet: atëherë, përherë, punë, burrë etj.

Sidoqoftë ky alfabet ishte mjaft praktik për të shtypur libra andaj pati mjaft përkrahës.

Sa i përket çështjes së theksit, siç theksojnë autorët edhe në fillim të Fjalorit, kanë në përdorim tre lloj theksesh: thekse rannia(‘) që zakonisht vihet në fjalët e këtij tipi:

*edhe gniky gnita gn’ashtu*, “thekse hiedhsa (‘), që në të shumtën e rasteve u vihet zanoreve e i dhe “theksi hunxa ... që përdoret për zanoret që shqiptohen me hundë, pra që kanë nuancë hundore, si: *bani, za, nanne, nannuer, rrjane* etj.

Sa i përket karakteristikave fonetike do të ndalemi pak në ato që na duken më të rëndësishme. Në Fjalorin, ashtu si edhe në të folmen e shkodranishtes në vend të grupeve të vjetra kl, gl, gjejmë ki e gi, të cilat siç e dimë kanë ardhur nga patalizimi i l-së *kiaai* (kiaava) *kiumsht, giunikiamm, zgiedh* etj.

Asimilimi si dukuri fonetike në grupe nd>n, mb>m, ng>n, nuk është bërë në masë të dukshme te grupet nd, ng (neer, neerim, nnhme, nnokush, nnodhi, nnalo, hunne, ngas, ngel, ngordh, ngop), derisa te grupi mb është bërë në masë të madhe (math, mys, myta, myllun, mytun, miell (mbielle)) etj.

Fjalët turke oksitone, në Fjalor, janë të kthyera në fjalë paroksite, *qòshe, bàb*. Në rrokje të theksuar para bashkëtingëlloreve hundore është ruajtur *â* me variantet e saj të ndryshme: *nâna, lâmi, shkâm* etj. Fjalët që kanë *ê* të theksuar para

një bashkëtingëlloreje hundore kanë *ê* të zëshme: *dhên, frê, mênja, pê* etj. Karakteristikë është gjithashtu përdorimi minimum i “e” si veçori e së folmes së Shkodrës: *ân* (anë). *tūf* (tufë bābs (babës), *thrras* (thërras) etj.

Siç dihet gegërishtja në vendosjen e theksit ka qenë më aktive se toskërishtja, andaj edhe shembujt e nxjerrë nga Fjalori e dëshmojnë këtë *ftúe, thúe, dúe, gxúe, dúer*. Gjithashtu edhe diftongu ie na del i ruajtur mirë: *sielle, vaele, vielun, diell, diellor, piell*.

Emrat që në njëjës mbarojnë me temë në zanore shumësin e bëjnë me j: *húj, barij*, etj., ndërsa shumë emra që mbarojnë me bashkëtingëllore marrin *a*: *drapna, gishta, prifta*; kanë *a* në mbarim edhe shumë emra që në letrarishte kanë *ë* si, *qylasha, dervisha, shegërta* etj.

Për rrjedhoren në Fjalor gjendet edhe trajta *préie s mrâmiét, préie miésnâtét, préie dhéut, préie fushét* etj.

Në këtë Fjalor jepen të gjitha pjesët e ligjëratës: emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet, ndajfoljet, pjesëzat, lidhëzat, etj.

Zakonisht pjesët e ndryshme të ligjëratës jepen në trajtën e tyre përfaqësuese: emrat – në emëroren e pashquar të njëjësit ose të shumësit (kur përdoret vetëm në shumës), mbiemrat, numërorët e përemrat në trajtën e gjinisë mashkullore të njëjësit ose me të dyja gjinitë); foljet në vetën e parë e të tretë njëjës të së tashmes së dëftores, në trajtën e së kryerës së thjeshtë dhe në trajtën e pjesores. Gjithashtu ekzistojnë edhe trajtat foljore të paskajores: *me lye, me çue, me fshi* etj. Të shumtë janë edhe mbiemrat foljorë të tipit: *i viefshëm, i shkueshëm, i prékshëm* etj.

Edhe ndajfoljet janë të pasqyruara mirë në Fjalor. Autorët kanë treguar kujdes për to dhe i kanë pasqyruar me një larmi të madhe. Shumica e tyre janë mbiemra ose participa të adjektivuar pa

nyje: *i mshëfun, micsisht, vllaxnisht, tinxe, hére hére* etj.

Si duket gjuha e popullit ka dashur përherë variacion. Janë shfrytëzuar gjerësisht mjetet fjalëformuese të shqipes. Kështu janë krijuar mbiemrat nga emrat sipas modelit *i hekurt* (ferreo), *i leshtë* (Di lana), *i flaket* (ardente), *i xiarte* (igneo).

Një gjë që bie në sy është se për pjesët e ligjëratës, autorët na japin fjalë emërtuese krejtësisht të tjera që i hasim shumë rrallë edhe në shkrimet e asaj kohe, për shembull për emër mashkullor – *vetëpasuer mashkulluer* (sonstantivo maschile), e kështu me radhë; *për mbi emër – përshtueshëm* (aggettivo), *për ndajfolje – parftillk* (avverbio); *përemër – perémen* (pronome) dmth sikur *sot*; shumuer e vechuer për shumës e njëjës; *ftillk* – për folje e të tjera.

Rendi i fjalëve në fjalor është alfabetik. Përgjithësisht ky rend mbahet edhe në çerdhe fjalësh. Për shembull: *mkat, mkatnoi, mkatnuem (t'), mkatnuer* etj. Në krahasim me Fjalorin e Kristoforidhit, këtu kemi një pasuri më të madhe fjalësh të prejardhura p.sh., të “Bashkimi”- *afër, afërm (i, e, t') afro, afrue, afruem, afruemit (t') afrueshëm (i, e)*, ndërsa të Kristoforidhi – *afër, i afërm, afëronem, afëronj, i afërt*. Këtu na del edhe një çështje për shqyrtim – *afër* na del si trajtë e plotë edhe të fjalët e tjera në çerdhen e kësaj fjale tek Kristoforidhi, që nuk ndodh tek “Bashkimi”, por është trajta si e letrarishtes, ngase Kristoforidhi e ka respektuar parimin etimologjik – historik, kurse Fjalori i “Bashkimit” iu ka përmbajtur parimit fonetik (*afrim – afër – te Bashkimi dhe afërim – afër – te Kristoforidhi*). Edhe shkronja *nj* të Kristoforidhi (*afëronj*) ruhet si arkaike, që nuk gjendet të “Bashkimi”.

Sa i përket çështjes së çerdhes së fjalëve, si Fjalori i “Bashkimit” ashtu edhe ai i Kristoforidhit na dalin mjaft të pasur, edhe pse kjo çështje është mjaft e ndërlikuar. Mjafton t’u hedhim një



sy shembujve: *âmel, âmelt, âmelsii a âmeltii, âmeltim, âmeltoj, âmeltue, âmeltuemit (t'), âmeltueshëm (i, e), âmeltsiim, âmeltsine, etj. ose ânkesë ankim, ankoj, ânkuë, nkuemit (t') ânkueshem (i, e), ânkueshim etj.*, tek Fjalori i “Bashkimit” apo te Fjalori i Kristoforidhit – *ambël (të), ambëla (të) ambëlcinë, ambëlcohem, ambëlcoj, ambëlë (të) ambëlë (ndajf.), ambëlsinë, ambëlsohem, ambëlsoj, ambëltoj, amëltonem,(t') amblëth, amblëth ose anëkim,anëkohem, anëkonj, anëkues, anëkueshim etj.*

Fjalori ka një pasuri mjaft të madhe leksikore. Leksiku është i zgjedhur mjaft. Në fjalor ndeshim edhe një sasi fjalësh që janë zhdukur për një kohë të gjatë dhe kanë hyrë përsëri në përdorim si të ishin neologjizma: *i grishun (invitato, chiamato), kshilltaar (conssigliere), kopstetaar (ortolano) etj.*

Dihet se në një fjalor dygjuhësh, një ndër problemet më të rëndësishme dhe më të vështira është dhënia në mënyrë të saktë të kuptimeve të ndryshme që kanë fjalët. Me gjithë kujdesin që është bërë në këtë drejtim kanë mbetur mjaft zbrastësi të ndjeshme, sikurse edhe në shumë fjalorë të kësaj kohe. Zakonisht në fjalorë të këtij tipi, kuptimet ndahen me shifra arabe 1, 2... germa a. b.... ose përdoren shenja të pikësimit. Në këtë fjalor, kuptimet ndahen me pikëpresje(;) kurse sinonimet me presje (.). Megjithatë, ndarja e kuptimeve të fjalës nuk është bërë me saktësi p.sh., për shpjegimin e fjalës shqipe “mikloi” jepen ekuivalentet italishte – *illudere, vezzeggiare, adulare*, pa dalluar këtu kuptimet e ndryshme të këtyre fjalëve, dhe anasjelltas, e ndodh që të zgjerohet koncepti mbi sinoniminë. Në një fjalor dygjuhësh, ashtu sikurse edhe në një fjalor shpjegues fjala që shpjegon duhet t’i përgjigjet kategorisë leksikoro-gramatikore të fjalës që shpjegohet. Në këtë fjalor kjo rrugë ka gjetur zbatim të mirë.

Për t'i dhënë sa më të plota fjalët në shqipe është ndjekur një rrugë mjaft e përshtatshme: rreshtimi i disa sinonimeve p.sh., për fjalën “*brengë*” jepen edhe ekuivalentet dialektore “*mjerim*”, “*zi*”; për foljen “*brigoj*” sinonimet “*bërtas*”, “*qortoj*”, apo për fjalën turke “*axgan*” jepen sinonimet “*trim*”, “*krenar*”, “*i zoti*”. Një hulumtues i kujdesshëm mund të mbledhë vargje të gjata sinonimesh në shqipen, po të rendiste në një vend fjalët e përgjithshme të gjuhës, fjalët dialektore, trajtat, huazimet, krijimet individuale. Prandaj ato kanë nevojë për një shoshitje të mirë.

Sinonimia, luan pa dyshim një rol të madh për ta bërë gjuhën më të larmishme, më të gjallë dhe më shprehëse, por sinonimet dialektore e ngarkojnë së tepërmi edhe këtë Fjalor. Kjo ka rrjedhur si pasojë e mungesës së një baze metodologjike të përpunuar në mënyrë të rreptë dhe nga moskuptimi i thellë i thelbit të normës letrare të gjuhës shqipe. Andaj kemi të bëjmë me një mori variantesh fonetike, gramatikore e ortografike.

Ky Fjalor, që ndër të parët që hodhi hapat për një fjalor shpjegues të shqipes. Ai nuk arriti dot deri te një fjalor shpjegues i mirëfilltë, por elementet e këtij tipi nuk janë të pakta, si në shpjegimin (edhe me anë të sinonimeve) shqip, edhe me gërshetimin e shpjegimit me përkthim. Në fjalor duket qartë se edhe përkthimi kryen rolin e shpjegimit. Nuk janë të pakta rastet kur jepet me funksione shpjegimi njëkohësisht edhe sinonimi shqip i fjalës, edhe përkthimi italisht ose kur në vend që të jepet përkthimi jepet vetëm shpjegimi (*bube-a*, *krym*, *krym i mnashit*, *bube mnashit – vermi*). Ka raste madje kur jepet përkthimi italisht me sinonime e gjithashtu edhe shpjegimi shqip me sinonime (*dallke-a (T)*, *shkulm*, *vale – flutto*, *onda*, *travaligo*).

Një problem shumë i rëndësishëm që na del kur shqyrtojnë përbërjen e glosarit nga pikëpamja e normës letrare është padyshim

edhe problemi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe. Në Fjalor një vend të veçantë zë çështja e turqizmave. Numri i turqizmave këtu është shumë i madh. Prej gjithsej të 13.614 fjalëve sa ka fjalori, 1342 fjalë na dalin turke (në fjalor shënohen me shkronjën T).- Përgjithësisht ky fjalor u ka dhënë një vend mjaft të madh fjalëve të huaja, pavarësisht nga prejardhja e tyre. Kjo ka rrjedhur ndoshta edhe nga mungesa e një fjalori të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe. Në këtë fjalor gjejmë fjalë të tilla si *adet, terzi, rrobot, sejte, alet, bafli, alem, axhami, bastis, bahche* e shumë fjalë të tjera tanimë të flakura. Përveç kësaj një numër i konsideruar i turqizmave që gjenden në fjalor si *kajmekan, sejmen, haraç, çiflik, asqer, dushman, zapti, hapsane, bakshish* kanë hyrë në gjuhën shqipe rrjedhimisht nga pasojat që kanë lënë gjurmët e sundimit turk, marrëdhëniet e pronësisë feudale, gjendja e administratës e tjera. Nuk janë të pakta as fjalët që pasqyrojnë terminologjinë e zanateve e të tregtisë, gjegjësisht të ekonomisë së vendit nën sundimin otoman siç janë *zanat, bojaxhi, dyqan, xherdan, esnaj* etj. Është karakteristike, që nëpërmjet turqizmave që depërtuan në gjuhën shqipe, janë të pakta fjalët që kanë të bëjnë me arsim, kulturë, shkencë, e art.

Veç turqizmave mund të hasim edhe në sllavizma e italianizma, por në numër shumë më të vogël.

Ky Fjalor ngërthen në vete fjalë, jo vetëm të gjuhës së shkruar që gjenden ndër vepra autorësh (Bogdani, Budi, Bardhi, Kristoforidhi), por edhe fjalë të gjuhës së folur, që nuk gjenden nëpër vepra, por që autorët e fjalorit i kanë nxjerrë nga burimet e ndryshme. Mirëpo aty – këtu hasim edhe në mjaft arkaizma të pasqyruara në mënyrë të ndryshme (*mik* me çerdhen e fjalëve *miçsi, mikeshe*, pastaj *micsisht, micsoi, micsuem* me ç’rast antonimi i kësaj na del kështu *ânmik, ânmiksii, ânmiksisht, ânmiksoj, ânmiksue*, pra kudo ruhet bashkëtingëllorja *k* që nuk ndodh tek fjala *mik*, por në

disa raste është *q (c)*.

Në përgjithësi fjalorët e paraçlirimit *gjuhë e huaj – shqip* apo *shqip – gjuhë e huaj*, janë mjaft të varfër sa i përket pasurisë së frazeologjizmave, mirëpo në këtë rast fjalori i Kristoforidhit, që vërtet ka fond të “Bashkimit” është mjaft i pasur, edhe pse nuk mund t’ia kalojë atij të begatshëm frazeologjizmesh. Në Fjalorin e “Bashkimit” frazeologjia është dhënë pas shpjegimit të kuptimit a kuptimeve të fjalëve, nuk është i përzier me shembujt ilustrues, bashkimet e lira, proverbat etj. Frazeologjizmat janë dhënë në formë fillestare, në trajtën përfaqësuese, frazeologjizmat foljorë në paskajore p.sh. *me mârre ghakun a t’kécén, me mârre male, me mârre ngryke, me mârre mprapa*; janë ruajtur veçoritë e ndërtimit të tyre, format e gjymtyrëve, parafjalët, p.sh., *me mârre m’sysh, me mí, i, a mârre meet, me e mârre m’lavd, me m’u mârre syt, me mârre udhe, me mârre n’për dore, me mârre dielli a hyiy, m’u mârre fryma* etj.

Pasuria e madhe leksikore, rëndësia e madhe leksikografike, e këtij fjalori përkundër të metave që ka, ka bërë që edhe sot e gjithë ditën të ketë vlerë të madhe, veçmas për studiuesit. Ky Fjalor u bë bazë për fjalorët e tjerë të mëvonshëm që ecën drejt zhvillimit të mëtejshëm të leksikografisë shqiptare. Mjafton të përmendim Fjalorin e Institutit të Shkencave (1954) dhe një varg fjalorësh të tjerë, të punuar me kritere të shëndosha shkencore, e të bindemi se kemi të bëjmë vërtet me një zhvillim të hovshëm e me hapa të sigurt. Në përgjithësi, prirjet kryesore të zhvillimit të gjuhës sonë letrare janë bërë më të qarta dhe njësimi i normës letrare ka ecur shumë përpara në të gjitha drejtimet – në fonetikë, në gramatikë, në leksik, në formimin e fjalëve etj.

Në fund i jemi mirënjohës Redaksisë së botimeve të “*Rilindjes*”, që me ribotimin e botimin e vlerave të trashëguara të

kulturës sonë shpirtërore siç është edhe ky fjalor, na mundësohet një njohje më e mirë e tyre e veçmas për ata që studiojnë.

## PESËDHETËVJETORI I FJALORIT “BASHKIMI”<sup>101</sup>

### Kujtime të reja e të vjetra

-----

Në vjetin 1899, plot dhetë vjetë mbasi kishte kthye nga mërgimi, Abati i Mirditës, Emzot Prend Doçi, themeloi në Shkodër Shoqnín “Bashkimi” me qëllime kulturore-letrare. Rreth tij u mblodhën ajka e klerit katolik shqiptár, Emzot Ják Serreqi, Emzot Lazër Mjedja, Don Ndoc Nikaj, At Gjergj Fishta, At Pashk Bardhi, Don Mark Shllaku, Don Dodë Koleci, e mâ vonë, i vetmi civil, Luigj Gurakuqi. Shoqnija i u vû punës me serjozitet, e mbrenda shtatë vjetve, përveç krijimit t’alfabetit, të njoftun me emnin “Bashkimi”, i cili pat qënë pranue nga shumica e shkrimtarvet, botoi 32 vepra, ndër të cilat disá me randësi të madhe, e qi edhe sot nuk e kanë humbë vleftën. Po përmendim, ndër tjera, librin e Don Ndoc Nikajt “*Historija Shqipnis q’me fillesë e deri në kohë kúr rá në dorë të Turkut*” (Bruksel, 1902. Ky është ai libri shqip, për të cilin na flet Fishta n’ “Anzat e Parnasit”, ku ankohet se nuk shitej: “*Sot n’Shqipni, morë lum miku, - Historí është meteliku*”. Mos të harrohet në ket mes, se Don Ndoc Nikaj është auktori i mâ se 30 librave shqip, të gjith me frymë kombtare, ndër të cilët nândë romana me mbrendí shqiptare. Shoqnija “Bashkimi” ká botue edhe dy blëjt e parë të “Lahutës” – *Marash Uci dhe Oso Kuka* -; prap kjo Shoqní ká shpallë librin “*Vargnimi i gjuhës shqipe*”, shkruar nga Luigj Gurakuqi e

---

<sup>101</sup> Karl Gurakuqi, *Shejzat*, Romë, 1958, nr.7-8, f. 223-226.

botue në Napoli në vjetin 1906. Gurakuqi i a kushton ket libër, në peng nderimi, Át Fishtës: “... *edhè Shqiptarët ashtu, q’at herë qi ushtima – E lahutës s’ate nisi me tingllue, - Shuen kângën të gjith e, sjellun kah Zadrìma, - Zùnë me ndigjue*”. Fishta e Gurakuqi ishin shokë të pandamë, bashkëpunëtorë të ngushtë në kulturë e në politikë.

Por vepra mà e çmueshme, jehona e së cilës ndihet edhè sot, ástht, pá tjetër, “*Fjalori i rí i Shqypes*”, qi simjet mbushë pesëdhjetë vjetë. Emzot Doçi, edhe pse larg Atdheut, i ndjekun nga qeverija turke për ndiesít e tija atdhetare, pse kishte marrë pjesë në kryengritjen në kohën e Dervish Pashës kundra vendimit të Konferencës së Berlinit për t’i a lëshue Ulqinin Malit të Zi, nuk pushonte së vepruemi për lavrimin e gjuhës, si mjeti mà i pari për me zgjue Shqiptarët e me i përgatitë për vetqeverim. Ishte prandej në marrëdhânje të papreme me njerzit mà shêj, sidomos me famullitarët e malevet. Udhëzimet, qi Emzot Doçi u jipte bashkëpunorvet të vet, i a njoftonte me anë njerzish të besueshëm Don Dodë Kolecit në Mirditë, të cilin Abati e donte dhe e çmonte për zgjuesi mendjeje, për kulturë e për zotsí ndërmarrjeje. Qysh aso kohe Doçi e Koleci e kishin pasë qitë cekën të mblidhej pasunija gjuhësore e popullit të malevet. Për ket qellim famullitarët ishin të këshilluem t’i vîheshin punës me zell. Sesili, mbas zotsís së vet, mirrte shenime, mblidhte fjalë të rralla bimësh e pemësh, zogjsh e shtasësh, dikush tue u vû përbri përgjegjsten italishte, ndokush tue i spjegue e ndonjëni tue u vû pranë përkthimin latinisht. Kështu punoi Don Prend Suli, Don Pál Trêshi, Don Mark Shllaku, Don Ndoc Nikaj, Át Pashk Bardhi, të gjith antarë të Shoqnís së mâvonshme “Bashkim”.

T’ardhmen, si erdh në Shqipni Emzot Doçi, i falun nga qeverija turke me ndërmjetsín e Sekretarís së Vatikanit e të

Patriarkut të Stambollit Azarian, i cili kishte hÿ dorzânës për të se do të hiqte dorë nga kryengritjet, mendimi i parë i tij qe t'i përmblihte këto fuqí të shpërndame e t'i bashkonte. Kështu zûni fill prá Shoqnija e mirënjoftun "Bashkim". Këshilli i Shoqnís në mbledhjet e para qi mbajti, vendosi merendimin e materjalit të Fjalorit. Kjo punë i u ngargue Don Dodë Kolecit, i cili mund të quhet auktori i vërtetë i tij, pse ky e pat pjesën mâ të madhe të hartimit, të spjegimit apo të përkthinit të fjalvet në gjuhën italjane, tue qênë se kishte pasë qênë pá e arsyeshme qi Fjalori të përpilohej në dÿ gjuhë, shqip – italisht.

Fjalori u botue në Shtypshkrojën e Jezuitvet në Shkodër, ku kjo vepronte për botim librash shqip me mbrendí mâ tepër fetare, qysh prej vjetit 1870, si mâ e vjetra shtypshkrojë në Shqipnî. Nuk ká as emën auktori, as vjet botimi, as emën shtypshkronje, por në fund të parathânjes shofim ket shenim: "*Parsimi i Shoqnis Bashkimi të Gjuhës shqype*" e mâ poshtë: "*Shkodër, 9 Kallnuer 1908*". Fjalori përfshín 538 faqe, secila në dÿ shtylla, përveç 12 faqeve tjera, të shënueme me numra romanë, dhe qi i paraprîjnë Fjalorit. Këto rrokin parathânjen, disa vrejte mbí gërma e theksa, spjegimin e fjalvet të shkurtueme e mâ në fund bibliografin me katër emna auktorësh, Bardhi, Budi, Bogdani e Kristoforidhi.

Rândësija e këtij Fjalori âsht njoftë e njifet prej çdo albanologu. Kúr flitet për leksikografin shqipe, vendin e parë e zên "Bashkimi" me 14.000 fjalët e radhituna, pse përmbledh krejt pasunín leksikore të kohës para vjetit 1908, të qemtueme me kujdes e me kompetencë, përsá lejoheshin kohët, rrethanat dhe mjetet. "Kemi mbledhë – thonë në parathânje përpiluesit – mâ të shumën, sá ku kemi mujtë, t'atyne fjalve sikurse fliten nepër qytete, fusha e male të së dashtunës atmes s'onë. Mbas këtyne, kemi pasë kujdes me shtî mbrendë edhë ato qi gjinden të shtypuna në libra, në fjalorë



e në shkrime të të shndriçëmve dijetarve t'onë e të huejve, qi aq me zëll janë mundue me i dhânë shkëlxim e hijeshí gjuhës s'onë, sikurse Dom Pjetër Budi, Emzot Frang Bardhi, Emzot Pjetër Bogdani, Gustav Meyer-i, Át Ják Jungg-u, Kostandin Kristoforidi, e disá tjerë të tashëm edhè mâ”.

Simbas pohimit t'Át Pashk Bardhit, qi ká qênë edhe sekretari i Shoqnís dhe qortuesi i provavet të shtypit, në fillim kishte qênë vendosë qi Fjalori të përfshînte edhe neologjizmat, e për këtë punë kishte qênë ngarkue ai vetë; por, mâ vonë, kishte qênë pjekë mendimi të hiqej dorë nga ato, pse nuk ishin endè të pjekuna sá duhet, nuk kishin marrë endè shtesín. Asht punue shum me mend, pse aso kohe çdo shkrimtár gazete, çdo njerí qi ngjyente pendën, i a kishte mbushë mendën vedit se ishte gjuhëtár, se mund të krijonte fjalë të reja ashtu si i vînte përdore. Shpesh në shkrimet e atëherëshme, por besa, edhè n'ato mâ të vonshmet, kemi vû ré sajime fjalësh të bâme kundra çdo rregulle së dijtunís gjuhësore. Na, në Fjalorin shqip-italisht, qi e kemi gatí për botim, i kemi shtí noelogjizmat, por tue i shenuë si të tilla, ndonsè shum prej sosh, të sajueme simbas natyrës së gjuhës, mund të kundroheshin si pasuní leksikore e fitueme.

Përpiluesit e Fjalorit “Bashkimi” thonë se “i kanë pá gjasën me i lânë fjalët e qituna rishtas e të përbâme, për një tjetër të shpallun mâ të peshuem”. Po, e dij me sigurí se do të bâhej një botim i dytë i Fjalorit të Bashkimit, me shtesa e përmirsime; madjè kam pá me syt e mij një kopje të këtij Fjalori të lidhun me aq faqe të zbrazta sá janë shtypunat. Kjo kopje ishte pronë e Át Bardhit, i cili shkonte tue i mbushë ato me fjalë qi me kujdes të posaçëm mblidhte andej e këndej nga goja e popullit apo nga faqet e libravet e të fletorevet.

Kanë kalue pesëdhjetë vjetë nga botimi, por Fjalori nuk e ká humbë aspak vleftën e vet. Të gjith fjalorët tjerë qi janë botue mbas tij e kanë marrë si themel, e kanë shfrytzue, dhe asnji s'ká mujtë me i a dalë në përpikní. Shkrimtarvet t'onë u ka hÿ në punë në përpilimin e vepravet të veta: Kolë Thaçi, Don Lazër Shantoja, Don André Zadêja, Ernest Koliqi, etj. e kanë pasë si ungjíll, e, kur kanë dashtë me përforcue përdorimin e ndonjij fjale së bukur e të rrallë, kanë theksue me krenari se akcilën fjalë e ká “Bashkim”, sikurse dojshin me thânë se nuk gjindeshin në gabim.

Jemi njerz e mund të gabojmë. Ndonji gabim u ká rrëshqitë edhe përpiluesvet të “Bashkimit”, por këto janë gabime të falshme, qi mund të qortoheshin në botimin e dytë. Jemi të sigurtë se edhé atyne do t'u ketë rá në sÿ gabimi i faqes 113, ku fjalës *fnyell* i jepet kuptimi i *këpucarit*, kurse don me thânë *biz ase feme*; gjithashtu se fjala gjetkëz nuk e ká kuptimin *campo di patate* (marrë: *qui pro quo* nga Kristoforidhi), por *vend ku mbyllen patat*; do t'a kenë vÿ ré se fjala hamurik (f.152) nuk don me thânë *fame*, por *talpa*; po, do të kenë vrejte se fjala *këlcatës* nuk i përgjigjet fjalës italishte *cagnolino*, por fjalës *schizetto*, qi në Shkodër i thonë *pushkaliqe* e në ndonji krahinë tjetër: *këllcacë*, *stërfyc*, *stërlagës*, *stërkitës*, etj. I qofshin falë këto gabime.

Sot kanë vdekë të gjith ata atdhetarë, por na nuk i harrojmë. Në rasën e pesëdhjetëvjetorit ulim gjÿnin para vorrit të tyne, i kujtojmë dhe u japim fjalën se do të punojmë mbas gjurmavet qi kanë lânë!

## PARATHANIE<sup>102</sup>

Po qesim në dritë këtë fjaluer me të cilin kemi mbledhë ma të shumen, sa kemi mujtë, të atyne fjalëve sikurse fliten nëpër qytete, fusha e male të dashtunes atmes sonë. Mbas këtyre, kemi pasë kujdes me shti mbrendë edhe ato që gjinden të shtypuna libra, në fjalorë në shkrime të shndritshmëve dijetarë e të huejve qi aq me zell janë mundue me i dhanë shkelzim e hijeshi gjuhës sonë, sikurse dom Pjetër Budi, Emzot Frang Bardhi, Emzot Pjetër Bogdani, Gustav Meyeri, atë Jak Jungu, Kostandin Kristoforidhi, e disa të tjerë të tashëm edhe ma. Fjalët e qituna rishtas e të përbame, sado që shihen shpesh sidomos nëpër tue pa gjasën me i lanë për një tjetër të shpallun ma të peshuem të këtij Fjalori të Bashkimit.

Tue qenë mbledhun fjalë shqipe prej gjithë anësh e tue qenë shumë herë të ndryshueme në të folun të popullit u venduan në fjalor të sjelluna, tue na u dukë ma pëlqyeshëm për përparim të gjuhës kombëtare, në trajtë të shqiptimit të Shkodrës. Mbasandej, si s'mundej prej secilit me u marrë vesh çka duen me thanë, i vumë për sherbim e ndihmë tonë dëftimin italian sikurse një gjuhë ma e njoftun ndër këto vende. Me gjithë këta, disave ndër to që fliten ndër ne kemi mujtë me ia gjetë të përgjegjunit të këtë gjuhë të huej, e mu për disa tjera as vetë s'dimë ende

---

<sup>102</sup> Parsimi i Shocniis Bashkimi t'Giuhes Sheypé.

Shkoder, 9 Kallnuer 1908 – transkriptuar me alfabetin e sotëm.

se ç'duen me thanë. Po asht shpresa se mbasi të përhapet shqipja letrare këto diftime s'kanë për t'u lypun e këto mungesa kanë për t'u zhdukë prej fjalorit tonë.

Mbas shqipes së sotme, të shuma janë fjalët e marruna prej gjuhëve të hueja. Edhe këto kemi dashtë me i vu në rreshta të vet, por ma të shumave të ktyne u asht vendue afër të përgjegjunit thjesht shqip me shkronja ma të imta por me u dallue ma mirë. Do të shihet me lehtësi mbas të përdoruesit të këtij fjalorit a do të jetë nevojë me ia kthye ndryshe rendin që u ndoq në këtë të parën të shpallun për një tjetër.

Ne mbrame janë të lutun gjithë shqiptarët e vërtetë me na ndihmue edhe me fjalë e diftime që s'gjinden në këtë fjalor, të cilëve tue iu urue gëzim e lumni për nder e dobi të gjuhës sonë, po iau kushtojmë.

## PARATHÂNIÉ<sup>103</sup>

Po césim n'drite ket fialuer m't'sillin kémi mbledhe mâa t'shumen, saa kémi multe, t'atyné fialvé sikursè flitén nneper ghytété, fusha e malé t' dashtunés atmés s'one. Mas ktyné, kémi pase kuidésme shtii mrénne edhé ato ci ghinnén t'shtypuna libra, n' fialoree n' shkrimé t' shnrichemvé diétarevé e t'hueivé ci ac me xéllé iâne munnue me i dhâne shkelzim e hiiiéshi giuhes one, sikursé Dom Piéter Budi, Ěmx. Frang Bardhi, Ěmx. Piéter Bogdani, Gustav Meyer-i, Atë Iake Iungg-u, Kostandin Kristofaridi, e disa tiére t'tashém edhé mâa. Fialet t'cituna rishtas e t'perbâamé, saado ci shifén shpesh sidomos nneper tui paa giasen me i lâne per ngi tiéter t'shpallun mâa t'péshuem t'ktii Fialorit t'Bashkimit.

Tui kéne mlédhun fiale sheypé préie ghith ânesh e tui kéne shum hére t'nnryshuemé n' t' folun t'popullit u vénnuené n'fialuer t' siélluna, tu n' a u duke mâae pelcyeshem per perparim giuhes komtaré, n'traite t' shcypimit t' Shkoders. Masanné, si s' munnéi préie séitsillit me u mârre vesht shkaduen me thâne, i vûumé per sherbim e nnihmé t'one diftimin italian sikursé gni giuhe mâa e gnoftun nner kto vénné. Me ghith kta, disaave nner to ci flitén nner nee kémi multe me i' a' u ghéte t' perghéghunit n' ket giuhe t'huei, e mu per disaa tiéra as véte s'diim nnénné se ch' duen me thâne Po âsht shpnésa se masi t'perhapét

---

<sup>103</sup> Parsimi i Shocniis Bashkimi t'Giuhes Sheypé. Shkoder, 9 Kallnuer 1908.

Sheypia letraré kto diftime s'kan per t'u lypun e kto mungésa kan per t'u shduke preie Fialorit t'one.

Mas shcypés t'sodés, t'shuma iâne fialet t'mârruna preie giuhevé t'hueia. Edhé kto kémi dashtë me i vûu m'rreshta t'vet, por mâa t'shumavé t'ktyne u â vennue afer t'pergheghunit thiéshte sheyp me shkroia mâa t'ima por m' u daa mâa mirë.Do t'i scifët me leetesii mass t'perdorue mit t'ktii fialorit a do t'ieet névoi me i' a kthye nnryshe rénnin ci u nnoc n'ket t'paren t'chpallmé per gni tieter.

Neemram idne lutun ghith Sheyptaret e vertete me n'a nnimue edhé me fiale e diftimi ci s'ghinnen n'ket fiauluer, t'tsillve tu i'u urue gxim e lumnii per nneer e dobie t' giuhes s'one po i'a'u kushtoime.

**Ahmet Kelmendi**

**Dy fjalë me rastin e ribotimit<sup>104</sup>**

Në shekullin e kaluar, sidomos në gjysmën e dytë të tij, ndër qarqet shkencore evropiane ekzistonte mendimi se mund të trajtohet popull, komb i denjë për vetëqeverisje, vetëm ajo bashkësi, ai komb që ka folklor të pasur, gramatikë të zhvilluar, të normuar, të shkruar, po ashtu edhe fjalor të pasur të botuar.

Kjo kërkesë jo vetëm e asaj kohe, i nxiti rilindasit tanë të mbledhin e të botojnë thesarin tonë gojor (Jeronim de Rada, Darajt, Th. Mitko, S. Dine etj.) dhe të hartojnë gramatika të gjuhës amtare (Dh. Kamarda e De Rada-italisht, K. Kristoforidhi - greqisht, S. Frashëri - shqip, V. Pasha - frëngjisht etj.), gjithnjë me program dhe me qëllim të caktuar.

Derisa nëpërmes të folklorit shprehet shpirti i një populli, me gramatikë pjekuria logjike-gjuhësore-shprehimore e kombëtare etj., me fjalor shprehet pasuria kulturore, shkalla e gjerësisë kulturore dhe historike e një populli. Prandaj edhe fjalori u bë objekt interesimi i rilindasve tanë. Meritë të veçantë në këtë fushë ka edhe shoqëria “Bashkimi” e Shkodrës.

Të përmendim të dhënë që dëshmon se historiku i leksikografisë shqiptare nuk zë fill në periudhën e Rilindjes Kombëtare, por disa shekuj më parë, me Fjalorin latinisht-shqip (1635) të F. Bardhit. Që nga kjo zanafillë

---

<sup>104</sup> “Fjalori i Bashkimit” (Ribotim), Prishtinë, 1978, f. V-VII.

deri në periudhën e Rilindjes janë botuar dhjetëra fjalorë, kryesisht dygjuhësorë, jo rrallë edhe disagjuhësorë, në të cilët shqipja ka pasur prore vend të konsiderueshëm.

Në vijim të përpjekjeve për mbrothësinë e kultures kombëtare inkuadrohet edhe shoqëria “*Bashkimi*” e Shkodrës, e cila themelohet më 1899, dy dhjetëvjeçarë mbas Lidhjes së Prizrenit. Kjo shoqëri që e para që në truallin shqiptar zuri të botojë libra në gjuhën shqipe e me alfabet latin, me karakter jo vetëm fetar po edhe shkollor e profan, në kohën e robërisë otomane, e cila u ndalonte shqiptarëve çdo përpjekje në drejtim të arsimit.

Shoqëria “*Bashkimi*” anëtarë të së cilës ishin ishin edhe disa figura të shquara, si: Prenkë Doçi, Luigj Gurakuqi, Dodë Koleci, Ndoc Nikaj etj., brenda 9 vjetëve të punës së vet mjaft pjellore (1899-1908), përpos këtij Fjalori të gjuhës shqipe, i cili ribotohet tani, nxori në dritë edhe 31 tituj të tjerë, kryesisht me karakter shkollor, didaktik e letrar, por edhe fetar, si: *Gramatikën ja Folmarmjen shcyptare* të Dodë Kolecit (1901); *Oroe permbi Abetar shcyp, Vargnimit* e Luigj Gurakuqit; pastaj disa abetare të thjeshta: *Këndonjtore, Dheshkronjë, Numërtore, Kalendarë Shcypтари*; për disa vite *Historinë e Shcypniis* etj.

“Fjaluer i Rii i Shcypes” (1908) (Fjalor i ri i gjuhës shqipe) që ka firmën e autorësisë “Përbâam preie Shocniet t’*Bashkimit*”, simbas të gjitha gjasave duhet të jetë vepër e Dodë Kolecit, në të cilin ka gjurmë të ndikimit të fjalorit të K.Kristoforidhit, është një ndër veprat kapitale të leksikografisë sonë. Ky fjalor u përdor dhe u konsiderua, siç konstaton Jup Kastrati (Histori e gramatologjisë



shqiptare) ndër më të mirët në leksikografinë shqiptare deri në botimin e Fjalorit të Institutit të Shkencave (1954). Fjalori i Bashkimit, sikurse zuri të quhet, ka një abece me bazë latine, alfabet i cili, thuajse ishte mbështetje bazë edhe për alfabetin që u miratua në Kongresin e Manastirit (1908)

Ky fjalor është mjaft i pasur për kohën kur u botua. Me pjesën integrale dhe me shtojcën na del me afro katërbëdhjetëmijë fjalë (13.798 fjalë). Fjalori nuk ka emërtime vendesh nga është marrë njëra apo tjetra fjalë. Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi mbështetet kryesisht në të folmen e Shkodrës. Së këndejmi ky ka vlerë edhe dialektologjike. Këtu fjalët me gurrë të huaj që kanë zënë vend në fondin tonë leksikor, kanë përbri indikatorë me shenja p.sh.

I- për fjalët me gurrë italiane, S- për fjalët me gurrë sllave, T- për fjalët me gurrë turke.

Ky fjalor i botuar në truall të shqipes gjatë sundimit otoman, më 1908, katër vjet mbas atij të K.Kristoforidhit, bashkë me të Sotir Pecit që mbeti sot e kësaj dite në dorëshkrim, ngërthen në vete një thesar të çmueshëm të leksikut tonë, në pjesën më të madhe të vjetëruar, njësi leksikore që mund të gjallëroheshin dhe të ktheheshin në jetë të fondit aktiv leksikor, duke pësuar përpunime të duhura leksikore funksionale.

Ribotimi dhe botimi i monumenteve të kulturës sonë shpirtërore të gjuhësisë sonë, nga ana e redaksisë së botimeve të *“Rilindjes”*, si është fjalori i Bashkimit, ka për qëllim që vlera të krijuara me kohë t’u jipen në dorë të

interesuarve, sepse mund t'u shërbejnë gjithnjë  
hulumtuesve të ndryshëm dhe të tjerëve.

**Fjalori i “Bashkimit” (1911). Vlerësim nga A. Xhuvani<sup>105</sup>**

Dy fjalorë kemi në gjuhën tonë pak si të mirë e qi sidokudo e mbushin një mungesë ksodoret, Fjalorët e Kristoforidhit e të “Bashkimit”. Mjerisht kta të dy nuk munt t’i përdori tjetërkush veç atij qi din greqishten e italishten. Fjalori i Kristoforidhit asht bamun, pas kohës qi rronte auktori, ma me mjeshtëri e ma me systemë, pas mendjes tonë, se aji i “Bashkimit”, i cili ia kalon të Kristoforidhit vetëm nga shumica e fjalvet të mbledhuna, sikurse thohet në parathane, nga qytetet, fushat e malet e Shqipnis. Por mungesa ma e para e Fjalorit të “Bashkimit” asht pas mendjes tonë, shinjimend në ato fjalë të pahasuna në Fjalort të Kristoforidhit e qi auktorët e librit me zell të për lavdueshëm kanë mujtun me i mbledhun andej e ktej nga goja e popullit. Sepse ma të shumtat e ktyne fjalve, ashtu si janë shkruem e përkthym, nuk munt të merren vesh e të përdorohen prej çdo njeriu. Auktorët e Fjalorit janë kufizuem vetëm në përkëthimin e këtyne fjalve me fjalët italishte qi i përkasin, pa i përcjellun kto me shemblla, me fraza ashtu si përdorohen në gjuhët, në mënyrë që një që nuk i din këto fjalë nga dhialekti vet, a nuk i ka ndëgjuem prej ndokuj, apo nuk i ka hasun andej e ktej nëpër librat, nuk mund t’i shtjer në punë e t’i përdorojë për nevojat e tij.

---

<sup>105</sup> Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave, *Aleksandër Xhuvani-2*, Tiranë, 1999, f. 22 – 25).

Tue e përfletun Fjalorin e “Bashkimit” qi kemi përpara sysh po marrim si më të shkruem vetëm kto dy fjalë që të diftojmë me shemblla ato qi thamë më sipër, substantivin *kllapi* (f. 195) e verbin *msyj* (f. 287). Fjalës së parë i jepet përkthimi në atë fjalor në italishtet me fjalën *vaneggiamento*; fjala e dytë përkëthehet me fjalët: *rivolgere, dirigere, accostarsi* collintenzione di trattare o di affrontare. Siç dihet, këto dy fjalë nuk përdorën në toskënishtet, por në gegënishtet, e madje në gegënishtet e sipërme. Nji toskë pra a një gegë, në dhialekt të të cilit nuk përdorën ato fjalë, sado mirë me e ditun italishten, nuk mund t’i përdorin pa lajthim, ashtu siç janë të papërcjelluna me shemblla, veç në kjoftë se iu ka ndodhun t’i ndëgjojë prej të tjerëvet, apo t’i ketë hasun ndër librat. Që të jenë të kuptueshme e të përdorohen prej thithkuj ato fjalë, duhen fthillzue me shemblla, sikurse bâhet kjo punë në gjithë fjalorët e gjuhvet të hueja. Duhesh pra pas mendes tonë, që ato fjalë tzë kallzoheshin me shemblla, si me kto: *i ligu* (= i sëmuri) *flet kllapi*, *i ligu trt në kllapi*; mos *fol kllapi*, tue u përkthiem secila nga kto në italishtet. E mbassi në toskënishtet e në dhialektet e tjera ky kuptim kallzohet tjetrazi, munt të shtoheshin edhe kto: në toskërishtet thohet: *flas përçart*; thohet edhe: *flas kot*; *bije kot e kot* (Elbasan), etj. Për verbin, *msyj* munt të shkruheshin kto shemblla: *msyj njerin, qytetin, shtëpinë* (miksisht) = drejtohem, marr udhën për me vajtun te ..., *msyj njerin, qytetin, shtëpin* (anmiksisht) = i hidhem, i vërsulem.....tue përkëthyem edhe kto shemblla në italishtet e tue shtuem që në toskënishtet a ndonji dhialekt

tjetër thohet edhe: *sulem, vërsulëm, hidhem, dërrudhem* etj.

Por nuk janë po ato dy fjalë a disa të tjera të pakta qi duhen përcjellun me shemblla që të përdorohen prej gjithkuj; sa e sa fjalë të tjera janë në ate Fjaluer që, pa kjenë të ftillzue me fraza, nuk din kush qysh me i përdorun: Qysh munt t'i përdorij p.sh. një toskë, ose një tjetër qi s'i din, kto fjalë; *nyteroj, reshij, skapë-a, gëzas, pinjuell-olli*; pa pasë hasun a ndëgjuem andej e ktej e pa ditun që thohet:

*I nytëroj ndokuj në vesh, ujët e zallit nytëron kandshëm;*

*Reshij ndokend me të mira, me gjithfarë të mirash:*

*Arrij në skapë të lumnis, të mirnis.*

*Gëzas ka të bëjë me verbet zhigas, gëzhis, zis, pra gërgas, ngas eys.*

*Pinjuell-olli* haset në frazen "*pinjuell shejtnish*".Te Flamuri i Arbërit( I , 2 VI) të De Radës po me atë kuptim në trajtën *pajolin*.

Si munt pra kush me i përdoruem të tilla fjalë, pa kjenë ftillzue me ksi shembllash?

Asht e vërtetë se ngandonjëherë mundet kush me i përdoruem disa fjalë pas kuptimit që kanë në Fjalort, tue i krahasuem kto me fjalë të tjerashqipe apo me të hueja po të fjala *luhas* (f. 230) asht si verb "frequentativ" i verbit *luej*: fjala *nuhas* (f,308) munt të vij xat' nga fjala *hundë*, si *ruxoj*, *zuroj*, *numuroj*, *munuroj*, *lezet*; *zelet* etj. Fjalët *riqoj* *redoj* (f. 375 e 373) munt të kenë po atë kuptim: kështu edhe fjala *shpotis* munt të jetë një me fjalën gjermanishte

*spoten*. Fjalët *flankth* (f. 174 te fjala “kafaz”), *humak*, *katallâ*, munt të kenë gjini me fjalët greqishte (*humus*), (*krotolla-katalla*).

Por në kjoqhtë se disa nga këto fjalë munt t’i përdorij kush me siguri tue i ardhun rreth etymologjis e tue i krahasuem me të tjera, por ma të shumtata nukmundet çdo njeri me i pëdorun me siguri kuptimi, pa mos qenë të përcjelluna me shemblla. Veç ksajë mungese, Fjalori ka edhe një tjetër, që shumë fjalë janë marrë për shqipe, në vent qi ato janë të hueja. Kështu fjala *stis* ( f. 405) nuk asht shqip, por greqisht, nga -----; fjalët *peleqis, molis* janë edhe kto greqishte, fjala *mat* (f.256) e cila haset, na duket, në librat e De Radës, sikurse e kemi vizhguar, asht kalabreze. Fjalët *harbe* (f.153), *dokënis* (f.91), *ktopra* (f. 259) qi që nuk shënohen me shkronjën T nuk janë shqipe, por turqishte e arabishte. Por veç ktyne të pakave fjalë greqishte qi përmendme e të cilat janë radhosur sikur me pasë kjenë shqipe, po të përfletet i gjithë Fjalori e të vështrohet me orë, munt të hasen edhe të tjera fjalë tl hueja qi janë marrë për shqipe.

Fjalët turqishte të shënuara me shkronjën T do të ishte mirë që të mos futeshin mbrenda, apo të radhoseshin mbrapa librit me një shtojcë të veçantë, kështu që, tue u përvendosun gjithnjë, në të mësuemit të njerëzvet, me fjalë fjesht shqipe, të shduken pak nga pak e të mos vehen ma në Fjalor në një shpallje të tij të tretë a të katërtë.

Fjalori i Kristoforidhit nuk ka fjalë turqishte, veç ndonjë të rrallë, ndoshta të shpëtuar, si fjala *garamet*; por edhe në të shkruarët e landës, në të përcjellunit të fjalvet

me shembulla e nnë të kallzuemit të vrrelles nga janë marrun. Fjalori i Kristoforidhit asht i bamun ma mirë se i “Bashkimit”, sado që jo pas systemës të sotshme të Fjalorvet.

Gjuha e janë nuk asht edhe e zamaritun e e vizhguar mirë e nuk u kanë mbledhur edhe gjithë fjalët e sajë, e nuk janë ba kto të njohtuna e të dituna prej gjithë popullit. Andaj gjithë fjalët e reja qi mblidhen nga malet e andej e këtej, e qi nuk janë të përdorueme në gjithë dhialektet, por vetëm në disa, duhet që të përcjellen me shemblla që të dij bota qysh t’i përdori, e të kallzohet edhe vendi, -- kjo punë gjer në një kohë duhet bamë, ---nga janë marrun siç ka bamë Kristoforidhi në Fjalort të tij.

Besojmë se kto vrojtime të pakta e të përungjëta qi bâmë përmbi Fjalorin e “Bashkimit”, auktorët do t’i marrin ndër sy, kur ta botojnë për së dyti, kështu që Fjalori i !Bashkimit”, tue u përmirsuem etue u shtuemgjithnjë, të zajë vendin e një Fjalori Akademik në gjuhën tonë.

## Sajimi i një alfabeti të përgjithshëm.<sup>106</sup>

...Nder pjestarët dikush ishte ma puntuer dikush ma i ploxhët e dikush edhe nuk pat shkrue as fare. Puna ma e madhja e ma e randa kje fjalori. Ata e muer mbi veti Dom Dodë Koleci në bashkim me mue e me Dom Mark Shllakun.

Une me gjith se kishem shkrime tjera neper dorë, ju perkraha shum Dom Dodë Kolecit, por aj bani pjesen ma të madhen e fjalorit. Une një të tretet e Dom Mark Shllaku një kater a pesë germa. Shkrimet tona n'at pikë ishin per ndimë me i lehtsue Dom Dodës muendin edhe ja çueme shkresat qi aj i rregulloj per shtyp.

Fjalori ishte një botim i parë sa per rregullimin shoqnuer e mbas tij do të shtypej një i dytët me shtesa e me dlirsime të reja të fjalve të hueja. Per at qellim na caktueme me i çue të gjith famullitarve nder katundet e nder malcinat ka një kopje të fjalorit, me lutje qi të mbëlidhte se i cilli fjalë shqype tjera qi nuk ishin aty,të foluna prej popullit ashtu mund plotshej një fjaluer shum i pershtatëshem per giuhen t'onë Kuej të çonte ma shum fjalë të reja të mbledhuna patme caktue me i dhanë një çmim të veçantë.

---

<sup>106</sup>Dom Ndoc Nikaj, *Kujtime të një jetës së kalueme*, Tiranë, 2003, f. 172 – 173.



## **Puna e Doçit dhe e shoqërisë “*Bashkimi*” në fushën e gjuhës shqipe. \***

Për hartimin e fjalorit Doçi i kishte caktuar çdo anëtarin me mbledhë fjalët e një numri shkronjash. Ashtu si për drejtshkrimin e gramatikën edhe për fjalorin puna përgatitore duhet të ketë nisur qysh me krijimin e shoqërisë. Të shtyrë, mbase, nga ndonjë fuqi e huaj, qysh në periudhën përgatitore të hartimit të fjalorit gjenden manafikë, që i kundërvihen shoqërisë “*Bashkimi*” në çështjen themelore: Njesimin e gjuhës shqipe. Kjo kuptohet nga një artikull i botuar në “*Albania*”, në të cilin ndër të tjera vihen në dukje:

*“U mbushën 3 vjet që disa nga atdhetarët e Shkodrës veç për t’i vjeft atdheut u mblodhën në një shoqëri vllazërisht për me derdh mundin e vet për gjithçka të lypte nevoja e gjuhës... Nuk ishin përnjëmend më të diturit e Shqipërisë, po pa zor mund të thuhet më të vullnetshmit për me i vjeft atdheut...”*

*Me ditë të sotme shoqëria “Bashkimi” po i rrëfen botës e atdhetarëve se nuk kanë asnjë mendim tjetër veç për drejtim e hollim të gjuhës shqipe, që nuk ka pas as nuk ka qëllim që duke mbledhur të gjitha të folmet e Shqipërisë në një, gega të dalë mbi toskën e anasjelltas, por vetëm që Shqipëria të ketë gjuhën e shqiptarëve të hershëm pa*

---

\*

Pal Pjetër Doçi, Imzot Prend Doçi, abati i Mirditës, Jeta dhe veprat, Tiranë, 1997, f. 104-106.

*ndërlikime, të dliurë e të kulluar si e ka e kanë folë motit. Të merren fjalë prej njënes e tjetres të folme*".<sup>1</sup>

Qysh pa u përfundue ende fjalori, nga Shkodra i kumtohej Vjenës: "*Sado e rëndësishme të jetë kjo punë për përparimin e gjuhës shqipe, nga ana tjetër ne nuk duhet ta lëmë pa e pa se ajo do të ketë si rrjedhim një përkrahje të mëtejshme të gjuhës italiane në Shqipëri*". Ndër të tjera Vjenës i kumtohet: "*Shoqëria gjuhësore "Bashkimi" e mbaroi fjalorin. Është një vëllim i vogël 538 faqesh, është me alfabetin e "Bashkimit", d.m.th. dy shkronjesh... merr si bazë dialektin e Shkodrës me shumë theksime mirditasish*".<sup>2</sup>

Këtij fjalori i është bërë jehonë si në shtypin kombëtar, ashtu edhe nga studiues të njohur të gjuhës shqipe. Profesor A. Xhuvani, mbasi i bën një varg vërejtjesh, shfaq mendimin se në botimin e dytë fjalori i "*Bashkimit*", "*Tue u përmirësue e tue u shtuemun të zeje vendin e një fjalori akademik të gjuhës sonë*".<sup>3</sup>

Këtë fjalor e kanë vlerësuar mjaft lart, prof. Ahmet Kelmendi, Gaetano Petrotta etj. Në veprën "*Leksikologjia e gjuhës shqipe*", botuar në vitin 1984 thuhet: "*Në vitin 1908 u botua në Shkodër Fjalori i ri i shqipes i shoqërisë "Bashkimi". Është një fjalor dy gjuhësh shqip-italisht... Ky fjalor përfshin një lëndë deri diku të zgjedhur dhe të shpjeguar mirë... Fjalët jepen në çerdhen e tyre. Edhe në pjesët shqipe jepen nën një fjalë sinonime shqipe dhe të*

---

<sup>1</sup> *Albanaia*, Bruxelles, 1902, Nr. 3, f. 58-60.

<sup>2</sup> *AIH*, D. 18-697, Nr. 37, Shkodër 12 prill 1908.

<sup>3</sup> A. Xhuvani, *Fjalori i Bashkimit*, në *Shkreptima* 1911, Nr. 15.

*huajtura. Fjalori i shoqërisë "Bashkimi" ka shërbyer gjithashtu si mbështetje për fjalorë të tjerë"*<sup>4</sup>.

Duke vlerësuar punën e kësaj shoqërie në lëmin e letërsisë Luigj Gurakuqi shkruante: *"Akademia e "Bashkimit" në pak vjet i solli shumë ndihmë literaturës sonë me botimet e veta të vlefshme. Pjestarët e kësaj shoqërie kishin me të vërtetë qëllime të larta e ishin të zotët me i vjeftë lulzimit të literaturës tone"*<sup>5</sup>.

Në një letër që Faik Konica i çon Gjeçovit ndër të tjera thekson: *"Mundësisht pra t'i jepet za t'emzot Preng Doçit se puna vete shumë mirë e se megjithë kundërshtimet e paarsyeshme, shoqëria që themelojti me bashkëpunëtorët e tij do të zerë vendin e parë në listën e bashkimit të gjuhës e kombësisë shqipe". Edhe Milo Duqi shpreh mendimin se "Duhet t'i jemi mirënjohës Preng Doçit për punët e mëdha që i ka bërë letërsisë shqipe si kryesonjës i shoqërisë "Bashkimi"*"<sup>6</sup>.

Natyrisht duke pasur parasysh vështirësitë e mëdha të Preng Doçit si klerik në Mirditë, lista e botimeve të shoqërisë "Bashkimi" është e gjatë dhe e larmishme. Për afro 9 vjet nga themelimi i saj deri në prag të Kongresit të Manastirit vuri në qarkullim mbi 35 libra nga autorë anëtarë të shoqërisë. Ndër ta shquhen libra historie, vëllime me poezi, romane, libra gjeografie, edukate, bujqësie etj. Nga vështrimi i veprave të botuara prej "Bashkimit" të bien në sy dy gjëra: E para, synimi për të

<sup>4</sup> J.Thomai, *Leksikologjia Shqipe*, Tiranë 1984, f. 44.

<sup>5</sup> *Letër e L. Gurakuqit*, botuar në ZP, Nr. 263, f. 3, Tiranë 11.10.1962.

<sup>6</sup> F.Konica, *Letër Gjeçovit*, tetor 1907, (ruhet tek një privat).

vënë në pah të kaluarën dhe të tashmen e vendit nëpërmjet historisë dhe gjeografisë, dhe e dyta, përpjekja për njehsimin e gjuhës letrare dhe studimin e saj mbi baza shkencore, përkitazi me çështjen kombëtare. Prandaj në këtë fushë nuk janë të rastit botime të tilla si drejtshkrimi, gramatika, fjalori, vargnimi në gjuhën shqipe etj.

## Nga kolana “Studime shqiptare”

### janë botuar:

1. *Martin Camaj –tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër, 1994, 164 f.
2. *Historia e letësisë si grindje metodike*, Shkodër, 1995, 99 f.
3. *Ernest Koliqi (1903-1975)*, Shkodër, 1995, 103 f.
4. *Justin Rrota-studiuues i shquar i letrave shqipe (1899-1964)*, Shkodër, 1995, 94 f.
5. *Kontribute të albanologëve të huaj për studimin e gjuhës shqipe*, Shkodër, 1996, 158 f.
6. *At Gjergj Fishta-Komb-Letërsi-Gjuhë*, Shkodër, 1997, 167 f.
7. *Studiuuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Shkodër, 1997, 146 f.
8. Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1996), Shkodër, 1997, 120 f.
9. *Eqrem Çabej-personalitet i shquar i shkencës dhe i kulturës shqiptare*, Tiranë, 1998, 187 f
10. *Gjuha dhe ligjërimi në shkollë*, Shkodër, 1998, 189 f.
11. *Gjuha dhe shkrimtari*, Shkodër, 2001, 152 f.
12. *Albanologu i shquar austriak Norbert Jokli (1877- 1942)*, Shkodër, 2003, 363 f.
13. *Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Shkodër, 2005, 208 f.
14. *Autorët e trevës së Veriut në vështrimin gjuhësor letrar dhe historik; 100-vjetori i botimit të këngës “Te Ura e Rrzhanicës”*, Shkodër, 311 f.
15. *Identitete gjuhësore dhe kulturore*, Shkodër, 2010, 2002 f.

16. *Selman Riza - gjuhëtar i shquar, në 100-vjetorin e lindjes*, Shkodër, 2010, 172 f.
17. *Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu*, Shkodër, 2011, 382 f.
18. *Fishta- poeti dhe mendimtari kombëtar*, Shkodër, 2011, 204 f.
19. *Fjalori i Shoqërisë "Bashkimi" në 100-vjetorin e tij*, Shkodër, 2011, 160 f.